



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Përkthim teknik – letrar dhe interpretim”

ofruar nga

“Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Enriketa SOGUTIU

Dr. Eriona ÇELA

Prill / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në: “Përkthim teknik – letrar dhe interpretim”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1225, datë 03.09.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 193, datë 16.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike, 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip /anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht, turqisht, greqisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	VA 2022-2023 69 PAE / 31 PAK; VA 2023-2024 67 PAE / 6 PAK;
18	Numri i studentëve:	VA 2022-2023 62 studentë VA 2023-2024 60 studentë VA2024-2025 65 studentë
19	Komente / të tjera:	-


PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi Master i Shkencave në “Përkthim Teknik Letrar dhe Interpretim” ofrohet nga të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës. Ky program është hapur me VKM 1225, datë 03.09.2008 me emërtim diplome Master i Shkencave në “Përkthim Teknik Letrar dhe Interpretim”, në sistemin 2-vjeçar me shkëputje nga puna.

Universiteti i Tiranës ka lidhur një Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Strasburgut për ofrimin e këtij programi studimi. Ajo që vlen të theksohet është fakti se programi është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të FGJH-së. Qëllimi i tij është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për tu bërë pjesë e tregut të punës menjëherë pas diplomimit si edhe ti aftësojë ato për të përkthyer materiale të ndryshme si edhe të zhvillojë aftësitë e studentëve në interpretim.

Gjithashtu, ky program kontribuon në zhvillimin e shoqërisë me anë të tri shtyllave të misionit të tij: kërkimit shkencor, edukimit dhe shërbimit ndaj publikut duke synuar edhe në transformimin e jetës së studentëve. Departamentet bëjnë një shpërndarje të balancuar ndërmjet veprimtarive mësimore, ngarkesës mësimore dhe praktikave brenda dhe jashtë kurrikulare, gjë që çon në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve dhe pajisjen e tyre me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale të nevojshme për një punësim në fushën e përkthimit.

Programi është në përputhje me prirjet globale të zhvillimit dhe me objektivat e kornizës “Edukimi dhe Trajnimi 2020” në fushën e arsimit dhe formimit, dhe me kuadrin e ri të Bashkimit Evropian për kompetencat themelore për të nxënëit gjatë gjithë jetës, si dhe me objektivin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kurrikula e programit është e ristrukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 120 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në 2 vite akademike. Programi ofron kualifikim të nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i përgatit të diplomuarit për të ndjekur studimet në programe të ciklit të tretë në fushën përkthimit dhe interpretimit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm, ngritur në përputhje me dispozitat ligjore të MAS dhe ASCAL, ka në përbërje të tij 2 (dy) profesorë: **Prof.Asoc. Enriketa Sogutlu** dhe **Dr.Eriona Çela**, dhe 1 (një) koordinator teknik të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Znj. Majlinda Demirmeli. Hartimi i draft raportit të vlerësimit të jashtëm është realizuar duke përcaktuar qartë mes anëtarëve përgjegjësitë dhe detyrat e gjithë secilit.


Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”, i ofruar nga të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja kaloi në disa etapa. Në fillim, grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ) iu vu në dispozicion nga ASCAL-i dosja e vetëvlerësimit së bashku me raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe dokumentacionin e përfshirë në të. Informacioni i përmendur më sipër u vu në dispozicion të GVJ-së pothuaj një muaj para vizitës në institucion, kohë e mjaftueshme për të lexuar, kuptuar dhe saktësuar informacionin e paraqitur në DVV si dhe evidencat për plotësimin e standardeve dhe kriterëve brenda fushave të RVB-së. Për të kuptuar më qartë, verifikuar dhe konkretizuar përfundimet e GVJ-së në lidhje me plotësimin e kriterëve nga programi i studimit, grupit iu dha mundësia e një vizite 2 (dy) ditore në institucion, e cila bazohej në një agjendë të përcaktuar qartë.

Vizita në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja u realizua gjatë periudhës 16-17 Dhjetor 2024. Gjatë kësaj vizite, GVJ-ja realizoi takime me dekanen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, përgjegjësit e të shtatë departamenteve të fakultetit, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, sekretarinë mësimore, përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore, NJSBC-në, zyrën e Planifikimit të Karrierës, dhe zyrën e Kërkimit Shkencor. Në fund të vizitës, GVJ-ja vizitoi mjediset mësimore, laboratorët e përkthimit, bibliotekën, etj.

Vizita në institucion dhe krahasimi i përfundimeve të dala gjatë vizitës me dokumentacionin e përfshirë në DVV, krijuan GVJ-në të krijojë një ide më të qartë në lidhje me procedurat e organizimit dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e aktorëve të përfshirë në menaxhimin dhe realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim” që ofrohet nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Burimet njerëzore në dispozicion të programit të studimit dhe infrastruktura, e cila mbështet realizimin e programit të ciklit të dytë, përforcuan konstatimet dhe përfundimet e shprehura nga GVJ-ja në vazhdim, në formën e draft raportit të vlerësimit të jashtëm.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.03.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 46/3 Prot, datë 12.03.2025. Universiteti i Tiranës njofton në ASCAL më datë 27.03.2025, nëpërmjet shkresës me nr. 839/3 Prot, datë 26.03.2025 “*Kthim përgjigje shkresës me Nr. 46/3 Prot, datë 12.03.2025*”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:



1. Për komentin Standardi II.1, kriteri 1

Bazuar në RVB, dhe në evidencat e paraqitura në DVV, GVJ-ja konstatoi se për programin e studimit Master i Shkencave në "Përkthim Teknik-letrar dhe Interpretim, ndonëse janë bërë dhe janë miratuar ndryshimet përkatëse për veprimtaritë formuese dhe ndarja e ngarkesës në kredite në përputhje me përcaktimet e VKM 41, datë 24.01.2018 (**Evidenca II.15**), këto ndryshime **nuk janë reflektuar** në të gjitha dokumentet përkatëse, siç janë plani mësimor (**Evidenca II.1 Dosja e programit/plani mësimor**), Tabela e veprimtarive formuese sipas VKM 41 (**Evidenca shtesë Tabela nr 9**), apo edhe suplementi i diplomës (**Evidenca III.55.1 Model Suplementi i Diplomës**). Edhe dokumenti i paraqitur me kërkesë të GVJ-së gjatë takimeve në institucion, si evidencë shtesë nuk i përmban ndryshimet e miratuara (**Evidenca shtesë nr 10**).

*Në lidhje me këtë konstatim, institucioni argumenton se ndarja e veprimtarive formuese është në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018, dhe është reflektuar në të gjitha dokumentet përkatëse, dhe në mbështetje të kësaj ka paraqitur dokumente shtesë. Megjithatë GVJ përsëri konstaton se në suplementin e diplomës të paraqitur si (**Evidencë 4 Suplementi i përditësuar 2023-2025, faqja 3**) përsëri praktika profesionale dhe detyrimi përmbyllës tezë figurojnë me përkatësisht 5 ECTS dhe 25 ECTS, pra nuk pasqyrojnë ndryshimet e bëra. Gjithashtu tabela me veprimtaritë formuese duhet të përmbajë lëndët me ECTS përkatëse, më pas të llogaritura në %, ndërkohë që **Evidenca shtesë 3 Tabela me shpërndarjen e krediteve** përmban vetëm totalin e përqindjes së lëndëve për çdo kategori. Për këtë arsye, rekomandimi i GVJ-së në lidhje me reflektimin e ndryshimeve për ndarjen e ngarkesës së krediteve sipas VKM 41 në të gjitha dokumentet përkatëse nuk ndryshon. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.***

2. Për komentin Standardi II.1 kriteri 9

Në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit nënshkruar me Universitetin e Strasburgut, bazuar në (**Evidencën II.6 Marrëveshje me Universitetin e Strasburgut**) si dhe në takimet me përgjegjësit e departamenteve dhe dekanen e fakultetit, GVJ-ja konstatoi se vlefshmëria e marrëveshjes kishte përfunduar.

*Në lidhje me këtë konstatim, institucioni argumenton se marrëveshja është përditësuar duke paraqitur një evidencë të re (**Evidenca Marrëveshje midis UT FGJH dhe UNISTRA ITIRI 2022**) nënshkruar në vitin 2022, me një afat vlefshmërie 5 (pesë) vjeçar, e hapur për rinovim. GVJ-ja merr në konsideratë argumentimin e institucionit në lidhje me rinovimin e marrëveshjes me Universitetin e Strasburgut. **Raporti në këtë pikë ndryshon.***

3. Për komentin Standardi II.1 kriteri 3

Për sa u përket ndryshimeve në ngarkesën e praktikës profesionale, përkatësisht në numrin e ECTS-ve, GVJ-ja konstatoi mospërputhje mes numrit të ECTS-ve të raportuara dhe atyre



të reflektuara në dokumente përkatëse, si plani mësimor (**Evidenca II.1 Dosja e programit të studimit**) dhe Suplementi i diplomës (**Evidenca III.55.1 Model Suplementi i Diplomës**) dhe (**Evidenca shtesë nr .10 Suplementi i diplomës**).

Në lidhje me këtë konstatim, institucioni argumenton se numri i krediteve për praktikën profesionale përkatësisht 12 ECTS, është i reflektuar në të gjitha dokumentet përkatëse, plani mësimor dhe suplementi i diplomës, dhe në mbështetje të këtij argumenti ka paraqitur evidenca mbështetëse, (Evidencë nr.2 Plani mësimor), (Evidencë nr.4 Suplementi i diplomës), dhe (Evidencë nr.9 Ngarkesa mësimore për shkak të buxhetit).

Megjithatë, GVJ-ja përsëri konstaton se në suplementin e diplomës të paraqitur si (Evidencë nr.4 Suplementi i përditësuar 2023-2025, faqja 3) përsëri praktika profesionale figuron me 5 ECTS, pra suplementi i diplomës nuk pasqyron ndryshimet e bëra. Për këtë arsye, rekomandimi i GVJ-së në lidhje me reflektimin e ndryshimeve për ndarjen e ngarkesës së krediteve sipas VKM 41 në të gjitha dokumentet përkatëse nuk ndryshon. Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

4. Për komentin Standardi II.2 kriteri 3

GVJ-ja, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatoi mungesën e vendimit zyrtar për emërimin e personave përgjegjës për ndjekjen e praktikës profesionale, dhe kërkoi vënien në dispozicion, por ky dokument nuk u paraqit as në dokumentet shtesë.

Në lidhje me këtë konstatim, institucioni argumenton se personat përgjegjës për praktikën profesionale emërohen me vendim përkatës, dhe në mbështetje të këtij argumentimi ka paraqitur (Evidencën nr 8 Mbi caktimin e përgjegjësve të praktikës). GVJ-ja e merr në konsideratë argumentimin e institucionit në lidhje me emërimin e personave përgjegjës për praktikën profesionale. Raporti në këtë pikë ndryshon.

5. Për komentin Standardi II.3 kriteri 2

Bazuar në planin mësimor dhe sylabuset e lëndëve, GVJ-ja konstatoi se emërtimet e lëndëve janë kryesisht Përkthim A-B ose Përkthim B-A, dhe sugjeroi përfshirjen e lëndëve me karakter letrar dhe teknik, në përputhje me emërtimin e programit të studimit (**Evidenca II.1 Plani mësimor, Tabela 10 shtojca**). Gjatë vizitës në institucion u theksua se emërtimi i lëndëve ishte bërë në mënyrë që t'i përshtatej marrëveshjes me universitetin e Strasburgut, ndërkohë që GVJ-ja bazuar në dokumentacionin në DVV dhe gjatë takimet në institucion konstatoi se vlefshmëria e marrëveshjes e kishte kaluar afatin.

Në lidhje me këtë konstatim, institucioni argumenton se emërtimi i lëndëve është bërë në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar me universitetin e Strasburgut, dhe për këtë ka paraqitur si mbështetje (Evidencën nr.5 Marrëveshje me Universitetin e Strasburgut). Gjithashtu, institucioni argumenton se programi lëndor përfshin një lëndë përkthim letrar

dhe lëndën e përkthimit të terminologjisë si lëndë me zgjedhje, dhe se emërtimi Përkthim A-B dhe Përkthim B-A nuk kufizon përfshirjen e tematikave në përputhje me objektivat e programit të studimit. Megjithatë përmbajtja e silabuseve të lëndëve paraqet një përsëritje të tematikave dhe literaturës. GVJ-ja merr pjesërisht në konsideratë argumentimin e institucionit në lidhje me emërtimin e lëndëve. Në këtë pikë raporti ndryshon në "GVJ-ja sugjeron përfshirjen në syllabuset e lëndëve Përkthim B-A dhe Përkthim A-B të tematikave me karakter letrar dhe teknik."

6. Për komentin Standardi II.3 kriteri 5

Bazuar në planin mësimor, si dhe në mungesën e ndryshimeve kurrikulare përpos atyre të diktuar nga udhëzimet përkatëse, GVJ-ja konstatoi mungesën e lëndëve specifike në përputhje me kërkesat e tregut dhe të teknologjisë (**Evidenca II.1 Plani mësimor**). Edhe pse gjatë takimeve në institucion, u theksua mbështetja nga ana e universitetit për trajnime në lidhje me përdorimin e programit kompjuterik TRADOS, kjo nuk është mbështetur me asnjë evidencë.

Në lidhje me këtë konstatim, institucioni argumenton se ka filluar trajnimet me stafin dhe studentët e programit të studimit për përdorimin e programit kompjuterik për përkthimin TRADOS. Gjithashtu institucioni argumenton se përdorimi i teknologjisë dhe integrimi i njohurive dhe aftësive në lidhje me CAT tools është pjesë e lëndëve të veçanta, dhe ka përmendur dy evidenca (**Evidenca nr. 11 Platforma TRADOS**) dhe (**Evidenca nr.12 Planet mësimore**) të cilat nuk janë ekzistente në sistem. Për sa më sipër, rekomandimi i GVJ-së për përfshirjen e lëndëve në lidhje me përdorimin e teknologjisë ndryshon pjesërisht. **Raporti ndryshon në "GVJ-ja rekomandon përfshirjen e përdorimit të platformave teknologjike dhe të CAT tools në silabuse të lëndëve Përkthim B-A dhe Përkthim A-B"**.

7. Për komentin Standardi II.4 Kriteri 5

Bazuar në silabuset e lëndëve të paraqitura në DVV, GVJ-ja konstatoi se literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar pothuajse në të gjitha syllabuset mund të konsiderohet e vjetërsuar dhe e mbi dhjetë viteve të fundit. (**Evidenca 30-34 silabuset e lëndëve**).

Institucioni shpreh dakordësi me këtë konstatim dhe gatishmëri për përmbushjen e detyrimit të përditësimit të silabuseve në vazhdim, duke vënë në dispozicion programe të lëndëve me literaturë të përditësuar, por evidenca e pretenduar (**Evidenca nr.12 Programe të lëndëve**) nuk është përcjellë. Për këtë arsye, rekomandimi i GVJ-së për përditësimin e literaturës nuk ndryshon. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

8. Për komentin Standardi II.5 kriteri 2

Duke qenë se ky kriter kërkon përfshirjen e studentëve në përmirësimin e programit të studimit dhe konsultimin për këtë qëllim edhe me studentët e diplomuar, bazuar në RVB dhe dokumentacionin në DVV, GVJ-ja konstatoi paqartësi dhe mungesë evidencash në lidhje me organizimin e takimeve me studentë për t'u konsultuar për përmbajtjen e programit të studimit.

Në lidhje me këtë konstatim, institucioni argumenton se me studentët e diplomuar dhe ata që vijojnë kualifikimet në ciklin e tretë të studimeve, organizohen prezantime dhe vlerësime të punës nga doktoratët dhe komisionet vlerësuese dhe se në këto takime shkëmbehen idhe dhe propozime mbi ecurinë e punës së doktorantëve si dhe vlerësohen idetë e tyre mbi përmirësime të programeve në të ardhmen (Evidenca nr.13 Raporte).

GVJ-ja gjykon se këto takime kanë për qëllim vlerësimin e punës së doktorantëve dhe rekomandimet që mund të dalin në lidhje me kuadrin teorik janë pjesë e domosdoshme e çdo punimi doktorature. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

9. Për komentin Standardi II.7 kriteri 3

Bazuar në informacionin e paraqitur në (Tabelën nr. 22) të shtojcave, GVJ-ja konstatoi mungesën e të dhënave për angazhimin në veprimtari të kërkimit shkencor të studentëve nga departamentet e gjuhës angleze, frënge dhe gjermane, dhe sugjeroi analizimin dhe raportimin e këtij angazhimi për secilin departament të programit të studimit.

Në lidhje me këtë rekomandim, institucioni ka plotësuar (Tabelën 22) për departamentet e gjuhës frënge dhe ruse, ndërkohë që listë të veprimtarive ku janë angazhuar studentët e departamentit të gjuhës angleze apo (Evidencë nr 14.Përshkrim cilësor) nuk ka.

Rekomandimi i GVJ-së në lidhje me analizimin e angazhimit të studentëve në kërkim shkencor për secilin departament dhe përfshirjen e të dhënave në raporte analitike nuk ndryshon. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” ofrohet nga njësia kryesore fakulteti i gjuhëve të huaja (FGJH) dhe si program i përbashkët ndërdepartamental nga të gjitha njësitë bazë të njësisë kryesore, miratuar me VKM 1225, datë 03.09.2008. Ai kontribuon në zhvillimin e shoqërisë me anë të tri shtyllave të misionit të tij: kërkimit shkencor, edukimit dhe shërbimit ndaj publikut duke synuar edhe në transformimin e jetës së studentëve. Siç shprehet edhe në nenin 5 të Statutit të UT-së, universiteti nxit rritjen personale dhe intelektuale të studentëve për t’i përgatitur si për karrierën edhe si qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë duke kontribuar në përgatitjen e individëve që konsolidojnë vlerat kombëtare e kulturore. GVJ-ja konstaton se programi i studimit “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” është në përputhje me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen dhe përforcimin si të vlerave akademike edhe të atyre kombëtare. Evidenca <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës,</i> <i>Evidenca 1.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së 2018-2023,</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e zhvillimit të UT-së 2023-2028,</i> <i>Evidenca 1.6 Strategjia e Zhvillimit të FGJH-së,</i> <i>Evidenca 1.10 Raporti vjetor mësimor-kërkimor 2022-2023)</i> <i>Evidenca nr. 1.15 Urdhër për hapjen e programeve të ciklit të dytë</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe	Ashtu si shprehet edhe në strategjinë e Zhvillimit të FGJH-së 2021-2024, programi i studimit Master i Shkencave në

ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	“Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, i cili është t’i shërbejë shoqërisë duke ofruar një formim universitar me cilësi të lartë me qëllim që t’i pajisë studentët me aftësi profesionale sipas tregut të punës, si dhe në përputhje me misionin e UT-së. Ky program ofrohet në përputhje me fushën e përkthim-interpretime, e cila është një nga tri drejtimet/fushat e programeve që ofron Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, ku dy të tjerat janë fusha e gjuhësisë dhe letërsisë dhe ajo e kulturës. GVJ-ja konstaton se programi i studimit është në përputhje me misionin e Universitetit të Tiranës, me misionin e FGJH-së si dhe me fushën e veprimtarisë së tyre. Evidenca <i>Evidenca 1.1 nenet, 4, 5 dhe 8, Statuti i Universitetit të Tiranës, Evidenca nr.1.6, f.3 misioni, Strategjia e Zhvillimit të FGJH-së, Evidenca 1.21, neni 4, Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Në përputhje dhe përshtatje me strategjinë e zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe atë të Universitetit të Tiranës, programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” synon të formojë studentë me cilësi, vlera e kompetenca, si dhe të aftë të kontribuojnë në sektorin e përkthimit në veçanti dhe atë të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Universiteti i Tiranës ofron programe në nëntë fusha të ndryshme, ndër të cilat janë edhe gjuhët e huaja. Veprimtaria e departamenteve që ofrojnë këto programe është hartuar e strukturuar në përputhje me drejtimet akademike të UT-së dhe FGJH-së, me Statutin e UT-së si dhe me rregulloren e FGJH-së dhe rregulloren e UT-së. GVJ-ja konstaton se programi ofrohet në përputhje me strategjinë e Institucionit, Statutin dhe rregulloren e tij, me rregulloren e njësisë kryesore si dhe në përputhje me drejtimet akademike të institucionit dhe të njësisë kryesore. Evidenca <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2023-2028,</i>

	<i>Evidenca 1.1 Statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e FGJH-së</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” ofrohet nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në përputhje me statutin e Universitetit të Tiranës, i cili është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe të kërkimit shkencor e inovacionit. Gjithashtu ai është në përputhje me prirjet globale të zhvillimit dhe me objektivat e kornizës “Edukimi dhe Trajnimi 2020” në fushën e arsimit dhe formimit, dhe me kuadrin e ri të Bashkimit Evropian për kompetencat themelore për të nxënëit gjatë gjithë jetës, si dhe me objektivin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Evidenca <i>Evidenca 1.11. Strategjia e Ndërkombëtarizimit të FGJH-së,</i> <i>Evidencë 1.12 Strategjia Kombëtare e Arsimit</i>			
Konkluzione	GVJ-ja konstaton se: - Universiteti i Tiranës, i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike, kulturore kombëtare, të cilat janë të parashikuara në Statutin e UT-së; - Hartimi i programit të studimit bëhet në përputhje me objektivat dhe misionin e UT-së të bëra të qarta në Statutin e institucionit dhe në planin e tij strategjik si dhe në përputhje me fushën e tij të veprimtarisë në shkencë humane, përkatësisht në gjuhë të huaja dhe përkthim; - Programi është në përshtatje me dhe në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UT-së dhe është hartuar e zhvilluar në përputhje me strategjinë kombëtare, interesin kombëtar si dhe me prirjet globale të zhvillimit;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	I hapur që në vitin 1957, Universiteti i Tiranës është institucioni i parë i arsimit të lartë në Shqipëri, dhe si rrjedhojë ka krijuar përvojë në përgatitjen e profesionistëve dhe elitave në fusha të ndryshme. Me 6 fakultete, 2 institute dhe 174 programe studimi, ai është IAL-ja më e madhe në vend. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”, dëshmon se ka 131 pedagogë të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit, të angazhuar në projekte kombëtare e ndërkombëtare, dhe në programe mobiliteti, të cilët sjelli përvojë, cilësi dhe njohuri e kompetenca të përditësuara. Personeli akademik ka përvojën e duhur në mësimdhënie, përgatitjen e teksteve dhe përkthimin e teksteve të ndryshme letrare e teknike, duke dëshmuar për ekzistencën e kapaciteteve dhe burimeve të duhura për ofrimin e programit në këtë fushë. Programi i studimit ofrohet për çdo gjuhë. Kjo dëshmohet edhe në vlerësimin e UT me numrin maksimal të akreditimit institucional nga ASCAL-i në vitin 2023. Evidenca <i>Evidenca Nr 1.13, Akreditimi, Vendim nr.04.dt, 27.01.2023</i> <i>Evidenca 1.9 Raporti vjetor mësimor-kërkimor 2021-2022</i> <i>Evidenca 1.10 Raporti vjetor mësimor-kërkimor 2022-2023</i> <i>Shtojcat Tabelat 1-4</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe	Programi Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” ofrohet nga fakulteti i gjuhëve të huaja, dhe në bazë të dokumentacionit në DVV-në e programit, rezulton se fusha e përgjithshme e programit përkon me fushën “Arte dhe shkencave humane”, ndërsa fusha specifike është përgatitja e përkthyesve letrarë dhe teknikë si dhe interpretëve. GVJ-ja konstaton se veprimtaria e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të fakultetit të gjuhëve të huaja. Bazuar në Kornizën Shqiptare të kualifikimeve, programi i referohet nivelit 7 dhe përgatit specialistë të fushës

udhëzimeve kombëtare e evropiane.	përkatëse, përkthyes teknik-letrar dhe interpretues. Ai është i bazuar në kodifikimin e programeve sipas direktivave dhe udhëzimeve si kombëtare edhe evropiane. Nga dokumentacioni i përfshirë në DVV, GVJ-ja konstaton se programi ofrohet me 120 kredite (ECTS) në dy vite akademike me kohë të plotë në përputhje me direktivat kombëtare e evropiane. Evidenca <i>Evidencë 1.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidencë nr 1.21 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit në DVV dhe në takimet në institucion, rezulton që programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” është program ndërdepartamental dhe ofrohet nga të gjitha njësitë bazë të fakultetit të gjuhëve të huaja, të cilat janë departamente të gjuhëve të huaja, dhe është në përputhje të plotë me fushat e tyre akademike e kërkimore. Ky program studimi është ndërdepartamental dhe të gjitha njësitë bazë janë përgjegjëse për programin e studimit, dhe secila njësi siguron mbarrëvajtjen e programit për pjesët e lidhura drejtpërdrejt me njësinë përkatëse. Evidenca <i>Evidencë 1.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidencë nr 1.21 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e	Në mbështetje të realizimit të trajnimeve dhe programeve për zhvillimin e mëtijshëm profesional të studentëve dhe të diplomuarve si edhe të stafit, Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja organizojnë veprimtari të ndryshme si leksione të hapura, seminare, trajnime e webinarë në

diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	bashkëpunim me ekspertë vendas dhe të huaj, si dhe me punëdhënësit të ndryshëm. Në funksion të kësaj janë ngritur përkatësisht “Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe e Trajnimit” pranë UT-së dhe “Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik” pranë FGJH-së. Evidenca <i>Evidenca 1.17 Vendimi për Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe të Trajnimit;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se:</i> - <i>njësia kryesore disponon kapacitetet njerëzore për të ofruar programin e studimit Master i Shkencave në Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” si dhe përvojën e duhur në këtë drejtim. Nga shqyrtimi i CV-ve, rezultojnë se fusha akademike e personelit akademik është në përputhje të plotë me fushën e programit të studimit, dhe se personeli akademik ka kualifikimin e duhur në këtë drejtim;</i> - <i>fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të njësisë kryesore dhe të njësive bazë të cilat e ofrojnë;</i> - <i>Programi i studimit ofrohet nga të gjitha njësitë bazë të fakultetit të gjuhëve të huaja, dhe secila njësi bazë është përgjegjëse për mbarëvajtjen e programit të lidhur drejtpërdrejt me njësinë bazë përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucionet e arsimit të lartë sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ-ja konstaton se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, si njësi kryesore ku ofrohet programi i studimit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit duke bërë ndarjen e detyrave ndërmjet njësive dhe personelit të cilat janë të përcaktuara në rregulloren e FGJH-së. Gjithashtu konstatohet se për të koordinuar dhe mbikëqyrur punën e njësive, FGJH-ja bën vlerësimin e punës dhe të aktiviteteve të tyre duke u përqendruar në elementë të tillë si stafi akademik, ndihmës akademik dhe ai administrativ, programet mësimore, mësimdhënia, studentët dhe shërbimet logjistike. Kjo analizë bëhet në periodikë vjetore dhe pasqyrohet në raportet vjetore mësimore kërkimore të njësisë. Evidenca <i>Evidenca 1.9 Raporti vjetor mësimor kërkimor 2021-2022,</i> <i>Evidenca 1.10 Raporti vjetor mësimor kërkimor 2022-2023</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Si gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, por edhe gjatë vizitave në IAI, GVJ-ja konstaton se për realizimin e objektivave dhe të procesit formues të studentëve, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ndjek një praktikë të vazhdueshme për vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit. Në raportin vjetor të vitit 2021-2022, vihet re se brenda një viti FGJH-ja ka vendosur marrëdhënie në fushën e kërkimit shkencor me institucione vendase dhe me institucione të huaja. Universiteti i Tiranës demonstroi një qasje të drejtuar kah ndërkombëtarizimit, gjë që vërtetohet me numrin e lartë të marrëveshjeve të vendosura në kuadër të programeve të shkëmbimit si Erasmus+, Mevlana, dhe të lëvizshmërisë së personelit akademik dhe studentëve. Evidenca <i>Evidenca 1.9, Raporti vjetor mësimor kërkimor 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.10, Raporti vjetor mësimor kërkimor 2022-2023;</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan	GVJ-ja konstaton se institucioni bashkëpunon dhe lidh marrëveshje me punëdhënësit shtetërorë dhe privatë për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale. Siç vihet re edhe në

marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	dokumentacion, rezulton se janë realizuar 35 të tilla. Këto memorandume bashkëpunimi parashikojnë edhe kryerjen e veprimtarisë së kërkimit shkencor. Memorandume bashkëpunimi janë lidhur edhe për realizimin e kërkimit shkencor, konkretisht Memorandume bashkëpunimi për praktikën mësimore dhe profesionale, Fakulteti i Gjuhëve të huaja nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione dhe kompani të fushës dhe bashkëpunon me këta aktorë për realizimin e praktikave profesionale në fushën e përkthimit. Evidenca <i>Evidenca 1.19 Memorandum bashkëpunimi për praktikën profesionale;</i> <i>Shtojcat Tabela 5;</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Bazuar në materialet në DVV, GVJ-ja konstaton se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, harton raporte periodike kryesisht vjetore ku analizon dhe raporton përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. Në këto raporte përfshihen të dhëna për marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e mobilitetit të stafit dhe brenda vitit 2021-2022 janë realizuar 30 të tilla në fakultetin e gjuhëve të huaja. Ndërkohë që janë vendosur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me bashkëpunimi në funksion të realizimit të programit, raportet analitike nuk përfshijnë përfitime të studentëve nga këto marrëveshje. <i>GVJ-ja sugjeron përfshirjen në raporte analitike të përfitimeve të studentëve nga marrëveshjet e bashkëpunimit të realizuara në funksion të përmbushjes së qëllimit të programit të studimit.</i> Evidenca <i>Evidenca nr 1.9 Raport vjetor mësimor –kërkimor 2021-2022,</i> <i>Evidenca nr 1.10 Raport vjetor mësimor-kërkimor 2022-2023</i>
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se:</i> - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja realizon ndarjen e detyrave mes njësive dhe personelit për realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit si dhe realizon analizën e veprimtarisë

	dhe punën së tyre, gjë që konkretizohet me përgatitjen e raporteve analitike vjetore; - Në funksion të objektivave të procesit mësimor, institucioni ka realizuar vendosjen e një numri të lartë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit. Institucioni punon në mënyrë sistematike për realizimin e objektivave të programit të studimit në kuadrin e procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit; <u>GVJ-ja rekomandon</u> përfshirjen në raporte analitike të përfitimeve të studentëve nga marrëveshjet në kuadër të realizimit të praktikës dhe mobilitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin	GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” ofrohet në përputhje me ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), por nuk është në përputhje me ndarjen e veprimtarive formuese sipas përcaktimit në VKM 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me vendim nr. 185, datë 25.03.2021.

Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Referuar *evidencës II.15, Dosja e programit të studimit*, programi është i organizuar në 2 vite akademike dhe në 4 semestra me nga 30 ECTS secili, në total 120 ECTS. Megjithatë, vihet re mospërputhje mes kësaj evidence dhe dokumentit të kërkuar gjatë vizitës në institucion (*Tabela nr 9 Planin mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese nuk është në përputhje me VKM 41*). Sipas këtij dokumenti programi është me 90 ECTS, dhe veprimtaria formuese e programit të studimit sipas kategorive A,B,C,D, dhe E është si më poshtë:

Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Sipas VKM 41/2018, e ndryshuar	Sipas programit të studimit
A	Lëndë bazë	5 % - 10 % (kredite)	5 %
B	Lëndë karakterizuese	50% -60% (kredite)	45 %
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12% -20% (kredite)	10 %
D	Lëndë Plotësuese	10% (kredite)	17.5 %
E	Detyrime përmbyllëse	10% -15% (kredite)	15 %

Nga sa më sipër konstatohet, se:

- gjenden më pak lëndë mësimore të kategorisë B (Lëndë karakterizuese) në Planin Mësimor të shprehura në 45 % të krediteve, në raport me 50-60% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;
- gjenden më pak lëndë mësimore të kategorisë C (Lëndë ndërdisiplinore/ integruese) në Planin Mësimor të shprehura në 10 % të krediteve, në raport me 12-20% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori;
- gjenden më shumë lëndë mësimore të kategorisë D (Lëndë plotësuese) në Planin Mësimor të shprehura në 17.5 % të

	krediteve, në raport me 10% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori; <i>Për sa më sipër <u>GVJ sugjeron</u>, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të përputhet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</i> Evidenca <i>Evidenca I.1 Statuti i UT-së</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së, Evidencë I.7 Rregullorja e FGJH</i> <i>Evidencë II.1 Dosjet e Programit të studimit</i> <i>Tabela nr 9 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese nuk është në përputhje me VKM 41;</i>
Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe në planin mësimor, GVJ-ja konstaton se programi i studimit synon formimin teorik dhe praktik të përkthyesve në fushën e përkthimit teknik, letrar dhe interpretim në dy gjuhë të huaja. Programi i pajis studentët me njohuri të larta shkencore dhe teknike në fushën e përkthimit dhe interpretimit, si dhe me aftësi të larta dhe i udhëheq drejt përfitimit të kompetencave profesionale të vlefshme për profesionin e përkthimit dhe interpretimit. Evidenca <i>Evidenca II.1 Dosja e programit të studimit, nenet 4, 7, dhe 9</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës	Në planin mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” është parashikuar në ngarkesë praktika profesionale, e cila realizohet në semestrin e katërt të studimeve. Sipas RVB-së, studentët e këtij program studimi i nënshtrohen praktikës profesionale e cila zhvillohet në

profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	semestrin e fundit të studimeve, është e monitoruar nga një pedagog udhëheqës dhe është e vlerësuar me 5 ECTS. Ndërkohë po sipas RVB-së, si detyrim përmbyllës, studentët e programit, i nënshtrohen provimit të mikrotezës/provimit final, i cili është i vlerësuar me 25 ECTS. Kjo ndarje vihet re edhe në planin mësimor paraqitur në dosjen e programit të studimit, ndërkohë që <i>evidenca II.15</i> raporton ndryshimet që janë bërë në planin mësimor, ku praktika profesionale dhe teza si detyrim përmbyllës kanë përkatësisht 12 dhe 18 ECTS. Këto ndryshime janë të reflektuara edhe në suplementin e diplomës dorëzuar si evidencë shtesë me kërkesë të GVJ-së gjatë vizitës në institucion. Si përfundim, GVJ-ja konstaton mospërputhje mes raportimit në RVB dhe evidencave të paraqitura. <u>GVJ-ja rekomandon reflektimin e ndryshimeve të bëra në planin mësimor, në dosjen e programit të studimit dhe në suplementin e diplomës, si dhe në çdo dokument tjetër të lidhur me këto ndryshime.</u> Evidenca <i>Evidencës II.15 Ndryshime në planin mësimor;</i> <i>Evidenca II.1 Dosja e programit të studimit, plani mësimor, dhe suplementi i diplomës.</i> <i>Evidenca shtesë 10 Suplementi i diplomës</i>
Kriteri 4.Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”,	Nuk Aplikohet

sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk Aplikohet
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nga dokumentacioni i përfshirë në DVV, GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim-teknik-letrar dhe interpretim” është i organizuar në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit. Ai ka të përcaktuara kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimi të studentëve, të transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve. Njësitë bazë kanë procedura përkatëse për përzgjedhjen e kandidatëve sipas kriterëve dhe shpallin listat e fituesve që plotësojnë kriteret. Evidenca <i>Evidenca I.1, Statuti i UT, kreu IV neni 91-94, 103-104, 109, 112;</i> <i>Evidenca II.1, Dosja e programit të studimit, neni 17-18;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT-së, neni 42, pika 2;</i> <i>Evidenca II.4, Shkresë për komisionet e dosjeve të aplikantëve;</i> <i>Evidenca II.5 Procedurë e shpalljes së fituesve në programin Master i Shkencave në përkthim;</i>

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në dijeninë e GVJ-së nuk ka asnjë IAL tjetër që të ofrojë një program të tillë studimi.
Kriteri 8.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i shkencave në “Përkthim-teknik-letrar dhe interpretim” është kodifikuar sipas fushës së studimit dhe klasifikimit të bërë publik nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ai i përket nivelit të shtatë të kualifikimeve, është dy-vjeçar, në fushën e arteve dhe humaniteteve, me fushë të ngushtë të papërcaktuar. 72MS0239X Kodifikimi i lëndëve të programit nuk është realizuar. Evidenca <i>Evidenca 1.15 Urdhër për hapjen e programeve të ciklit të dytë;</i> <i>Evidenca 1.16 Kodifikimi i programeve Master</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Bazuar në dokumentacionin në DVV, GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim-teknik-letrar dhe interpretim” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitetin e Strasburgut, e cila është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi, por nuk është program i përbashkët. Marrëveshja me Universitetin e Strasburgut është rinovuar në vitin 2022, për një afat pesë-vjeçar, e hapur për rinovim dhe vazhdimin e bashkëpunimit. Evidenca <i>Evidenca II.6 Marrëveshja me Universitetin e Strasburgut.</i> <i>Evidencë shtesë Marrëveshje midis UT FGJH dhe UNISTRA ITIRI 2022</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim-teknik-letrar dhe interpretim” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me</i>

	<i>legjislacionin në fuqi për Arsimin e Lartë dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i> <i>Ky program synon formimin teorik dhe praktik të përkthyesve në fushën e përkthimit teknik, letrar dhe interpretim në dy gjuhë të huaja.</i> <i>Ai i pajis studentët me aftësi të larta dhe i udhëheq drejt përfitimit të kompetencave profesionale të vlefshme për profesionin e përkthimit dhe interpretimit. Programi i studimit është kodifikuar në përputhje me udhëzimet përkatëse, ndërkohë që nuk është realizuar kodifikim lëndësh.</i> <i>GVJ sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të përputhet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, si dhe reflektimin e këtyre ndryshimeve në planin mësimor, suplementin e diplomës dhe në çdo dokument që ndikohet nga këto ndryshime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	UT, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.04, datë 27.01.2023 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 6 vite, deri në 26.01.2029. Fakultetit të Gjuhëve të Huaja si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 7 njësi bazë: 1. Departamenti i Gjuhës Angleze; 2. Departamenti i Gjuhës Frënge; 3. Departamenti i Gjuhës Italiane; 4. Departamenti i Gjuhës Gjermane; 5. Departamenti i Gjuhës Spanjolle; 6. Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike; 7. Departamenti i Gjuhës Greke;

FGJH si njësi përgjegjëse për programin e studimit, për tre vitet akademike ka në përbërjen e tij staf akademik, efektiv (PAE) dhe staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm: (III.17 Tabela 1+8 përmbledhese e personelit akademik)

Kualifikimi i stafit akademik të	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja					
	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	19	2	17	3	17	3
Prof. Asoc.	21	3	22	3	22	3
Dr/Phd	73	12	75	9	75	9
Msc.	17	77	17	70	17	69
Gjithsej	130	94	131	85	131	84

GVJ konstaton se njësi kryesore përmbush kërkesat ligjore për organizimin, strukturën dhe kualifikimin e tyre, si edhe për raportet mes personelit PAE dhe PAK.

Megjithatë, ajo që u vu re është se departamenti i gjuhës greke përbëhet nga 6 personel akademik me kohë të plotë. Mbështetur në ligjin e arsimit të lartë 85/2015 departamenti duhet të ketë në përbërje të tij 7 personel akademik ku të paktën 3 të kenë tituj shkencorë Prof.Dr ose Prof.Assoc.

Për sa më sipër, GVJ sugjeron marrjen e masave nga departamenti i gjuhës greke për punësim të një personeli akademik me kohë të plotë me titull shkencor.

Evidenca

Evidencë II.8 Manuali i cilësisë;

Evidencë II.9 Vendim për ngritjen e NJSBC-së,

Evidencë II.10 Përmbledhje e gjetjeve sipas raportit vjetor,

Evidenca 0.5 Vendim për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm,

Evidenca III.17 Tabela përmbledhese e stafit akademik

Tabela 1.2 Shtojca

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse

Bazuar në raportin dhe vizitat në institucion, GVJ-ja konstaton se në kurikulën dhe programin mësimor të programit të studimit

për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	parashikohet lënda e praktikës profesionale. Ndërkohë që njësia kryesore angazhon personel ndihmës akademik/administrativ për realizimin e shumë proceseve në lidhje me realizimin e programit, praktika profesionale është parashikuar si lëndë dhe çdo njësi përgjegjëse për programin bën ndjekjen e praktikës në bashkëpunim me koordinatorin e praktikës. dhe ndiqet nga pedagogu përkatës. dhe si mbikëqyrret ajo. Sic konfirmohet në (<i>Evidenca III.17 Tabela përmbledhëse e stafit akademik</i>), në FGJH angazhohen në rolin e personelit ndihmës akademik, PNA sipas viteve si më poshtë vijon: <table><tr><td>Personeli ndihmës akademik FGJH</td><td>2021 – 2022</td><td>2022 – 2023</td><td>2023 - 2024</td></tr><tr><td></td><td>7</td><td>7</td><td>7</td></tr></table>	Personeli ndihmës akademik FGJH	2021 – 2022	2022 – 2023	2023 - 2024		7	7	7
Personeli ndihmës akademik FGJH	2021 – 2022	2022 – 2023	2023 - 2024						
	7	7	7						
	Evidenca <i>Evidenca nr 1.1 Statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e brendshme e FGJH-së</i> <i>Evidenca III.17 Tabela përmbledhëse e stafit akademik</i>								
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, si njësi kryesore, cakton koordinatort për programet e studimit që ofron. Programi Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” koordinohet nga zv.dekani i fakultetit. Për realizimin e praktikës çdo njësi bazë cakton koordinatorin për organizimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e praktikës, të cilët më pas miratohen me vendim dekanati. <i>Evidenca mbështetëse 8 Mbi caktimin e personave përgjegjës për praktikën</i>								
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se:</i> - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacion për organizimin, strukturën akademike, vlerësimin dhe akreditimin; - Rregullorja e FGJH-së ka të përcaktuar realizimin e praktikës profesionale. Ndërkohë që realizimi i programit të studimit ndiqet nga koordinatori, i cili është zv.dekani i fakultetit,								

	<i>ndjekja dhe ecuria e praktikës profesionale realizohet nga çdo njësi bazë e fakultetit për studentët e vet, sikurse edhe procesi mësimor në tërësi;</i> <i>- GVJ rekomandon marrjen e masave nga departamenti i gjuhës greke për plotësimin me staf akademik efektiv sipas pikës 4, neni 25 të LAL 80/2015.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ-ja konstaton se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”, disponon dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Rregullorja e Fakultetit dhe e programit të studimit janë hartuar bazuar në Statutin e UT-së dhe në rregulloren e UT-së dhe përmbajnë të gjithë elementet dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me ofrimin dhe organizimin e programit të studimit, si dhe përmbajtjen e tij. Evidenca <i>Evidenca I.1 Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH-së;</i> <i>Evidenca II.1 Plan i mësimor dhe Rregullorja e programit të studimit në Përkthim teknik-letrar dhe interpretim;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në	Bazuar në informacionin e paraqitur në rregulloren e programit të studimit, plani mësimor i programit të studimit përmban emërtimin e lëndëve që zhvillohen në çdo vit akademik (dy vite akademike) dhe në çdo semestër (4 semestra), numrin e krediteve për lëndë dhe në total (120 ECTS), orët mësimore të ndara në

semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	javë. Komponentët mësimorë janë të ndarë në лекsione dhe seminare. Orët në auditor dhe orët jashtë auditorit përfshijnë studimin individual dhe ato në funksion të praktikës profesionale. GVJ-ja konstaton se shumica e lëndëve kanë emërtime të përgjithshme kryesisht përkthim A-B, ose Përkthim B-A, etj. Nuk konstatohen lëndë me përmbajtje teknike apo letrare, që të jenë në përputhje me emërtimin e programit të studimit “Përkthim teknik-letrar”. <i>GVJ-ja sugjeron përfshirjen në syllabuset e lëndëve Përkthim B-A dhe Përkthim A-B të tematikave me karakter letrar dhe teknik..</i> Evidenca <i>Tabela 10 shtojca</i> <i>Evidenca II.1 Plani mësimor dhe Rregullorja e programit të studimit në Përkthim teknik-letrar dhe interpretim;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ-ja konstaton se në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” si dhe në rregulloren e FGJH-së gjendet informacioni i nevojshëm për studentët, si kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, të transferimit të studimeve dhe të ekuivalentimit. Kriteret përcaktohen çdo vit dhe bëhen publike në faqen e Universitetit të Tiranës. Sipas këtyre kriterëve, kandidatët duhet të kenë përfunduar një program studimi të ciklit të parë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ose në programe të ngjashëm brenda ose jashtë vendit, në institucione publike ose jopublike dhe të akredituara, si dhe njohja e një prej pesë gjuhëve të BE, e vërtetuar me testimet ndërkombëtare në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit të arsimit. Renditja përfundimtar e kandidatëve bëhet në rend zbritës sipas notës mesatare. Evidenca <i>Evidenca I.21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”;</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH-së;</i> <i>Evidenca II.2 Rregullore e diplomimit</i>

	https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimiit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga Tabela nr 14 në shtojcën e RVB-së, GVJ-ja konstaton se programi i studimit përmban informacionin e nevojshëm për programet lëndore të secilës lëndë. Syllabuset për secilën lëndë janë hartuar sipas formatit të përcaktuar dhe miratuar nga MAS. Në përbërje të tyre gjenden të gjithë komponentët e nevojshëm si emërtimi i lëndës, tipologjia, ngarkesa javore e ndarë në leksione dhe seminare, numri i krediteve, përshkrimi dhe objektivat e lëndës, konceptet themelore, temat sipas kalendarit javor, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar. Megjithatë, ato nuk përmbajnë kode të lëndëve. <i>GVJ-ja sugjeron vendosjen e kodeve për secilën lëndë.</i> Evidenca <i>Evidencat 30-34 Syllabuset e lëndëve sipas departamenteve; RVB Tabela 10 Shtojca,</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”, është ofruar për herë të parë pas miratimit me VKM nr 1225, datë 03.09.2008 dhe nuk ka kaluar asnjë proces riorganizimi apo ndryshimi gjatë këtyre viteve. Të vetmet ndryshime kurrikulare janë ato për përshtatjen e ECTS-ve të lëndëve me VKM 41, dt 24.01.2018. <i>GVJ-ja rekomandon përfshirjen e përdorimit të platformave teknologjike dhe të CAT tools në silabuse të lëndëve Përkthim B-A dhe Përkthim A-B.</i> Evidenca <i>Evidenca I15, Urdhër për hapjen e programeve të ciklit të dytë</i>
Konkluzione	GVJ-ja konstaton se: - Rregullorja e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe ajo e programit të studimit përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për ofrimin dhe realizimin e programit të studimit, siç janë objektivat formuese, kriteret e pranimiit të studentëve,

	transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, mundësitë e punësimit, etj; - <i>Plani mësimor i programit përmban informacionin për çdo lëndë, ku përfshihet emërtimi i lëndës, kreditet, orët javore, etj;</i> - <i>GVJ-ja sugjeron vendosjen e kodeve për lëndët e planit mësimor të programit të studimit. Gjithashtu, <u>GVJ-ja rekomandon</u> përfshirjen e përdorimit të platformave teknologjike dhe të CAT tools si dhe të tematikave me karakter letrar dhe teknik në silabuse të lëndëve Përkthim B-A dhe Përkthim A-B.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ-ja konstaton se ka një shpërndarje të balancuar ndërmjet veprimtarive mësimore, ngarkesës mësimore dhe praktikave brenda dhe jashtë kurrikulare, gjë që çon në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve dhe pajisjen e tyre me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale të nevojshme për një punësim në fushën e përkthimit në përputhje me nevojat e tregut të punës, por edhe për të vazhduar studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve. Evidenca <i>Evidenca II.1 Plani mësimor;</i> <i>Evidenca 30-34, Silabuset e lëndëve sipas departamenteve;</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e	Bazuar në dokumentacionin në DVV, konstatohet se plani mësimor i programit shtrihet në 4 semestra me nga 30 ECTS, në dy vite akademike, duke siguruar një shpërndarje të barabartë të krediteve në vite, semestra, në orë mësimore në auditor dhe jashtë tij, si dhe studim individual, për projekte, provime, përgatitje teze

objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	dhe veprimtari të tjera, si praktika profesionale, duke mundësuar arritjen e objektivave formues të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Evidenca <i>Shtojca Tabela nr 10, Tabela nr 13.</i> <i>Evidenca II.1 Dosja e programit Plani mësimor</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Bazuar në dokumentacion si dhe gjatë takimeve në institucion, GVJ-ja konstaton se struktura e programit të studimit është organizuar në përputhje me profilin e programit dhe synon formimin e specialistëve në fushën e përkthimit teknik, letrar dhe të interpretimit. Gjithashtu, struktura e programit, lëndët dhe raporti teori-praktikë janë orientuar nga programe të ngjashme, gjë që ka krijuar mundësinë e shkëmbimit si për stafin dhe studentët, si dhe njihjen e periudhës së studimit në universitete të huaja. Evidenca <i>Evidenca II.6, Marrëveshje bashkëpunimi Universiteti i Strasburgut;</i> <i>Evidenca II.1, Rregullore e programit të studimit, neni 8-9;</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Referuar planit mësimor në dosjen e programit, GVJ-ja konstaton se plani mësimor përmban dhe pasqyron veprimtari formuese me karakter teorik dhe praktik, çka mundëson realizimin e objektivave, transferimin e studimeve, pjesëmarrjen në programe shkëmbimi si dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit. Megjithatë siç është komentuar edhe në standardet më lart, ka një mospërputhje të ndarjes së veprimtarive formuese në kategoritë A-E sipas përqindjes dhe ECTS-ve në planin mësimor dhe në tabelën nr 9 të veprimtarive formuese sipas VKM 41, 24.01.2018. <i>GVJ-ja sugjeron rishikimin e planit mësimor dhe shpërndarjen e veprimtarive formuese në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018.</i> Evidenca <i>Evidenca II.1 dosja e programit, plani mësimor</i> <i>Shtojca 1 Tabela nr 9 Ndarja e veprimtarive formuese</i>

	<i>Evidenca shitesë 14 Plani mësimor sipas veprimtarive formuese</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Referuar RVB-së, përditësimi i silabuseve bëhet bazuar në rishikimin dhe përditësimin e kurrukulës dhe në përditësim të vetë lëndës bazuar në nevojat që sheh pedagogu përfshirë edhe përditësim të literaturës. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjet e silabuseve, GVJ-ja konstaton se në planin mësimor nuk janë kryer ndryshime kurrikulare përveç atyre të detyruara që kanë të bëjnë vetëm me numrin e ECTS-ve të praktikës profesionale dhe tezës. Gjithashtu GVJ-ja konstaton se programi lëndor miratohet nga përgjegjësi i departamentit, megjithatë, mbetet e paqartë se si realizohet përditësimi i programit të lëndës. <i>Ndërkohë që GVJ konstaton se literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar pothuajse në të gjitha syllabuset mund të konsiderohet e vjetërsuar dhe e mbi dhjetë viteve të fundit.</i> <i>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës me botime të pesë viteve të fundit.</i> Evidenca <i>Evidenca nr 30-34, silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Nga plani mësimor i programit, GVJ-ja konstaton se përmbajtja e programit të studimit synon përfitimin e dijeve dhe aftësive specifike në fushën e përkthimit teknik, letrar dhe të interpretimit. Lëndët që ofron programi i studimit lidhen me fushën e përkthimit dhe të interpretimit. Ndërkohë lëndët e përkthimit janë të emërtuara vetëm në varësi të gjuhës nga shqip në gjuhë të huaj ose anasjelltas dhe nuk ka lëndë specifike të përkthimit teknik apo letrar. Edhe pse gjatë takimeve me stafin dhe përgjegjësit e departamenteve, u tha se kjo sigurohej në fillim të vitit akademik me miratimin e silabuseve, për GVJ-në mbetet e paqartë se si bëhet ndarja e lëndëve të përkthimit B-A dhe A-B në përkthim letrar dhe teknik, që për pasojë lë të paqartë edhe mënyrën si realizohet përfitimi i kompetencave në përkthim letrar dhe teknik. Edhe në syllabuset e lëndëve të ndryshme me të njëjtin emërtim vihet re përsëritje theksuar e tematikave dhe e literaturës. <i>GVJ rekomandon përditësimin e planit mësimor, për ndarjen e lëndëve të përkthimit në përputhje me emërtimin e programit</i>

	(teknik dhe letrar) dhe me arritjen e kompetencave në këto fusha specifike. Evidenca <i>Evidenca II.1 Plani mësimor,</i> <i>Evidenca 30-34, silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ-ja konstaton se bazuar në dokumentacionin e paraqitur, studentët që diplomohen në këtë program studimi, referuar përmbajtjes së tij, janë në gjendje të vijojnë studimet e mëtejshme në programe të ciklit të tretë. Gjithashtu programi mundëson pajisjen e studentëve me aftësi që i bën të përshtatshëm dhe konkurrues në tregin e punës dhe kërkesat e tij. Më konkretisht, përmes nxitjes për pjesëmarrje në konferenca, lëndës kërkim shkencor dhe përgatitjes së punimit të diplomës, studentët përgatiten për vijimin e studimeve të ciklit të tretë. Për sa i përket punësimit, krahas lëndëve që mundësojnë aftësimin praktik të studentëve si përkthyes, zhvillimi i praktikës profesionale në agjenci përkthimi dhe organizata të ndryshme i njeh studentët më nga afër me nevojat e tregut të punës dhe i përgatit për to. Evidenca <i>Evidenca II.17 Studim i tregut të punës</i> <i>Evidenca II.1 Plani mësimor</i>
Konkluzione	GVJ-ja konstaton se: - rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Përkthim teknik-letrar dhe interpretim" përcakton qartë mënyrën e organizimit, strukturën dhe përmbajtjen e programit duke bërë të mundur marrjen e njohurive dhe thellimin e tyre; - Ndarja për çdo lëndë në kredite bazuar në orët në auditor dhe të punës individuale, mundëson transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve; - Përmbajtja e programit garanton marrjen e njohurive të nevojshme për vazhdimin e studimeve të mëtejshme dhe punësimin e studentëve në fushën e përkthimit; <i>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit si dhe ndarjen e lëndëve të përkthimit në përputhje me</i>

	<i>emërtimin e programit (teknik dhe letrar) me qëllim arritjen e kompetencave në këto fusha specifike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Njësitë bazë të FGJH-së, përgjegjëse për programin e studimit, ecurinë dhe cilësinë e tij, bazohen në dokumentacionin rregullator të FGJH-së dhe të UT-së, për përmirësimin e cilësisë, krijimin e një kulture të cilësisë dhe përshtatjen e programit me nevojat e tregut. Në rregulloren e programit të studimit parashikohen procedurat e vlerësimit të brendshëm, aktorët që marrin pjesë në këtë proces si dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit. Gjatë procesit të përmirësimit dhe përshtatjes së programit Master i Shkencave në Përkthim teknik-letrar dhe interpretim janë marrë parasysh sugjerimet e studentëve të diplomuar, përvoja e universiteteve të huaja partnere, si dhe nevojat e nxjerra në pah nga studimi i tregut të punës kryer nga FGJH-ja. Evidenca <i>Evidenca I.14 Statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca II.8. Manuali i Cilësisë,</i> <i>Evidenca II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë,</i> <i>Evidenca II.22 Strategjia për sigurimin e cilësisë 2022-2024,</i> <i>Evidenca II.1 Dosja e programit,</i> <i>Evidenca II.25 Raport përmbledhës mbi pyetësorin,</i> <i>Evidenca II.17 Studimi i tregut të punës.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime	GVB-ja shprehet se me studentët dhe të diplomuarit mbahen kontakte dhe organizohen sondazhe përkatësisht për vlerësimin e

studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	mësimdhënies dhe programin e studimit. Në raport thuhet se pedagogët kanë organizuar takime me studentët në prag diplomimi në lidhje me pritshmëritë e tyre për programin e studimit, si dhe janë marrë mendimet e studentëve doktorantë në fushën e përkthimit. <i>Megjithatë, për GVJ-në mbetet e paqartë se si janë realizuar takimet dhe marrja parasysh e mendimeve të studentëve pasi nuk janë paraqitur evidenca që të mbështesin organizimin e këtyre veprimtarive.</i> Evidenca <i>Evidenca I.9 Raporti Vjetor kërkimor-shkencor 2021-2022,</i> <i>Evidenca I.10 Raporti vjetor kërkimor –shkencor 2022-2023.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në RVB thuhet se njësiti bazë të FGJH-së përgjegjëse për ofrimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, organizojnë veprimtari të përbashkëta me agjenci dhe organizata të fushës së përkthimit dhe kanë marrë në konsideratë sugjerimet e këtyre aktorëve në lidhje me kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për përkthyesit. Edhe pse në RVB janë paraqitur evidencat përkatëse për organizimin e këtyre eventeve, <i>mbetet e paqartë se si këto sugjerime janë përkthyer në masa konkrete dhe janë reflektuar në përshtatjen e programit të studimit.</i>
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se:</i> <i>Statuti i UT-së dhe Strategjia për sigurimin e cilësisë synojnë rritjen e cilësisë së programit të studimit dhe përditësimin e tij. Kjo realizohet me anë të përdorimit të instrumenteve përkatëse dhe përfshirjes së aktorëve të parashikuar në dokumente si Paketa e instrumenteve të cilësisë, dhe Manuali i Cilësisë;</i> <i>Për përmirësimin e programit të studimit, njësiti mbajnë kontakte me studentët aktualë dhe ata të diplomuar me qëllim marrjen edhe të sugjerimeve nga ana e tyre. Gjithashtu njësiti përgjegjëse ruajnë kontakte të vazhdueshme dhe marrin propozime nga rrjete profesioniste dhe shoqata të përkthimit.</i>

	<i>Megjithatë, <u>GVJ rekomandon</u> dokumentimin e sugjerimeve dhe takimeve të realizuara me studentët, të diplomuarit dhe institucionet partnere apo me rrjetet e profesionistëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit master i shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” është shprehur qartë misioni për përgatitjen e përkthyesve dhe interpretëve profesionalë që ndërmjetësojnë komunikimin me anë të njohurive të thella që u ofron programi. Gjithashtu, programi u mundëson studentëve fitimin e njohurive të thelluara për proceset përkthimore në fushën e përkthimit dhe interpretimit në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe etike. Këto objektiva janë në përputhje me objektivat e strategjisë së dhe misionin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe të Universitetit të Tiranës. Ndonëse Strategjia e Zhvillimit të UT-së dhe dhe strategjia e zhvillimit të FGJH-së kanë të përfshirë objektiva për zhvillimin e kërkimit shkencor përkatësisht objektivi 3 dhe objektivi 6. <i>GVJ-ja konstaton se në rregulloren e programit të studimit nuk ka objektiva të kërkimit shkencor dhe <u>sugjeron</u> përfshirjen e objektivave të kërkimit shkencor në rregulloren e programit të studimit.</i> Evidenca <i>Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i> <i>Evidenca I.6 Strategjia e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja</i> <i>Evidenca I.21 Rregullorja e programit të studimit</i> <i>Evidenca II.1 Dosja e programit të studimit,</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit,	Bazuar në Dosjen e Vetëvlerësimit si dhe në takimet me stafin akademik, konstatohet se veprimtaritë mësimore dhe ato

bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	akademike në programin e studimit bashkërendohen dhe administrohen nga njësia kryesore, FGJH, e cila bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, në Statutin e UT-së dhe në Planin e saj Strategjik, siguron ushtrimin e lirisë akademike të stafit akademik duke ua mundësuar këtë liri në zgjedhjen e literaturës, përdorimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe përdorimin e rezultateve të kërkimit. Kjo liri akademike është ushtruar nga grupet kërkimore-akademike edhe në përcaktimin e fushave të kërkimit dhe në pjesëmarrjen në projekte si në nivel fakulteti dhe në nivel ndërkombëtar. Evidenca <i>Evidenca I.1 Statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca I.3 Plani strategjik i UT-së 2023-2028,</i> <i>Evidenca I.6, Strategjia e FGJH-së,</i> <i>Evidenca I.10 Raporti vjetor mësimor-kërkimor 2022-2023,</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Referuar të dhënave në DVV, GVJ vëren se programi i studimit mundëson, nxit dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Angazhimi i studentëve në konferenca është parashikuar edhe në rregulloren për organizimin e konferencave. Bazuar në të dhënat e tabelës 22, 7 studentë janë aktivizuar në projekte shkencore në rang departamenti, 2 në projekte në rang fakulteti, 29 në kërkime shkencore individuale të pedagogëve, dhe 2 në projekte në bashkëpunim me të tjerë. Gjatë takimeve me stafin, u konstatua se angazhimi i studentëve në kërkim shkencor realizohet edhe me anë të punimeve në secilën lëndë sipas programit mësimor si dhe nëpërmjet realizimit të punimit të diplomës. Evidenca <i>Evidenca I.1 Statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca II.26 Rregullore për organizimin e konferencave,</i> <i>Shtojca Tabela 22</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet	Mbështetur në dokumentacionin e DVV-së dhe në takimet me stafin, GVJ-ja konstaton se bazuar në kuadrin rregullator të UT-së dhe FGJH-së, organizimi dhe realizimi i aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore në lidhje me programin e

financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	studimit, kryhet me mbështetjen e dekanatit dhe njësive bazë të angazhuara në realizimin e programit të studimit. Financimi i konferencave rregullohet sipas parashikimeve në rregulloren e konferencave. Ndërkohë që realizimi i kërkimit shkencor është bërë me anë të organizimit të konferencave shkencore në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë nëpërmjet programit të doktoratës në të njëjtën fushë, nëpërmjet pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca ndërkombëtare, dhe botimit të punimeve në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Evidenca <i>Evidenca I.1 Statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca I.6 Strategjia e zhvillimit të FGJH-së</i> <i>Evidenca II.26 Rregullore për organizimin e konferencave</i>			
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se:</i> - <i>programi i studimit Master i Shkencave në "Përkthim teknik-letrar dhe interpretim i ka të përcaktuar qartë objektivat kryesore të studimit. Mbështetur në objektivat e përcaktuar në strategjinë e UT-së dhe të FGJH-së, njësia kryesore dhe njësitë bazë që sigurojnë ofrimin e programit të studimit, bashkërendojnë dhe realizojnë veprimtarinë mësimore dhe kërkimore;</i> - <i>Për realizimin e këtyre objektive, njësitë mundësojnë angazhimin e studentëve në projekte kërkimore në rang njësie, fakulteti dhe punime shkencore në bashkëpunim me pedagogë.</i> - <i>GVJ sugjeron përcaktimin dhe përfshirjen e objektive në lidhje me kërkimin shkencor në rregulloren e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

37

Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ konstaton se në Strategjinë e Zhvillimit të FGJH-së, projektet kërkimore konsiderohen një nga shtyllat kryesore për fuqizimin e njësive dhe vënien e dijes dhe kërkimit shkencor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Njësia kryesore ka hartuar strategjinë për kërkimin shkencor, e cila përfshin si pikë të rëndësishme mbështetjen e kërkimit shkencor dhe lidhjen e tij me mësimdhënien. Përmes angazhimit në projekte bashkëpunimi me institucione të tjera është mundësuar dhe realizuar pjesëmarrja e stafit akademik në programe shkëmbimi, çfarë ka rritur edhe mundësinë e bashkëpunimit për pjesëmarrje në projekte të përbashkëta në lidhje me kërkimin shkencor. Si nga dokumentacioni në DVV edhe nga takimet me stafin akademik, GVJ konstaton se njësia kryesore bashkërendon dhe menaxhon bashkëpunimin ndërmjet të gjitha njësive dhe strukturave me qëllim realizimin e veprimtarive në lidhje me kërkimin shkencor. Megjithatë mungesa e objektivave të programit të studimit në lidhje me kërkimin shkencor e bën të paqartë se si veprimtaritë e realizuara janë në funksion të arritjes së objektivave në lidhje me kërkimin shkencor. <i>GVJ sugjeron përfshirjen e objektivave në lidhje me kërkimin shkencor në rregulloren e programit të studimit.</i> Evidenca <i>Evidenca I.6 Strategjia e FGJH-së,</i> <i>Evidenca II.28 Strategjia e FGJH-së për kërkimin shkencor,</i> <i>Evidenca I.9 dhe I.10 Raporte vjetore mësimore kërkimore 2021-2022, 2022-2023</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për	GVJ konstaton se njësia kryesore nxit pjesëmarrjen e stafit në projekte dhe kërkim shkencor me anë të organizimit të ditëve informative dhe trajnimeve të ndryshme, siç është trajnimi për shtimin e projekteve. Mbështetja e kërkimit shkencor realizohet edhe me anë të financimit nga vetë UT-ja e projekteve të vogla si dhe me anë të vënies në dispozicion të laboratorëve, pajisjeve dhe infrastrukturës.

realizimin e këtyre objektivave.	Koordinimi për aplikimin dhe realizimin e projekteve realizohet me anë të Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, gjë që ka çuar në promovimin e frymës së bashkëpunimit ndërmjet njësisë përgjegjëse dhe qendrave kërkimore brenda dhe jashtë vendit. FGJH-ja i ka kushtuar rëndësi edhe angazhimit të studentëve në kërkim shkencor si trajnimi dhe mentorimi për kërkim shkencor, angazhimi në projekte kërkimore, dhe financimi i projekteve të studentëve. Në funksion të këtyre, realizohet konferenca studentore. Gjithashtu për realizimin e objektivave kërkimore shkencore, njësia bashkëpunon me sektorin privat duke mundësuar sigurimin e të dhënave për kërkim shkencor, gjë që realizohet nëpërmjet projekteve dhe angazhimit të studentëve në kuadër të praktikave apo temave të diplomave. Evidenca <i>Evidenca I.2 Statuti i UT-së</i> <i>Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i> <i>Evidenca I.19 Memorandume bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale,</i> <i>Evidenca II.29 Dosje e praktikës së studentit,</i> <i>Shtojca Tabela 19</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Referuar të dhënave në DVV, GVJ-ja vëren se realizimi i konferencës shkencore është ndër objektivat e FGJH-së, dhe për pasojë njësia kryesore organizon konferencën vjetore të fakultetit dhe konferencën e studentëve, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për angazhim në kërkim shkencor. Referuar të dhënave rezulton se në vitet e fundit janë realizuar mbi 60 punime individuale të pedagogëve, mbi 30 projekte të fituara në rang fakulteti ose departamentesh, dhe 12 aktivitete shkencore të organizuara nga njësia kryesore. Gjithashtu FGJH-ja mundëson publikimin e rezultateve të kërkimit shkencor realizuar nga stafi në revistat shkencore të fakultetit. Në të njëjtën kohë, GVB shprehet se për të nxitur angazhimin e studentëve në veprimtari dhe kërkim shkencor, FGJH-ja mundëson botimin e punimeve më të mira në revistat shkencore të fakultetit. E gjithë kjo veprimtari raportohet në

	mënyre periodike vjeçare nga stafi dhe pasqyrohet në raportet vjetore të njësisë. Bazuar në të dhënat në RVB, numri i studentëve të angazhuar në kërkim shkencor është gjithsej 40 ku departamenti i gjuhës gjermane ka 24 studentë të angazhuar, ai i gjuhës italiane 1, i gjuhës turke 12, dhe i gjuhës spanjolle 1. Departamenti i gjuhës frënge ka raportuar zero angazhim të studentëve, ndërkohë që për departamentet e anglishtes dhe greqishtes, referuar po tabelës 22, nuk është raportuar asnjë e dhënë. <i>GVJ sugjeron analizimin e angazhimit të studentëve në kërkim shkencor për secilin departament dhe përfshirjen e të dhënave në raporte analitike.</i> Evidenca <i>Evidenca I.6 Strategjia e FGJH-së,</i> <i>Evidenca I.9 dhe Evidenca I.10 raportet vjetore mësimore-kërkimore Shtojca Tabela 19 Lista e konferencave</i> <i>Shtojca Tabela 22 Angazhimi i studentëve në kërkim shkencor</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Përgatitja e profesionistëve konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës në të gjitha fushat e studimit, është pjesë e strategjisë së ndërkombëtarizimit të FGJH-së, e cila parashikon dhe synon integrimin e kompetencave ndërkombëtare dhe ndërkulturore në kurrikulën e programit. Kjo realizohet edhe me anë të pjesëmarrjes së studentëve në programe shkëmbimi, Erasmus+, internshipe ndërkombëtare dhe shkolla verore. Programi siguron mundësinë e praktikimit të dijeve dhe përgatitjen për tregun e punës nëpërmjet angazhimit në përkthim simultan në organizata si Parlamenti Evropian, Komisionin Evropian, Gjykata e Drejtësisë së BE, etj. Evidenca <i>Evidenca I.11 Strategjia e ndërkombëtarizimit,</i> <i>Evidenca II.6 Marrëveshja me universitetin e Strasburgut</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat,	Siç shprehet GVB, në fazën e konsultimeve për ligjin për përkthyesit zyrtarë, janë kryer konsultime me FGJH-në për vendosjen e kriterëve në licencimin e përkthyesve. Megjithatë

shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	GVB nuk është shprehur se si rekomandimet e këtyre urdhreve merren parasysh dhe zbatohen në lidhje me programin e studimit. Evidenca <i>Evidenca Regjistri elektronik për njoftime dhe konsultime publike.</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Profesioni i përkthyesit, sipas ligjit nr 10 171 datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” nuk është profesion i rregulluar.			
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se:</i> - <i>programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Njësia kryesore angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave;</i> - <i>Një tjetër mjet për realizimin e tyre është edhe organizimi i konferencave nga njësia kryesore;</i> - <i>Gjithashtu programi i studimit synon përgatitjen e profesionistëve konkurrues në tregun e punës;</i> - <i>GVJ sugjeron analizimin e angazhimit të studentëve në kërkim shkencor dhe përfshirjen e këtyre të dhënave në raporte.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

			X	
--	--	--	---	--

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në dokumentacion e përfshirë në DVV, GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” është i organizuar me 120 kredite sipas sistemit “European Credit Transfer System” (ECTS) dhe realizohet me kohë të plotë në dy vite akademike të ndara në katër semestra. Mësimdhënia dhe të nxënit në këtë program rregullohet në mënyrë të detajuar në Statuti, Rregulloren e UT-së dhe FGJH-së, dhe rregulloren e programit të studimit, me miratimin e institucionit. Në përputhje me VKM 41/2018 për “Elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, format kryesore të mësimdhënies përfshijnë leksione, seminare, praktikë, diplomë, të parashikuara në silabuset e lëndëve. Gjatë vizitës, GVJ konstatoi se procesi mësimor realizohet në forma audio-vizuale nëpërmjet infrastrukturës dhe hapësirave digjitale që ofron Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Gjithashtu njësisia kryesore organizon leksione të hapura me lektorë të ftuar, studiues apo profesionistë të fushës specifike ose të gjerë të programit të studimit. Evidenca <i>Evidenca I.1 statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH,</i> <i>Evidenca I.21 Rregullore e programit të studimit,</i> <i>Evidenca III.2 Tabela 13 ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies,</i>

	<i>Evidenca II.1 Programet mësimore të lëndëve,</i> <i>Evidenca III.4 Plani i miratuar mësimore 2023-2025,</i> <i>Evidenca III.5 Konferenca,</i> <i>Evidencat III.7-10 Leksione të hapura</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	GVJ konstaton se për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor, vlerësimin e studentëve dhe literaturën e materialet e përdorura, personeli akademik respekton rregullat e institucionit. Në varësi të specifikës së secilës lëndë, pedagogu zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies, të aktivizimit të studentëve, dhe kombinojnë aspektin teorik me atë praktik duke nxitur diskutimin dhe ndërveprimin. Këto forma u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve për punën individuale dhe në grup, për nxitjen e mendimit kritik dhe zbatimin e punëve me karakter aplikativ dhe praktik. Pedagogët përdorin edhe platforma online, Teams, e vënë në dispozicion gjatë pandemisë, por që ka përdorim të gjerë edhe në vazhdim. Evidenca <i>Evidenca 1.21 Rregullore e programit të studimit,</i> <i>Evidenca II.1 Programet mësimore të lëndëve,</i> <i>Evidenca III.2 tabela 13 ngarkesa totale në auditor e studentëve,</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Referuar RVB-së dhe materialeve informuese në DVV, GVJ konstaton se UT organizon aktivitete trajnimi në mënyrë periodike për personelin akademik, lidhur me përmirësimin e kompetencave didaktike në drejtim të përdorimit të metodave inovative në mësimdhënie, me qëllim arritjen e objektivave të programit të studimit dhe të secilës lëndë, dhe në përputhje me rezultatet e të nxënit për programin e studimit. Për këtë qëllim, UT ka ngritur edhe qendrën virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional. GVJ konstaton se në mbështetje të realizimit të një mësimdhënieje cilësore dhe bashkëkohore, FGJH-ja ka ngritur infrastrukturë mbështetëse informatike dhe teknologjike, çka lehtëson procesin e përdorimit të metodave të ndryshme sipas programit lëndor specifik.

	Evidenca <i>Evidenca I. Statuti i UT,</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidenca I.7 Vendim për ngritjen e Qendrës Virtuale për trajnim dhe zhvillim profesional,</i> <i>Evidenca III.12 Trajnime UT,</i> <i>Evidenca III.13 Afishe: Java e teknologjisë,</i> <i>Evidenca III.14 Email njoftues për trajnim,</i> <i>Evidenca III.15 Klasa TEAMS- Technology training for FGJH.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga profesorë të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit. GVJ konstaton se personeli akademik është i formuar në gjuhën angleze dhe specializuar në drejtime të ndryshme të përkthimit apo gjuhësisë dhe ka specializime të ndryshme sipas fushave, çka i bën kompetentë për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve dhe përdorimin e metodave interaktive të mësimdhënies me në qendër studentin. Gjithashtu gjatë takimeve me personelin akademik dhe me studentët, GVJ konstatoi se në njësi sigurohet udhëheqja, mbështetja dhe ndërtimi i marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes personelit dhe studentëve. Kjo marrëdhënie respekton rregullat e komunikimit dhe etikës institucionale dhe karakterizohet nga një frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi. Gjithashtu personeli akademik vendos për studentët orare konsultimi jashtë orarit të leksioneve, për të maksimizuar prezencën e tij në asistimin e problematikave të ndryshme. Evidenca <i>Evidenca II.1 Dosja e programit /CV-të e stafit,</i> <i>Evidencë III.19 Plan i mësimor i lidhur me personelin akademik,</i> <i>Evidencë III.20 Udhëzimi 29, dt 10.09.2028 {Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL,</i> <i>Evidencë III.17-18 Tabelat përmbledhëse të stafit akademik,</i> <i>Evidencë III.21 Orare konsultimi me studentët</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe	GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja kanë të përfshira në strategji përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës dhe rritjes së cilësisë.

përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Tërheqja e mendimit të tyre realizohet nga përfaqësimi në organe dhe struktura të UT-së si dhe nga të dhënat e mbledhura në pyetësorët me studentët të cilat realizohen në bazë të manualit të Cilësisë. Pas marrjes së informacionit, NJSBC-ja organizon takime me personelin akademik dhe bën të njohura rezultatet, së bashku me rekomandimet dhe pikat e dobëta të evidentuara nga studentët. Më pas, pedagogët bazuar në nevoja vlerësojnë dhe përmirësojnë format e mësimdhënies. Evidenca <i>Evidenca I.1 Statuti i UT,</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidenca II.8 Manuali i Cilësisë,</i> <i>Evidenca III.22-23, Raport vlerësimi vjetor për studentin dhe pedagogun nga NJSBC,</i> <i>Evidenca III.25 Model i pyetësorit të studentëve</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ konstaton se për të garantuar ruajtjen e standardeve të cilësisë së programit të studimit dhe në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e institucionit, Universiteti i Tiranës ka ngritur njësi dhe struktura të tjera siç janë Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimi i Cilësisë, Drejtoria e Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave, si dhe Drejtoria e Kërkimit shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Këto njësi bashkërendojnë aktivitete me njësitë kryesore me qëllim që të promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në të gjitha njësitë dhe programet e Universitetit të Tiranës. Si organi më i lartë drejtues, Senati Akademik, në funksion të përmirësimit të cilësisë ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë dhe Komisionin e Kurrikulave, të cilat kanë në fokus sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit si dhe vlerësimin e projekt-programeve të paraqitura nga njësitë kryesore dhe bazë. Një strukturë e rëndësishme për promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është edhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë, e cila funksionon si njësi e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Duke u koordinuar me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC-ja ka në fokus edhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. GVJ konstaton se në planin strategjik të zhvillimit, UT ka të parashikuar objektivat për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve dhe të metodave dhe rezultateve të

	mësimdhënies. Realizimi i këtyre objektivave kryhet me koordinimin e strukturave dhe njësive përgjegjëse, të cilat mbështesim eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies duke organizuar veprimtari kërkimore-shkencore ose trajnuese për këtë qëllim. Evidenca <i>Evidenca III.24 Struktura organizative e rektoratit të UT-së,</i> <i>Evidenca I.1 Statuti i UT, Kreu II, Kreu III neni 29, nenit 37, nenet 41-42,</i> <i>Evidencë II.9 Vendim i FGJH-së për ngritjen e NJSBC-së,</i> <i>Evidencë I.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se</i> <i>-Fakulteti i Gjuhëve të Huaja e realizon procesin e mësimdhënies, aftësimit profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin dhe duke rekrutuar personel akademik të pajisur me grada shkencore të nevojshme për mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve për programin Master i Shkencave në "Përkthim teknik-letrar dhe interpretim".</i> <i>-Fusha specifike e stafit përkon me fushën e lëndëve që mbulojnë. Për të garantuar sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe përdorimin e metodave interaktive që nxisin mendimin krijues dhe atë kritik;</i> <i>-Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja kanë ngritur strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë, në të cilën janë përfshirë edhe studentët. Raportimi i përgatitur nga anketat me studentët diskutohet nga NJSBC-ja me pedagogët e çdo njësie;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ-ja konstaton se kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave që merr studenti janë të bazuara në rregulloret dhe procedurat e vendosura në aktet rregullative të UT-së dhe FGJH-së, si dhe në rregulloren e programit të studimit. Këto rregullore parashikojnë të gjithë elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup dhe provime të ndërmjetme e përfundimtare. Mënyra e vlerësimit të dijeve jepet e detajuar në silabusin e çdo lënde dhe varion sipas specifikave të saj si më poshtë: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Komponenti</th><th>Përqindja</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td><td>10-20%</td></tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, laboratorike, etj.)</td><td>20-30%</td></tr> <tr> <td>Testime gjatë vitit</td><td>20%</td></tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td><td>40-50%</td></tr> <tr> <td>Totali</td><td>100%</td></tr> </tbody> </table> Evidenca <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidencë II.1 Syllabuset e lëndëve,</i> <i>Evidencë III.27 Format e kontrollit të dijeve.</i>	Komponenti	Përqindja	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10-20%	Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, laboratorike, etj.)	20-30%	Testime gjatë vitit	20%	Provimi përfundimtar	40-50%	Totali	100%
Komponenti	Përqindja												
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10-20%												
Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, laboratorike, etj.)	20-30%												
Testime gjatë vitit	20%												
Provimi përfundimtar	40-50%												
Totali	100%												
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët vihen në dijeni që në fillim të vitit akademik mbi format e kontrollit të njohurive, metodologjinë e testimit si dhe sistemin e vlerësimit. Metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive parashikohet në një sërë aktesh rregullatore si Rregullorja e UT, Rregullorja e njësisë kryesore FGJH, etj. Publikimi i akteve rregullatore në faqen web të institucionit lehtëson njohjen dhe aksesimin nga studentët. Metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive është komponent i syllabusit të lëndëve me të cilën studentët pajisen nga pedagogët e lëndëve që në fillim të procesit akademik.												

	Evidenca <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidenca I.21 Rregullore e programit të studimit,</i> <i>Evidencë II.1 Syllabuset e lëndëve,</i> <i>Evidencë III.21 Udhërrëfyesi i FGJH-së</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se sipas seksionit të rregullave për provimet përcaktuar në rregulloren e UT, të FGJH dhe të programit të studimit, studentët testohen për njohuritë dhe dijet e marra nëpërmjet një larmie mënyrash siç janë pjesëmarrja në seminare dhe aktivizimi gjatë tyre, detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe provimi final. Një komponent i rëndësishëm vlerësimi në këtë program studimi është edhe praktika profesionale, si dhe realizimi i tezës së diplomës si detyrim përmbyllës i programit të studimit. Format e kontrollit të njohurive janë të përcaktuara qartë dhe të ndara në përqindje dhe janë të përfshira edhe në silabusin e çdo lënde: -Pjesëmarrja dhe angazhimi gjatë seminareve – 10 %; -Provimi i ndërmjetëm 20-30 %; Kontrolli i vazhdueshëm 20-30 %; -Provimi përfundimtar 50-60 %; Evidenca <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-s,</i> <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidencë I.21 Rregullorja e programit të studimit,</i> <i>Evidencë II.1 Silabuset e lëndëve,</i> <i>Evidencë III.29-30 Model teze me shkrim dhe me gojë,</i> <i>Shtojca Tabela 15</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: -Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e institucionit; -Në fillim të çdo semestri studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive dhe dijeve të

	<i>parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit si dhe me përqindjen përkatëse të secilit komponent;</i> <i>-Për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore përdoren forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se pjesë e rëndësishme e programit të studimit është vlerësimi dhe testimi i vazhdueshëm i aftësive, dijeve dhe njohurive të studentit, i cili realizohet përgjatë gjithë semestrit ose vitit akademik, në varësi të lëndës. Ky kontroll dhe vlerësim është në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL” dhe përbëhet nga komponentë të përfshirë në këtë VKM si: kontroll i vazhdueshëm me anë të detyrave të kursit dhe prezantimeve, testime me shkrim dhe me gojë, si dhe mbrojtja e punimit të diplomës. Sistemi i pikëzimit është i reflektuar në syllabusin e çdo lënde: Pjesëmarrja dhe angazhimi gjatë seminareve – 10 %; Provimi i ndërmjetëm 20-30 %; Kontrolli i vazhdueshëm 20-30 %; Provimi përfundimtar 50-60 %; Këto raporte ndryshojnë në varësi të lëndës dhe u bëhen të ditura studentëve në fillim të semestrit. Format e testimit dhe vlerësimit të dijeve janë të parashikuara në rregulloret përkatëse të institucionit. Evidenca

	<i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së neni 37, 45,</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e FGJH-së neni 34, 41, 42, 44,</i> <i>Evidencë II.1 Silabuset e lëndëve,</i> <i>Evidencë I.21 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Referuar informacionit në RVB, kriteret dhe procedurat e vlerësimit të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët janë të rregulluara me anë të përfshirjes së tyre në statutin dhe rregulloren e UT-së, në rregulloren e FGJH-së, në rregulloren e programit të studimit si dhe në rregulloren e provimeve. Një mënyrë që institucioni ka vënë në përdorim për korrigjimin e provimeve nëpërmjet sistemit informativ të teknologjisë është sistemi Clean score, me anë të së cilit synohet rritja e transparencës në vlerësim dhe shmangia e çdo lloj abuzimi. Gjithashtu, referuar RVB-së dhe takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se natyra e programit të studimit lë vend edhe për kryerjen e testeve kryesisht sipas mënyrës tradicionale nën mbikëqyrje në auditorë, me shkrim ose me gojë në varësi të lëndës, ndërkohë që për dorëzimin e detyrave apo projekteve përdoret sistemi Teams. Evidenca <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidencë I.21- Rregullore e programit të studimit,</i> <i>Evidencë III.31-32 Screenshot/Detyrë kursi në platformën Teams (gjuhë angleze dhe frënge)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga dokumentacioni në DVV, GVJ-ja konstaton se format e vlerësimit gjatë vitit dhe ai përfundimtar janë të parashikuara në silabuset e lëndëve. Ndërkohë që referuar RVB-së, vlerësimi përfundimtar realizohet nga komisioni i provimeve i përbërë nga të paktën dy pedagogë, dhe që ngrihet nga përgjegjësi i departamentit. <i>Për GVJ-në mbetet e paqartë nëse komisioni ngrihet për realizimin e vlerësimit përfundimtar të lëndës apo vetëm për vlerësimin e provimit final, ndërkohë që ky i fundit bazuar në kriteret më lart ka një peshë të caktuar në notën përfundimtare të lëndës.</i>

	Evidenca <i>Evidencë I.5 Rregullore e FGJH-së neni 34, 41, 42, 44,</i> <i>Evidencë II.1 Silabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Referuar takimeve me stafin dhe studentët, GVJ konstaton se në programin e studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” studentët krahas vlerësimit për dijet dhe aftësitë, marrin edhe komente ose këshilla, të cilat u shërbejnë si pika referimi për të rritur cilësinë e të nxënimit dhe për t’u aftësuar më shumë nga ana profesionale. Një pikë e fortë e këtij këshillimi janë konsultimet që studentët bëjnë me pedagogët si pjesë e vlerësimit dhe mundësisë për përmirësim. Studentët njihen me rezultatin e provimit me gojë nga komisioni në përfundim të provimit, dhe për provimin me shkrim brenda 10 ditëve nga data e provimit. Evidenca <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së, neni 49, 51,</i> <i>Evidencë 1.21 Rregullore e programit të studimit,</i> <i>Evidencë III.34 Rregullore për funksionimin e sistemit informativ</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga RVB-ja dhe dokumentacioni në DVV, si dhe nga takimet në institucion, GVJ-ja eidenton se stafi është i angazhuar të ketë në fokus integritetin akademik të studentëve duke shmangur plagjiaturën dhe kopjimin në provime apo detyra. Rregullat për zhvillimin e provimeve, ndalimin e kopjimit e plagjiaturës, si dhe respektimin e Kodit të Etikës janë të parashikuara në rregulloren e përgjithshme e UT-së dhe në rregulloren e programit të studimit, sipas të cilave gjatë provimeve është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit dhe teknologjisë. Sipas RVB-së dhe stafit, natyra e programit të studimit, e bën të kuptueshëm lejin e përdorimit të fjalorit gjatë 30 minutave të para të provimit. Gjithashtu respektimi i rregullave gjatë provimit mundësohet edhe nga prezenca e komisionit të provimit, i cili mbikëqyr me kujdes të gjithë procesin deri në përfundim. Për detyra të ndryshme, edhe pse lejohet përdorimi i përkthimit automatik me anë të aplikacioneve të ndryshme, studenti është i detyruar të kryejë redaktimet e nevojshme, të cilat janë lehtësisht të verifikueshme nga pedagogu i lëndës. Ndonëse në

	rregullore parashikohet ndalimi dhe ndëshkimi i plagjiaturës, çka u përmend edhe gjatë takimit me stafin akademik, nuk është e qartë nëse institucioni ka vënë në dispozicion softuerë apo platforma të kontrollit të plagjiaturës, sidomos për kontrollin e punimeve të diplomës. <i>GVJ rekomandon ofrimin e një platforme antiplagjaturë për të shmangur plagjiaturën dhe siguruar origjinalitetin e punimeve të diplomës.</i> Evidenca <i>Evidencë III.36 Kodi i Etikës i UT,</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidencë I.21 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se studentët e programit të studimit vlerësohen për dijet dhe aftësitë e fituara në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e UT-së dhe atë të programit të studimit, sipas meritës dhe në afate kohore të përcaktuara në këto të fundit. Vlerësimi bëhet në bazë të meritës dhe reflekton një kombinim formash të vlerësimit të folur dhe të shkruar, të vazhdueshëm dhe përfundimtar. Tezat e provimeve hartohen duke marrë në konsideratë nivele të ndryshme njohurish, duke filluar nga më e thjeshta tek më e ndërlikuara. Pas korrigjimit të provimeve, procesverbalet dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 10 ditëve nga data e zhvillimit të provimit, sipas përcaktimit në rregullore. Në fund të programit studentët njihen me notën mesatare të ponderuar e cila merr në konsideratë kreditet e marra për çdo veprimtari formuese të lëndës, me të cilën studentët janë njohur në fillim të semestrit. Evidenca <i>Evidenca III.34 Rregullore për funksionimin e sistemit informativ, neni 11</i> <i>Evidencë III.35 Manual Sistemi E-student,</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidencë I.21 Rregullore e programi të studimit</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e	GVJ konstaton se rregulloret përkatëse të institucionit i garantojnë studentit të drejtën të njihet me vlerësimin e

studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	provimeve të realizuara sipas afateve të përcaktuara në to. Gjatë takimit me studentët, u vu në dukje transparenca në vlerësim si dhe vlerësimi me rubrika të ndryshme gjatë gjithë vitit. Gjithashtu rregulloret e UT-së i garantojnë studentit edhe të drejtën për të parashtruar kërkesë për rishikim të vlerësimit në rast mosdakordësie. GVJ-ja konstaton se <i>neni 61</i> i Rregullores së UT-së parashikon të drejtën e studentit brenda 24 orëve pas shpalljes së notave për ankimim note. Me miratim të dekanit ngrihet komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton, me miratim të dekanit, notën përfundimtare të studentit për lëndën përkatëse. Evidenca <i>Evidencë III.34 Rregullore për funksionimin e sistemit informativ,</i> <i>Evidencë III.35 Manual Sistemi E-student,</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidencë I.21 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Rregullorja e UT-së parashikon të drejtën e studentit për ankimim note në rast mosdakordësie. Studenti ka të drejtë të paraqesë kërkesën tek përgjegjësi i njësisë bazë, i cili në zbatim të parashikimeve të rregullores njofton dekanin, dhe ky i fundit ngre komisionin ad-hoc për vlerësimin dhe verifikimin e pretendimeve të studentit. Komisioni ad-hoc përcakton vlerësimin përfundimtar të studentit. Më pas rezultatet e ankimimit paraqiten tek drejtuesi i njësisë kryesore sipas afateve të përcaktuara në rregullore si dhe bëhet informimi i pedagogut të lëndës dhe drejtuesit të njësisë bazë. Evidenca <i>Evidencë III.34 Rregullore për funksionimin e sistemit informativ,</i> <i>Evidencë III.35 Manual Sistemi E-student,</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore</i>
Konkluzione	GVJ-ja konstaton se: - Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja kanë hartuar një kuadër rregullator të konsoliduar, me rregullore të përgjithshme të institucionit, fakultetit,

	programit të studimit dhe njësive administrative, të cilat garantojnë vlerësimin transparent të studentit dhe i japin atij të drejtën të realizojë procedurën e ankimimit të notës sipas procedurës së parashikuar në rregullore; - FGJH mundëson vlerësimin fizik por edhe në format elektronik me anë të sistemit Cleanscore; - Shpallja e rezultateve të provimeve bëhet sipas parashikimeve në rregullore. Institucioni ka marrë masat për të ndaluar kopjimin si dhe masat përkatëse në rast shkeljeje; - <u>GVJ rekomandon</u> ofrimin e një platforme antiplagjaturë për të shmangur plagjaturën dhe siguruar origjinalitetin e punimeve të diplomës, si dhe përcaktimin e rolit të komisionit në vlerësimin përfundimtar të lëndës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim, me planin mësimor që ofron, dhe me angazhimin e studentëve në auditor, punë individuale, dhe me anë të provimeve,u mundëson studentëve thellimin e njohurive të thella në fushën e përkthimit dhe interpretimit. Me anë të orëve praktike dhe infrastrukturës së ofruar, programi mundëson edhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve në fushën e përkthimit dhe interpretimit. Ndërkohë që ekuilibri mes këtyre dy aspekteve rregullohet me anë të ndarjes së lëndëve sipas veprimtarive në bazë, karakterizuese ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse në përshtatje me VKM 41, datë 24.01.2018, sipas evidencës shtesë për ndarjen e këtyre veprimtarive, përqindjet e secilës kategori formuese nuk janë në përputhje me VKM.

	Evidenca <i>Evidenca I.21 Rregullore e programit të studimit,</i> <i>Evidenca III.3 Plani mësimor i programit të studimit,</i> <i>Evidenca shitesë 14 Plani mësimor sipas veprimtarive formuese</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në RBV dhe në DVV, GVJ konstaton se në përfundim të programit të studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”, studentët njohin dy gjuhë të huaja në nivel të lartë dhe një gjuhë të huaj të tretë në nivel mesatar, si dhe arrijnë të pajisen me njohuri të thelluara të parimeve dhe teknikave të përkthimit dhe interpretimit. Ndonëse në programin e studimit nuk ka lëndë specifike për zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë, gjatë takimeve me stafin dhe studentët u përmend se programi garanton zhvillimin e aftësive në përdorimin e mjeteve informatike dhe teknologjike. Mungesa e një lënde specifike për zhvillimin e aftësive teknologjike e lë zhvillimin e tyre disi të paqartë dhe të pagarrantuar. Për të garantuar ofrimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë, <i>GVJ sugjeron përfshirjen në programin e studimit të lëndëve specifike që ofrojnë dhe garantojnë zhvillimin e këtyre aftësive.</i> Evidenca <i>Evidencë III.3 Plani mësimor i programit të studimit,</i> <i>Evidencë II.7 marrëveshja me universitetin e Strasburgut</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Bazuar në RVB dhe në materialet në DVV, konstatohet se programi i studimit dhe syllabuset e lëndëve përmbajnë ndarjen sipas veprimtarive formuese, dhe objektivat, aftësitë dhe kompetencat që pritet të fitojë studenti, si dhe mënyra e vlerësimit të arritjes së këtyre kompetencave me anë të komponentëve të ndryshëm. Gjatë takimeve me stafin dhe me studentët, u konstatua se në përfundim të lëndëve dhe programeve lëndore, aftësitë dhe kompetencat analizohen dhe shqyrtohen, dhe nëse është e nevojshme, nëpërmjet metodave të ndryshme, studentëve u jepen edhe rekomandime apo këshilla me qëllim përmirësimi në të ardhmen. Bazuar në këto vërejtje, pedagogu bën orientimin e duhur me qëllim që studenti të arrijë

	përmbylljen e detyrimeve dhe arritjen e kompetencave për përfundimin me sukses të programit të studimit. Evidenca <i>Evidencë II.1 Programet lëndore,</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ konstaton se me anë të veprimtarive të ndryshme dhe formave të vlerësimit, siç janë detyrat e kursit, projektet, përdorimi i laboratorëve të përkthimit, dhe praktikave profesionale, mundësohet realizimi i mësimdhënies bazuar në kompetenca. Pjesëmarrja në programe mobiliteti ka mundësuar përdorimin e metodave bashkëkohore nga stafi akademik. Gjatë takimit me studentët, këta të fundit u shprehën se institucioni mbështet studentët të zhvillojnë aftësitë nëpërmjet punës në grup, diskutimeve për zgjidhjen e çështjeve të caktuara, duke krijuar kështu një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve. Nxitja e punës në grup realizohet sidomos nëpërmjet detyrave të kursit apo ekspozive në varësi të lëndëve. Për më tepër, institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve, çka mundëson njohjen e tyre më nga afër me ide inovative dhe studime kërkimore të zhvilluara në vende të BE-së. Marrëveshje janë nënshkruar edhe me aktorë të tjerë të sektorit publik dhe privat, dhe të shoqërisë civile për të krijuar më shumë hapësira dhe mundësi si për stafin edhe për studentët. Evidenca <i>Evidencë II.1 Programi lëndor i programit të studimit,</i> <i>Evidencë I.19 Lista e marrëveshjeve të FGJH,</i> <i>Evidencë III.38 Manuali i praktikës profesionale,</i> <i>Evidencë II.6 marrëveshje me universitetin e Strasburgut</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë	Bazuar në materialet në DVV dhe gjatë takimeve me stafin, GVJ konstaton se personeli akademik është i angazhuar që të përfshijë në mënyrë të vazhdueshme të reja e teknologjisë dhe të shkencës. Kjo realizohet si gjatë leksioneve edhe me anë të orëve të hapura apo seminareve të ndryshme. Një mënyrë me anë të së cilës stafi njihet me këto të reja është përfshirja e tij në programe mobiliteti, konferenca kombëtare e ndërkombëtare si

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	dhe projekte të ndryshme, veprimtari të cilat më pas mundësojnë integrimin e përvojës së fituar në leksionet në auditorë ose në leksione të hapura. Gjithashtu institucioni organizon leksione të hapura me lektorë të ftuar, si pjesë e veprimtarive ekstra-kurrikulare ose e projekteve të bashkëpunimit, të cilat kontribuojnë në njohjen e studentëve me zhvillimet më të fundit kryesisht në fushën e përkthimit. Evidenca <i>Evidencë III.7 Leksion i hapur, Dept i gjuhës gjermane projekti READ/AADF,</i> <i>Evidencë III.39 Workshop nga grupi i gjuhës italiane për përkthimin letrar,</i> <i>Evidencë III.8 Leksion i hapur mbi karrierën dhe mundësitë,</i> <i>Evidencë III.9 Workshop mbi përkthimin,</i> <i>Evidencë III.-10, Sfida e përkthimit letrar,</i> <i>Evidencë 40-41 Workshop mbi përkthimin sipas qasje konjitivo-funksionale,</i> <i>Evidencë III.41 Konferencë Shkencore me Universitetin e Korfuzit,</i> <i>Evidencë 42.1, 2, 3 Informacion mbi mobilitetin.</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ konstaton se nëpërmjet politikave dhe parashikimeve në Statut, marrëveshjeve dhe thirrjeve për projekte drejtuar studentëve, institucioni nxit studentët për zhvillimin e ideve inovative dhe rritjen e përvojave ndërkombëtare. Gjithashtu FGJH i nxit studentët të marrin pjesë në konferenca studentore të organizuara nga vetë fakulteti i gjuhëve të huaja. Angazhimi në këto veprimtari mundëson ndarjen e ideve inovative sidomos në lidhje me fushën e përkthimit. Në këtë kuadër janë organizuar veprimtari në lidhje me dialogun ndërkulturor dhe festivali studentor, të cilat u japin studentëve mundësinë të ndajnë idetë inovative kryesisht në fushën e gjuhësisë dhe të përkthimit. Nxitja e studentëve për zhvillimin e ideve inovative realizohet edhe përmes shpalljes të thirrjeve për pjesëmarrje në projekte që synojnë mbështetjen e nismave studentore. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT-së,</i>

	<i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidencë III.43.1 Pjesëmarrje e studentëve në projekt ndërkombëtar për lëvizshmërinë,</i> <i>Evidencë III.43.2 Mobilitete dalëse-hyrëse Erasmus+,</i>			
Konkluzione	<i>GVJ-ja arrin në konkluzionin se:</i> - <i>programi i studimit garanton thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve, si dhe zhvillimin e aftësive të veçanta komunikimit dhe ndërveprimit, përfshirë edhe në gjuhë të huaj;</i> - <i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët, mësimdhënia realizohet në bazë kompetencash me qëllim që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale;</i> - <i>Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë dhe nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore;</i> - <i>Për të garantuar ofrimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë, <u>GVJ sugjeron</u> përfshirjen në programin e studimit të lëndëve që ofrojnë zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë dhe informacionit;</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuq përmbylljet	Përmbylljet pjesërisht	Përmbylljet kryesisht	Përmbylljet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar procedura të qarta dhe të posaçme për detyrimet përmbyllëse të studimeve, të cilat janë të përfshira në rregulloret e brendshme të institucionit dhe në atë të programit të studimit. Përmbyllja e programit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” kryhet me realizimin e praktikës profesionale dhe me punim diplome.

	Praktika profesionale ka 12 ECTS dhe teza e diplomës ka 18 ECTS, pra jo më shumë se 15% të krediteve të programit, në përputhje me VKM 41 dt 24.01.2018. Rregullorja e programit të studimit përmban kriteret dhe detyrimet për mbylljen e studimeve, me qëllim pajisjen më pas të studentit me diplomë, suplementin e diplomës dhe dokumentacionin përkatës. Për më tepër, institucioni bën publike kriteret, procedurat e detyrimeve dhe datat për detyrimet përmbyllëse. Evidenca <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidenca I.21 Rregullore e programit të studimit,</i> <i>Evidencë III.38 Manuali i praktikës profesionale për programet e ciklit të dytë "Master i shkencave",</i> <i>Evidencë III.33 Shpallja e datave të detyrimeve përmbyllëse</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar dokumentacionit në DVV dhe takimeve me studentët dhe stafin, konstatohet se udhëheqësi i diplomës, përgjegjësi i departamentit dhe koordinatori i praktikës kanë rol kyç përkatësisht në mbylljen e punimit të diplomës dhe në realizimin e praktikës profesionale, si detyrime kryesore përmbyllëse të programit të studimit. Ata përcjellin informacionin e nevojshëm tek studenti, udhëzimet në lidhje me realizimin e diplomës dhe praktikës profesionale, asistojnë në përcaktimin e institucionit ku do të kryhet praktika profesionale, si dhe me materialet e tjera të nevojshme. Gjithashtu personeli akademik përgjegjës për detyrimet përmbyllëse, përkatësisht praktikën profesionale dhe tezën e diplomës i njohin studentët edhe me kriteret e këtyre detyrimeve bazuar në manualin e praktikës profesionale dhe formularin e vlerësimit të punimit të diplomës. Evidenca <i>Evidencë III.38 Manuali i praktikës profesionale për programet e ciklit të dytë,</i> <i>Evidencë I.19 Lista e marrëveshjeve për realizimin e praktikës,</i> <i>Evidenca III.49 Modele marrëveshjesh për realizimin e praktikës,</i> <i>Evidenca III.50 Materiale për studentët në lidhje me realizimin e praktikës.</i>

	<i>Evidenca 52.1 Fletë vlerësimi diplome 1</i> <i>Evidenca 52.2 Fletë vlerësimi diplome 2</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim” përmbyllet me realizimin e diplomës dhe mbrojtjen e saj. Çdo njësi bazë e angazhuar në këtë program studimi, realizon çdo vit ndarjen e diplomave dhe pedagogët përkatës, në mënyrë të njëtrajtshme. Mbrojtja e diplomës bëhet në praninë e një komisioni të ngritur nga departamenti, i cili përbëhet nga tre anëtarë, dhe kryen vlerësimin bazuar në komponentët dhe kriteret e përfshira në formularët e vlerësimit. Këto kritere janë të përcaktuara në rregulloret e UT-së, të FGJH-së, të programit të studimit dhe të rregullores së diplomimit për programet e ciklit të dytë master i shkencave. Sipas nenit 3 të kësaj të fundit, studenti mund të diplomohet vetëm pasi ai ka shlyer të gjitha detyrimet e tjera të programit të studimit, çka përfshin shlyerjen e detyrimeve të lëndëve në planin mësimor të programit të studimit, si dhe mbrojtjen me sukses të punimit të diplomës. Evidenca <i>Evidencë III.51 Model-listë e shpërndarjes së udhëheqësve,</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidencë I.21 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë	GVJ-ja konstaton se teza e diplomës udhëhiqet nga personeli akademik me titull ose gradë të paktën doktor i shkencave. Udhëheqësi i temës i jep studentit mbështetjen e nevojshme në të gjitha hapat për përgatitjen e punimit të diplomës duke filluar me përzgjedhjen e temës, përgatitjen e planit të punës, përzgjedhjen e literaturës, organizimin e punimit, stilin e të shkruarit, dhe afatet e punimit. Këto faza të realizimit të diplomës përmbushen me anë të takimeve konsultuese që udhëheqësi i diplomës realizon me studentin në mënyrë periodike dhe sipas nevojës. Pas realizimit të këtyre etapave, udhëheqësi vlerëson cilësinë e punimit të realizuar dhe përcakton kalimin në fazën finale, atë të mbrojtjes së punimit, duke firmosur deklaratën miratuese sipas formatit të miratuar nga fakulteti.

për t'u paraqitur para komisionit.	<i>Edhe pse në RVB thuhet që udhëheqësi e njeh studentin me penalizimet në rast plagjature, mënyra apo format e penalizimit nuk janë të përcaktuara në rregullore.</i> Evidenca <i>Evidencë nr.53 Rregullore diplomimi e programeve të ciklit të dytë Master i shkencave</i> <i>Evidencë II.1 Syllabus i lëndës MKSH</i> <i>Evidencë III.21 Lista e orareve të konsultimeve pedagogë-studentë</i> <i>Evidenca III.54, Deklarata e pedagogut udhëheqës para mbrojtjes së punimit.</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Bazuar në RVB dhe në takimet me stafin akademi, u konstatua se për shkak të natyrës së programit të studimit, për realizimin e diplomës nuk është e nevojshme kryerja e matjeve apo analizave. Megjithatë, në rast nevojë, udhëheqësi i diplomës e orienton studentin drejt strukturave përkatëse, ndërkohë që e asiston gjatë gjithë kohës në hapat përkatës të realizimit të diplomës, nga strukturimi deri në përfundim të tij. Evidenca <i>Evidencë III.53 Rregullore diplomimi e programeve studimore të ciklit II master i shkencave,</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidencë III.52 Fletë vlerësimi e diplomës.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi përfundimtar i tezës së diplomës realizohet me notë, kur 5 (pesë) është nota më e ulët kaluese dhe 10 (dhjetë) më e larta, dhe përfshin vlerësimin e punimit me shkrim të diplomës (30%), vlerësimin e mbrojtjes me gojë (30%) dhe notën mesatare (40%). Vlerësimi pasqyrohet në formularët përkatës, sipas rubrikave të veçanta vlerësimit. Më pas formularët firmosen nga të gjithë anëtarët e komisionit para të cilit realizohet mbrojtja e punimit të diplomës, dhe depozitohen në sekretarinë mësimore sipas përcaktimeve në rregulloren e diplomimit të programeve të ciklit të dytë.
	Evidenca

	<i>Evidencë III.53 Rregullore diplomimi e programeve të ciklit të dytë, Master i shkencave,</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidencë III.52.1 Fletë vlerësimi e diplomës</i> <i>Evidencë III.52.2 Fletë vlerësimi e diplomës</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ-ja konstaton se studenti që ka shlyer detyrimet përmbyllëse të të gjitha lëndëve që janë pjesë e planit mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”, dhe që ka marrë miratimin e mbrojtjes së diplomës nga pedagogu udhëheqës, mund të bëjë mbrojtjen finale të saj. Pas realizimit me sukses të praktikës profesionale dhe mbrojtjes së temës së diplomës, të cilat jynë detyrime kryesore përmbyllëse të programit të studimit, pajiset me diplomën e programit të studimit dhe me suplementin e saj. Diploma dhe suplementi janë të miratuara nga Ministria e Arsimit. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se studentit i vihet në dispozicion kopje zyrtare e programit të studimit vetëm me kërkesë të studentit. Evidenca <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidencë III.55.1 Model diplome</i> <i>Evidencë shtesë 10.Model i Suplementit të diplomës</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ konstaton se në përmbushje të detyrimeve institucionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, sekretaria mësimore ruan informacionin për studentin në regjistrat përkatës dhe e jep atë për palët e interesuara në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatorë. Informacionin në lidhje me mbarëvajtjen e programit të studimit, studenti mund ta gjejë edhe në E-student, ku përfshihen të dhëna personale, për regjistrimin në programin e studimit, lista e notave, historiku i regjistrimit në provime dhe rezultatet e marra në çdo lëndë. Evidenca <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore,</i>

	<i>Evidencë III.35 Manual i E-student</i>			
Konkluzione	<i>GVJ-ja konstaton se:</i> - <i>Përmbyllja e studimeve për programin Master i Shkencave në "Përkthim teknik-letrar dhe interpretim" kryhet me mbrojtje të punimit të diplomës, procedurë e parashikuar në rregulloret e institucionit, të programit të studimit dhe atë të diplomimit të programeve të ciklit të dytë Master i Shkencave;</i> - <i>Gjatë realizimit të punimit, studenti asistohet nga pedagogu udhëheqës në të gjitha hapat e punimit;</i> - <i>Në përfundim të mbrojtjes të punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë dhe më pas pajiset me diplomë dhe suplement diplome;</i> - <i>Informacioni në lidhje me studentin ruhet bazuar në legjislacionin në fuqi dhe vihet në dispozicion të studentit në rast nevojë dhe me kërkesë të tij;</i> - <i>GVJ sugjeron përcaktimin e mënyrës apo formave të penalizimit në rast plagjature të punimit të diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A

Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N / A			
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A			
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																																																																				
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Gjatë vizitës në institucion si edhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, GJVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i angazhuar në këtë program studimi, ka kualifikimin e duhur për realizimin e orëve mësimore. Gjatë takimeve në FGJH me personelin akademik, zyrën e burimeve njerëzore, me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, u konstatua se për punësimin e personelit janë ndjekur procedura standarde të parashikuara në nenin 64 e në vijim të statutit të UT-së dhe manualin mbi punësimin e personelit të UT, ku përgjegjësi i departamentit ka bërë kërkesën lidhur me nevojat e njësisë bazë, ka hartuar kriteret e përgjithshme ia ka dërguar dekanit për miratim dhe më pas njoftimi është bërë publik në faqen zyrtare të FGJH. Mbështetur në dokumentacionin e kërkuar gjatë vizitës në institucion (<i>Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabelat 6)</i>), numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2"></th><th rowspan="2">Tituj/Grada</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td rowspan="4">Dep i Anglishtes</td><td>Prof. Dr</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>12</td><td>-</td><td>11</td><td>-</td><td>12</td><td>--</td></tr><tr><td>Msc</td><td>0</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td rowspan="4">Dep i frengjishtes</td><td>Prof. Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td><td>9</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>2</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>2</td></tr><tr><td rowspan="4">Dep i gjuhes gjermane</td><td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Assoc.</td><td>1</td><td>1</td><td>3</td><td>1</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD</td><td>13</td><td>1</td><td>11</td><td>-</td><td>10</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc</td><td>5</td><td>20</td><td>5</td><td>16</td><td>5</td><td>1</td></tr><tr><td rowspan="2"></td><td>Prof. Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td></tr></table>		Tituj/Grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Dep i Anglishtes	Prof. Dr	3	-	3	-	3	-	Prof.Assoc	1	-	1	-	1	-	Dr./PhD	12	-	11	-	12	--	Msc	0	-	-	-	-	-	Dep i frengjishtes	Prof. Dr	-	-	-	-	6	-	Prof.Assoc	3	-	3	-	9	-	Dr./PhD	2	1	1	1	4	-	Msc	-	-	-	-	-	2	Dep i gjuhes gjermane	Prof. Dr	1	-	1	-	1	-	Prof.Assoc.	1	1	3	1	4	-	Dr./PhD	13	1	11	-	10	1	Msc	5	20	5	16	5	1		Prof. Dr	-	-	-	-	-	-	Prof.Assoc	3	-	3	-	3	-
	Tituj/Grada			2021-2022		2022-2023		2023-2024																																																																																																													
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																																																														
Dep i Anglishtes	Prof. Dr	3	-	3	-	3	-																																																																																																														
	Prof.Assoc	1	-	1	-	1	-																																																																																																														
	Dr./PhD	12	-	11	-	12	--																																																																																																														
	Msc	0	-	-	-	-	-																																																																																																														
Dep i frengjishtes	Prof. Dr	-	-	-	-	6	-																																																																																																														
	Prof.Assoc	3	-	3	-	9	-																																																																																																														
	Dr./PhD	2	1	1	1	4	-																																																																																																														
	Msc	-	-	-	-	-	2																																																																																																														
Dep i gjuhes gjermane	Prof. Dr	1	-	1	-	1	-																																																																																																														
	Prof.Assoc.	1	1	3	1	4	-																																																																																																														
	Dr./PhD	13	1	11	-	10	1																																																																																																														
	Msc	5	20	5	16	5	1																																																																																																														
	Prof. Dr	-	-	-	-	-	-																																																																																																														
	Prof.Assoc	3	-	3	-	3	-																																																																																																														

	Dep i gjuhes italiane	Dr./PhD	4	-	4	-	5	-
		Msc	-	-	-	-	-	-
	Dep i gjuhes spanjolle	Prof. Dr	1	-	1	-	1	-
		Prof.Assoc	-	-	-	-	-	-
		Dr./PhD	5	2	5	2	3	1
		Msc	2	8	2	9	-	1
	Dep i gjuhes sllave dhe ballkanike	Prof. Dr	-	-	-	-	-	-
		Prof.Assoc	5	-	5	-	-	-
		Dr./PhD	4	-	5	-	-	-
		Msc	-	-	1	2	-	-
	Dep i gjuhes greke	Prof. Dr	-	-	-	-	-	-
		Prof.Assoc	2	-	2	-	-	-
		Dr./PhD	3	-	2	-	-	-
		Msc	1	2	-	-	-	-
	Totali		70	35	69	31	67	6

Nga sa më sipër konstatohet se për tre vitet akademike në këtë program studimi ka të angazhuar edhe staf akademik me Msc, në kundërshtim me *pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015, konkretisht:*

2021-2022 nga 105 staf gjithsej 38 me Msc, 36 %;

2022-2023 nga 100 staf gjithsej 37 me Msc, 37 %;

2023-2024 nga 71 staf gjithsej 9 me Msc, 12.3 %;

GVJ rekomandon që, për realizimin e programit të studimit Msc në "Përkthim teknik - letrar dhe interpretim", Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.

Evidenca

Evidencë III.17 tabela 1+8 përmbledhëse e personelit akademik

Evidencë III.18 tabela 2 përmbledhëse e personelit akademik

Evidencë IV.2 komitetet shkencore të programit të studimit dhe koordinatorët e programeve të studimit

	<i>Evidencë IV.3 screenshot Cv e stafit nga faqja ëeb e FGJH</i> <i>Evidencë I.9 raport vjetor mësimor kërkimor 2021-2022</i> <i>Evidencë I.10 raport vjetor mësimor kërkimor 2022-2023</i> <i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidenca 4.8 Manual mbi punësimin e Personelit të Universitetit të Tiranës anglisht+shqip</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Lidhur me ngarkesën mësimore për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim ofruar nga FGJH, GJV konstatoi se në fillim të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit bën shpërndarjen për secilin personel akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ajo që u theksua edhe në takimet e zhvilluara është se ngarkesa realizohet në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe departamentet e saj, për të mbuluar 70% të saj. Mbështetur gjithashtu në evidencat e ngarkuara në sistem, rezulton se programi i studimit Master i shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim është ndërdepartamental, pra ofrohet nga departamente të ndryshme. Kështu, për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023, janë angazhuar personel me kohë të plotë dhe personel me kohë të pjesshme nga të 7-të departamentet. Personeli akademik i angazhuar është i pajisur me gradat dhe titujt shkencorë të kërkuar sipas akteve nënligjore në fuqi. Mbështetur në deklaratimet e FGJH mbi ngarkesën mësimore rezulton se për një vit akademik ajo mbulohet deri në 1000 orë në total, orë këto të shpërndara në leksione 225 orë, seminare 675 orë, praktikë profesionale 100 orë. Lidhur me ngarkesën mësimore, GJV konstatoi se personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit, mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit përkatësisht për secilin departament dhe vit akademik në vlerat si më poshtë: Për vitin akademik 2021-2022 departamenti i gjuhës angleze ka deklaruar 1060 orë të cilat mbulohen nga PAE dhe për vitin akademik 2022-2023 940 orë mbulohen nga PAE. Ndërkohë, për vitin akademik 2024-2025 janë deklaruar gjithësej 1540 orë nga të cilat vetëm 60 mbulohen nga PAK. Për vitin akademik 2021-2022 departamenti i gjuhës gjermane ka deklaruar 1000 orë nga të cilat vetëm 90 orë mbulohen nga PAK. Për vitin 2022-2023 dhe 2024-2025 i njëjti departament ka deklaruar 1000 nga të cilat vetëm 60 mbulohen nga PAK.

Për vitin akademik 2021-2022 departamenti i gjuhës italiane ka deklaruar 1170 orë të cilat mbulohen nga PAE. Për vitin 2022-2023 i njeiti departament ka deklaruar 730 të mbuluara nga PAE.

Për vitin 2021-2022 dhe 2022-2023 departamenti i gjuhës spanjolle ka deklaruar 900 orë nga të cilat 200 orë mbulohen nga PAK.

ku 850 mbulohen nga personeli akademik me kohë të plotë dhe 150 nga personeli akademik me kohë të pjesshme.

Dep i Anglishtes	Totali i Ngarkesës mësimore	2021-2022		2022-2023		2024-2025	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	1060/1540	1060 100%	-	940 100%	-	1480 96%	60 4%
Dep i gjuhes gjermane	1000	910 91%	90 9%	940 94%	60 6%	940 94%	60 6%
Dep i gjuhes italiane	1170	1170 100%	-	730 100%	-	-	-
Dep i gjuhes spanjolle	900	700 77%	200 23%	700 77%	200 23%	-	-

Mbështetur në sa më sipër, ngarkesa mësimore është shpërndarë sipas aktëve nënligjore në fuqi. Referuar nenit 51/b të Statutit të Universitetit të Tiranës, drejtuesi i departamentit mbikëqyr shpërndarjen e ngarkesës mësimore të anëtarëve të njësisë sipas drejtimeve të përcaktuara nga njësia dhe sigurohet për përmbushjen e saj. Ndarja e ngarkesës mësimore mes personelit akademik, realizohet duke respektuar normat e ngarkesës, shkallën e kualifikimit, eksperiencën e personelit akademik dhe numrin e grupeve për disiplinat përkatëse.

Evidenca

Evidencë III.2 tabela 13 ngarkesa totale në auditor

Evidencë III.4 plani i miratuar mësimor 2023-2025

Evidencë I.1 stauti i UT

Evidencë I.16 kosifikimi i programeve master

Evidencë II.18 ndarja e ngarkesës mësimore tabelë

	<i>Evidencë IV.11 tabelat e realizimit të ngarkesës mësimore të dep të frëngjishtes</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Në takimet e zhvilluara në FGJH, si edhe pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i qëndrueshëm, kontratat e të cilëve janë rinovuar sipas kategorive respektive, me kohë të plotë dhe të pjesshme. Personeli akademik është deklaruar në organet tatim paguese dhe është mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Kontratat janë specifike për personelin akademik me kohë të plotë dhe personelin akademik me kohë të pjesshme. Objekti dhe përshkrimi i kontratës, kohëzgjatja e saj, ngarkesa mësimore, pushimet vjetore, masat disiplinore, paga dhe rastet e përfundimit të kontratës janë të parashikuara në secilën prej tyre. Evidenca <i>Evidencë IV.7 Listë pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore</i> <i>Evidencë IV.5 Inventar, fleta prezantuese e dosjes së personelit akademik</i> <i>Evidencë IV.6 Kontratat tip të stafit akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme rekrutohet në bazë të një procedure ligjore, mbështetur në manualin e punësimit të personelit të UT, statutin e UT dhe rregulloren e FGJH. Përgjegjësi i Departamentit përcakton nevojat dhe kriteret specifike që duhet të përmbushë personeli akademik dhe më pas kërkesën e drejton në Dekanat, ku dekani e miraton dhe më pas ia përcjell rektorit për miratim. Për këtë procedurë ngrihet një komision ad hoc i cili merr në konsideratë të gjitha aplikimet dhe bën të mundur përzgjedhjen e tyre nëpërmjet një sistemi pikëzimi. Procedura është transparente dhe kolegjiale. Kriteret e përcaktuara nga njësia bazë bëhen publike edhe në faqen zyrtare të UT dhe FGJH, duke njoftuar çdo të interesuar mbi nevojat e FGJH. Gjatë takimeve në FGJH u theksua fakti se është zyra e burimeve njerëzore që përcakton më pas kriteret e përgjithshme dhe bën dhe njoftimin në faqen zyrtare të internetit, duke përcaktuar edhe afatet e aplikimit. Gjithashtu, lidhur me kontratat e punës rezultoi se, kontratat për personelin akademik me kohë të plotë janë me afat të pacaktuar ndërsa ato për personelin akademik me kohë të pjesshme më afat 1 vjeçar, si edhe janë të pajisura me të gjithë elementët ligjorë si firma, data e fillimit dhe përfundimit, vula.

	Evidenca <i>Evidencë I.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë IV.8 Manuali mbi punësimin e personelit të UT</i> <i>Evidencë IV.9 vendim për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik</i> https://unitir.edu.al/category/njoftim-per-vende-te-lira-pune/ https://www.app.gov.al
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Gjatë takimeve të zhvilluara në FGJH, si edhe mbështetur në dokumentet e vendosura në dispozicion, GVJ konstatoi se për programin e studimit master i shkencave në përkthim teknik-letrar dhe interpretim vijnë në ndihmë ambiente të pajisura me mjetet teknologjike të nevojshme për të praktikuar përkthimin e materialeve. Laboratorët janë të mirë organizuar, kanë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor, janë të pajisur me kompjuterë dhe sistem ngrohje dhe akustikë të mirë duke u ofruar studentëve komoditet. Për t'i ardhur në ndihmë mirëmbajtjes së laboratorëve janë angazhuar persona specifike të cilët u takuan me GVJ edhe gjatë takimeve në FGJH. Evidenca <i>Evidencë III.17 tabela 1+8 përmbledhëse e personelit akademik</i> <i>Evidencë IV.10 Organigrama</i> <i>Evidencë IV.15 fotografi të laboratorëve</i> <i>Evidencë IV.14 të dhëna për infrastrukturën e auditorëve dhe laboratorëve mësimor</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e	GVJ konstatoi se UT nëpërmjet sektorit të burimeve njerëzore dhe sektorit të protokoll arkivës, mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik. Kjo realizohet nëpërmjet përditësimit të kontratave të punësimit për personelin me kohë të pjesshme, kontrata e të cilëve është me kohëzgjatje 1 vjeçare. Zyra e burimeve njerëzore dhe zyra e arkiv protokollit deklaruan se dosjet e personelit ruhen dhe përditësohen edhe për personelin akademik me kohë të plotë. Të dhënat e përditësuara lidhen me CV, pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, kualifikime, apo angazhime të tjera në funksion të pozicionit të punës. Gjatë takimeve të zhvilluara nga GVJ u vu në dispozicion nga një dosje të përditësuar të personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme. Dosjet e personelit akademik ishin të pajisura me të

programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	gjithë dokumentet e nevojshëm që vërtetojnë ligjshmërinë e tyre (të noterizuara) për ushtrimin e profesionit. Evidenca <i>Evidencë IV.9 vendim për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik</i> <i>Evidencë IV.5 Inventar, fleta prezantuese e dosjes së personelit akademik</i> <i>Evidencë IV.6 Kontrata tip të stafit akademik</i> www.fgjh.edu.al
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Gjatë takimeve në FGJH, GVJ konstatoi se në kuadër të ofrimit të praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, me institucione të ndryshme. Nga lista e vënë në dispozicion rezulton se jo për të gjitha institucionet disponohet një numër kontakti ose një adresë email nëpërmjet të cilave mbahet komunikimi. <u>GVJ sugjeron që FGJH të rishikojë listën dhe ta përditësojë atë me informacionin e nevojshëm (numër kontakti dhe adresë email) për të garantuar edhe vërtetësinë e dokumentit.</u> Një gjë e tillë është parashikuar edhe në aktet e brendshme të UT. Edhe vetë studentët pranuan se ata zhvillojnë praktikën profesionale në institucione të ndryshme në semestrin e katërt. Mënyra e organizimit dhe mbikëqyrjes së praktikës profesionale është parashikuar në manualin e praktikës profesionale në të cilin përcaktohen edhe detyrat e koordinatorit të praktikës. Më konkretisht koordinatori i praktikës vendos kontakte me institucionet dhe diskuton rreth kapaciteteve të tyre për të pranuar studentë të kryejnë praktikën profesionale, bën organizimin e tyre në institucione të ndryshme, mban kontakte me udhëheqësit e praktikës me përgjegjësin e departamentit dhe studentët. Nga ana tjetër, në këtë manual parashikohen edhe detyrat e udhëheqësit të praktikës i cili në vija të përgjithshme ndihmon dhe këshillon studentët gjatë praktikës profesionale, sigurohet që praktika profesionale të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara si edhe i ndjek studentët dhe mban komunikimin me ta deri në përfundim të kësaj periudhe. Evidenca

	<i>Evidencë I.19 Memorandume bashkëpunimi për praktikën mësimore profesionale</i> <i>Evidencë IV.12 Lista e marrëveshjeve të nënshkuara nga FGJH për praktikën e masterit shkencor</i> <i>Evidencë III.38 Manual i praktikës profesionale për programet e ciklit të dytë të studimeve</i> <i>Evidencë I.18 Manuali i praktikës profesionale për programet e ciklit të dytë</i>
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se dokumenti i cili përcakton mënyrën e organizimit dhe finalizimit të praktikës profesionale në FGJH është Manuali i Praktikës Profesionale. Në këtë dokument përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e institucionit pritës, koordinаторit të praktikës profesionale, udhëheqësit të praktikës dhe studentit i cili e zhvillon praktikën. Gjithashtu, ky manual përcakton edhe procedurën që ndjek studenti që në momentin e përzgjedhjes së institucionit ku do të kryejë praktikën e deri në përfundimin e tij. Jo vetëm kaq, në manual parashikohet edhe procedura që ndiqet pas përfundimit të praktikës, ku konkretisht institucioni ku është zhvilluar praktika plotëson vlerësimin e studentit dhe studenti në përfundim të praktikës dorëzon një raport përshkrues pranë njësisë bazë. Evidenca <i>Evidencë I.19 Memorandume bashkëpunimi për praktikën mësimore profesionale</i> <i>Evidencë IV.12 Lista e marrëveshjeve të nënshkuara nga FGJH për praktikën e masterit shkencor</i> <i>Evidencë III.38 Manual i praktikës profesionale për programet e ciklit të dytë të studimeve</i> <i>Evidencë I.18 Manuali i praktikës profesionale për programet e ciklit të dytë</i>
Konkluzione	GVJ, konstatoi se: personeli akademik, i angazhuar në këtë program studimi, i përmbush kryesisht kërkesat ligjore të kornizës rregullatore për IAL përsa i përket numrit dhe kualifikimit, kjo sepse konstatohet se një pjesë e stafit mësimdhënës janë me Master Shkencor. <u>GVJ rekomandon</u> që, për realizimin e programit të studimit Msc në "Përkthim teknik - letrar dhe interpretim", Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.

	<i>Procedurat e punësimit janë ndjekur në përputhje me standardet e parashikuara nga statuti i Universitetit të Tiranës. Procedurat e rekrutimit për personelin akademik janë transparente dhe kolegjiale, duke ndjekur kriteret e përcaktuara në manualin e punësimit dhe duke u bërë publike në faqet zyrtare.</i> <i>Ngarkesa mësimore për vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023 është e organizuar dhe menaxhuar mirë, me një mbulueshmëri të lartë të orëve të nevojshme. Personeli akademik ka mbuluar ngarkesën e kërkuar për mbështetje në procesin mësimor.</i> <i>FGJH ka nënshkruar një sërë marrëveshesh për praktikant profesional të studentëve, por <u>GVJ rekomandon</u> përditësimin e informacionit rreth kontaktit me institucionet që pranojnë studentë, për të garantuar një komunikim efektiv.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Pas vizitës në institucion por mbështetur edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se FGJH garanton mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Godina ndodhet në një zonë lehtësisht të aksesueshme nga studentët dhe ka një sipërfaqe prej 3699 m ² . Mjediset janë të pajisura me sistem ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën dhe në të gjitha klasat. Laboratorët dhe klasat janë gjithashtu të pajisura me kompjuter dhe pajisjet e domosdoshme për zhvillimin e praktikave në përkthim, lidhje interneti dhe tabela interaktive. Mësimi organizohet në fasha orare për të lehtësuar pjesëmarrjen e studentëve dhe përshtatur nevojave të tyre pasi një pjesë e studentëve të programit master janë të punësuar me kohë të pjesshme dhe oraret gjatë paradites janë jo shumë të përshtatshme për to. Studentët mund të përdorin ambientet e bibliotekës dhe laboratorëve sa herë që ato

	e kanë të nevojshme. Në dispozicion të programit të studimit master i shkencave në përkthim teknik-letrar dhe interpretim janë të dyja godinat, godina A dhe godina B. Orari mësimor është i afishuar në korridoret e godinave por studentët mund ta marrin këtë informacion edhe në sekretarinë mësimore. Ambientet në të cilat zhvillohet mësimi i programit të studimit master i shkencave në përkthim teknik-letrar dhe interpretim përdoren edhe për organizimin e aktiviteteve ekstra kurrikulare ose leksioneve të hapura. Evidenca <i>Evidencë RVB mjediset për fakultetin/njësive bazë tabela 16</i> <i>Evidencë IV.13 orari mësimor për vitin akademik 2021-2023</i> <i>Evidencë IV.14 të dhëna mbi infrastrukturën dhe inventarin e FGJH</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore të vëna në dispozicion për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim, janë të pajisura me mjete elektrike dhe teknologjike si: kompjuter, video-projektor, kamera, tabelë interaktive, të domosdoshme për të mundësuar një proces mësimor bashkëkohor. Duke qenë se ky program studimi është specifik, ai kërkon edhe pajisje specifike të përkthimit. Laboratorët janë përshtatur për të ndihmuar studentët të përfitojnë praktikën e nevojshme për tu përgatitur për tregun e punës. Laboratorët e përkthimit janë të pajisur me tavolina, kufje dhe mikrofona si edhe kabina përkthimi. Në ambientet e laboratorëve studentët mund të lidhen edhe me internet dhe mund të marrin me vete laptopë kur është e nevojshme për procesin mësimor. FGJH gjithashtu ka mundësuar krijimin e klasave të përshtatshme për organizimin e konferencave e cila është e pajisur me projektor dhe lidhje interneti. Gjatë vizitave në FGJH GVJ konstatoi se zyrat e sekretarisë mësimore janë të pajisura me kompjuter dhe printera për lehtësimin e proceseve të caktuara. Evidenca <i>Evidencë IV.14 të dhëna mbi infrastrukturën dhe inventarin e FGJH</i> <i>Evidencë IV.15 fotografi të laboratorëve dhe sallave të leksioneve+seminareve</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset	Gjatë takimeve të zhvilluara në FGJH, GVJ konstatoi se ambientet e dedikuara për procesin mësimor, plotësojnë kushtet

e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	e përshtatshme për një mësimdhënie moderne dhe bashkëkohore. Infrastrukturë e përshtatshme teknologjike ndihmon në zhvillimin e një procesi mësimdhënës dhe nxënës bashkëkohor dhe interaktiv. Laboratorët e në dispozicion të programit të studimit master i shkencave në përkthim teknik-letrar dhe interpretim u vijnë në ndihmë studentëve për përvetësimin e aftësive të tyre në përkthim dhe interpretim. Laboratorët janë specifikë të pajisur me kabina përkthimi, kufje dhe mikrofona si edhe lidhje interneti. Salla e kompjuterëve gjithashtu vjen në dispozicion të këtij programi studimi. Ato mund të përdoren nga studentët gjatë orës së mësimin kur është e nevojshme ose kur profesori ia kërkon një gjë të tillë për aftësimin e tyre praktik. FGJH u ofron gjithashtu mundësinë studentëve të përdorin platforma të caktuara ku ato mund të shkarkojnë pa pagesë aplikacione ose licenca të programe të ndryshme që u vijnë në funksion të procesit mësimor. Evidenca <i>Evidencë IV.14 të dhëna mbi infrastrukturën dhe inventarin e FGJH</i> <i>Evidencë IV.15 fotografi të laboratorëve dhe sallave të leksioneve+seminareve</i> <i>Evidencë RVB mjediset për fakultetin/njësive bazë tabela 16</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë takimeve në FGJH, GVJ konstatoi se në funksion të programit të studimit master i shkencave në përkthim teknik-letrar dhe interpretim janë vënë në dispozicion laboratorë përkthimi dhe interpretimi të cilët ndihmojnë në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe lehtësimin e praktikës mësimore. Laboratorët janë bashkëkohorë dhe të pajisur me mikrofona, kufje, kabina përkthimi, kompjuterë dhe pajisje fonetike që ndihmojnë studentët të jenë më interaktivë gjatë procesit mësimor. Përveç laboratorëve studentët mund të shfrytëzojnë edhe ambientet e bibliotekës për të mësuar, punuar ose për të marrë literaturën e nevojshme. Evidenca <i>Evidencë IV.14 të dhëna mbi infrastrukturën dhe inventarin e FGJH</i>

	<i>Evidencë IV.15 fotografi të laboratorëve dhe sallave të leksioneve+seminareve</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulate me kapacitetet e nevojshme.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe gjatë takimeve të zhvilluara në mjediset e FGJH, GVJ konstatoi se ky institucion siguron mjedise të përshtatshme dhe bashkëkohore për zhvillimin e praktikave mësimore. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, ky institucion siguron mjedise të tjera dhe mundësi për studentët për zhvillimin e aftësive të tyre në përkthim dhe interpretim nga ekspertë të fushës ose institucione si studio përkthimi, shtëpi botuese, apo sipërmarrje të ndryshme të cilat kanë nevojë për këtë ekspertizë. Këto marrëveshje janë lidhur gjithashtu në kuadër të zhvillimit të 12 javëve praktikë mësimore e cila është e planifikuar në programin mësimor. Procedurat e zhvillimit të praktikës jashtë FGJH janë të parashikuara qartë në manualin e praktikës profesionale për programet e ciklit të dytë të studimeve. Të gjithë aktorët si studentët, udhëheqësi apo institucioni i kanë të përcaktuara qartë të drejtat dhe detyrimet e tyre në këtë manual. Evidenca <i>Evidencë IV.14 të dhëna mbi infrastrukturën dhe inventarin e FGJH</i> <i>Evidencë IV.15 fotografi të laboratorëve dhe sallave të leksioneve+seminareve</i> <i>Evidencë IV.12 lista e marrëveshjeve të nënshkruara nga FGJH</i> <i>Evidencë III.38 prezantimi i kumtesës së studentes së degës së gjuhës spanjolle</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: Godina e institucionit shtrihet në një zonë lehtësisht të aksesueshme dhe ka një sipërfaqe prej 3699 m². Mjediset janë të pajisura me sistem ngrohje dhe ftohje, si dhe laboratorë dhe klasat përkatëse me kompjuterë, internet dhe tabela interaktive. Ambientet janë të dizajnuara për të mbështetur orare fleksibile, duke mundësuar pjesëmarrjen e studentëve që punojnë me kohë të pjesshme. Laboratorët e përkthimit janë të pajisur me mjete specifike si tavolina, kabina përkthimi, kufje dhe mikrofona për të ndihmuar studentët në zhvillimin e aftësive praktike. Salla e kompjuterëve

	<i>mund të përdoret për mësim dhe detyra, duke siguruar akses të vazhdueshëm në burime të nevojshme për studentët.</i> <i>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me zyra përkthimi dhe institucione të tjera për zhvillimin e praktikave 12-javore për studentët. Manuali i praktikës profesionale përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve dhe institucioneve përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës në FGJH, por mbështetur gjithashtu në takimet e zhvilluara në mjediset e këtij institucioni, GVJ konstatoi se ky institucion ofron një bibliotekë të pasur me tekste universitare, libra, revista shkencore dhe fjalorë për të gjitha gjuhët që ofron të cilat përdoren nga studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim. Gjithashtu FGJH ndjek një procedurë të rregullt ligjore mbi blerjen e fondit të librit ku njësia bazë bën kërkesën për një fond libri sipas nevojave. Ajo çfarë u vu re nga GVJ ishte se në dokumentacionin e vënë në dispozicion jo të gjithë librat ishin të specifikuar për citin e tyre të botimit. Nga ana tjetër, edhe në syllabuse literatura e referuar si e detyruar dhe me zgjedhje nuk është e përditësuar dhe kryesisht janë literaturë që i përkasin jo 5 vjeçarit të fundit. <u>GVJ rekomandon që literatura e përcaktuar në sillabuse të përditësohet dhe të ofrohet një literaturë e përditësuar të paktën e 5 viteve të fundit.</u> Biblioteka, përveç studentëve, është në dispozicion edhe të personelit akademik. Biblioteka është e pajisur me poste leximi dhe me një literaturë të pasur e megjithatë ajo që u vu re ishte mungesa e posteve të kompjuterëve ku studentët dhe personeli

	akademik mund ta përdorin për të kërkuar informacion ose për të punuar detyra në kompjuter. <u>GVJ sugjeron që biblioteka të pajiset edhe me poste kompjuteri për të lehtësuar procesin e kërkimit shkencor.</u> Bashkëpunimi me bibliotekën si nga ana e studentëve por edhe e personelit akademik rregullohet nëpërmjet rregullores së brendshme të bibliotekës ku të interesuarit duhet të kenë një kartelë ku regjistrohen hyrjet dhe daljet e librave, orari kur biblioteka është në dispozicion, mënyrën e përditësimit të fondit. Rregullorja dhe lista e librave janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të internetit të FGJH. Përveç bibliotekës fizike FGJH ofron edhe shërbimin online të bibliotekës ku nëpërmjet platformave të ndryshme si JSTOR apo EBSCON studentët dhe personeli akademik mund të shkarkojnë materiale të ndryshme që i shërbejnë procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Vlen të theksohet fakti se këto platforma mund të përdoren jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe jashtë tij, mjafton që studentët dhe personeli akademik të kenë një llogari dhe aprovim për ti përdorur këto platforma. Edhe shërbimet e bibliotekës online janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të FGJH. Evidenca <i>Evidencë IV.24 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale JSTOR</i> <i>Evidencë IV.23 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale të FGJH</i> <i>Evidencë IV.21 ekstrakte të fondit të inventarizuar të bibliotekës sipas njësive bazë</i> <i>Evidencë IV.22 screenshot i linkut të bibliotekës dhe lista e titujve të fondit sipas njësive bazë</i> <i>Evidencë IV.20 pasqyrë përmbledhëse e fondit të bibliotekës dhe titujve të FGJH</i> <i>Evidencë IV.19 rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Evidencë IV.18 kontrata e blerjes së fondit të librit për vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstatoi se literatura e vënë në dispozicion të këtij program studimi i përket periudhave të ndryshme kohe, kjo pasi edhe vetë programi i studimit kërkon përkthime të materialeve të ndryshme që përkojnë në vite të ndryshme të botimit të tyre. Edhe pse FGJH ndjek një procedurë të rregullt ligjore lidhur me përditësimin e fondit të bibliotekës, në syllabuse, GVJ konstatoi

	se një pjesë e mirë e literaturës nuk është e përditësuar ose i përket një periudhe më të gjatë sesa 5 vitet e fundit. <i>Për sa më sipër, <u>GVJ</u> sugjeron përditësimin e literaturës së përdorur në sillabuse nga personeli akademik me literaturë të detyrueshme dhe me zgjedhje të paktën të 5 viteve të fundit.</i> Evidenca <i>Evidencë IV.16 listë shembull e kërkesës për blerje fondi libri nga njësitë bazë</i> <i>Evidencë IV.17 listë shembull e kërkesës për blerje fondi drejtuar rektoratit</i> <i>Evidencë IV.19 rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Evidencë IV.20 pasqyrë përmbledhëse e fondit të titujve të bibliotekës së FGJH</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë takimeve në FGJH, GVJ konstatoi se ky institucion vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim, si bibliotekën fizike edhe atë online. Studentët dhe personeli akademik mund të zgjedhin të punojnë në bibliotekë duke shfrytëzuar postet e leximit ose të përdorin në çdo kohë dhe vend platformat online të vëna në dispozicion për të kërkuar çfarëdo informacioni të nevojshëm. Studentët gjithashtu mund të huazojnë literaturën e nevojshme dhe ta përdorin atë jashtë ambienteve të FGJH duke respektuar afatet e vendosura për kthimin sërish të literaturës së huazuar. Kjo e drejtë u lind me anëtarësimin në këtë bibliotekë. Evidenca <i>Evidencë IV.24 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale JSTOR</i> <i>Evidencë IV.23 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale të FGJH</i> <i>Evidencë IV.21 ekstrakte të fondit të inventarizuar të bibliotekës sipas njësive bazë</i> <i>Evidencë IV.22 screenshot i linkut të bibliotekës dhe lista e titujve të fondit sipas njësive bazë</i> <i>Evidencë IV.20 pasqyrë përmbledhëse e fondit të bibliotekës dhe titujve të FGJH</i> <i>Evidencë IV.19 rregullore e brendshme e bibliotekës</i>

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e FGJH është në dispozicion të gjithë programeve të studimit që ofrohen nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë. GVJ konfirmon se biblioteka është e pajisur me fond fizik si tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, për të gjitha gjuhët që FGJH ofron programe studimi. Konkretisht, gjatë vitit akademik 2020-2021 FGJH ka bërë kërkesë për blerje të 191 titujve të rinj për të gjitha gjuhët që ofron programe studimi, për vitin akademik 2021-2022 190 tituj të rinj, për vitin 2022-2023 120 tituj të rinj dhe për vitin akademik 2023-2024 30 tituj të rinj. Ky numër verifikon shumëllojshmërinë e titujve të disponueshëm si në bibliotekën online edhe në atë fizike në ambientet e FGJH. Biblioteka e FGJH përmban një fond fizik prej 15.600 tituj dhe lidhur me fondin e përgjithshëm ku bëjnë pjesë edhe titujt në platformat online një numër prej 23.000 tituj. Evidenca <i>Evidencë IV.20 pasqyrë përmbledhëse e fondit të bibliotekës dhe titujve të FGJH</i> <i>Evidencë IV.19 rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Evidencë IV.18 kontrata të blerjes së fondit të librit për vite akademike 2021- 2022 dhe 2022-2023</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ gjatë takimeve në FGJH por edhe mbështetur në dokumentacionin e vendosur në dispozicion konstatoi se FGJH ka krijuar kushtet e përshtatshme për studentët dhe personelin akademik, për të aksesuar pa pagesë bibliotekat online, përkatësisht JSTOR, EBSCO. Sipas FGJH, nëpërmjet këtyre platformave elektronike, studentët dhe personeli akademik mund të shkarkojnë çdo material të nevojshëm lidhur me studimet e tyre, realizimin e ndonjë projekti ose detyre si edhe kërkimet shkencore. Evidenca <i>Evidencë IV.19 rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Evidencë IV.18 kontrata të blerjes së fondit të librit për vite akademike 2021- 2022 dhe 2022-2023</i> <i>Evidencë IV.24 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale JSTOR</i> <i>Evidencë IV.23 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale të FGJH</i>

Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me poste studimi si edhe ofron mundësinë e përdorimit të platformave online si JSTOR, EBSCO në funksion të studentëve dhe personeli akademik për të zhvilluar kërkimin shkencor apo detyra në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të programit të studimit. GVJ konstatoi se në bibliotekën e FGJH nuk ka poste kompjuteri ku studentët dhe personeli akademik të mund të punojnë për gjenerimin e materialeve online. <i>Për sa më sipër, <u>GVJ sugjeron</u> pajisjen e bibliotekës edhe me poste kompjuteri në mënyrë që studentët dhe personeli akademik të mund të shfrytëzojnë këto asete për zhvillimin e tyre akademik. Megjithatë, platformat online janë të disponueshme dhe mund të aksesohen në çdo moment dhe nga çdo vend nga studentët dhe personeli akademik.</i> Evidenca <i>Evidencë IV.19 rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Evidencë IV.24 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale JSTOR</i> <i>Evidencë IV.23 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale të FGJH</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë takimeve me studentët si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka është në dispozicion të studentëve, sipas orareve të koordinuara të zhvillimit të procesit mësimor dhe këto orare janë të afishuara. Përkatësisht nga ora 08:00 e mëngjesit deri në orën 16:30 të pasdites përveç ditës së premte ku shërbimi ofrohet deri në orën 14:00, përveç ditëve të festave zyrtare. Personeli akademik dhe studentët konfirmuan gjatë takimeve në FGJH se gjithmonë kanë marrë shërbim nga biblioteka dhe komunikimi me personin përgjegjës ka qenë relativisht i mirë. GVJ konstatoi se nuk ka patur raste të mos ofrimit të shërbimit, të humbjes së literaturës së huazuar apo mos kthim të materialeve brenda afateve të përcaktuara. Evidenca <i>Evidencë IV.19 rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Evidencë IV.24 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale JSTOR</i> <i>Evidencë IV.23 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale të FGJH</i>

Kriteri 8.Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ konstatoi se biblioteka ka një rregullore specifike në të cilën përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, procedurat e përditësimit të fondit të bibliotekës dhe mënyrat e huazimit të titujve. FGJH ndjek një procedurë të rregullt ligjore të përditësimit të titujve e cila realizohet nëpërmjet blerjes, dhurimit ose shkëmbimit të teksteve ose botimeve. Në fillim të vitit akademik, personeli akademik paraqet një kërkesë në drejtim të përgjegjësit të njësisë bazë lidhur me përditësimet e nevojshme të fondit të bibliotekës për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim. Përgjegjësi i njësisë bazë ia përcjell këtë listë dekanit i cili më pas ia përcjell rektoratit dhe sipas mundësive bëhet e mundur përditësimi i fondit të bibliotekës. Përgjegjësi i bibliotekës bën gjithashtu inventarizimin e titujve sipas standardeve të vendosur nga shoqata ndërkombëtare e bibliotekave. Përgjegjësi i bibliotekës është gjithashtu i përfshirë në trajnime të ndryshme në kuadër të përditësimit dhe mirëmbajtjes së bibliotekës. GVJ e konstatoi këtë gjë gjatë takimeve në FGJH kur përgjegjësi i bibliotekës deklaroi se ka ndjekur një trajnim për të cilin edhe do të testohet në mënyrë që të certifikohet për detyrën e tij. Evidenca <i>Evidencë IV.19 rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Evidencë IV.24 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale JSTOR</i> <i>Evidencë IV.23 screenshot i linkut të bibliotekës digjitale të FGJH</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se:</i> <i>FGJH ofron një bibliotekë të pasur me tekste universitare, libra, revista shkencore dhe fjalorë për të gjitha gjuhët që ofron, të cilat përdoren nga studentët e programit Master në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim, megjithatë <u>GVJ sugjeron që literatura e përcaktuar në sylabuse duhet të përditësohet me materiale të paktën të pesë viteve të fundit, për të siguruar që studentët të kenë akses në informacionin më të ri dhe relevante</u></i> <i>Edhe pse biblioteka është e pajisur me poste leximi, ajo nuk ka poste kompjuterësh për përdorim nga studentët dhe personelin akademik, gjë që pengon procesin e kërkimit shkencor. <u>GVJ sugjeron pajisjen e bibliotekës me këto poste për të lehtësuar punën e studentëve.</u></i>

	<i>Shërbimet dhe procedurat e bibliotekës janë të rregulluara në rregulloren e brendshme, që përfshin pasqyrimin e të drejtave dhe detyrave të përdoruesve dhe procedurat e huazimit të titujve. FGJH ofron akses në shërbime online si JSTOR dhe EBSCO, ku studentët dhe personeli akademik mund të shkarkojnë materiale shkencore dhe informacion të nevojshëm, si brenda ambientit të institucionit ashtu edhe jashtë tij, duke përdorur llogaritë e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare të FGJH ka seksione të veçanta që shërbejnë për të aksesuar informacione të ndryshme lidhur me aktivitetin mësimor si orari, lajmërimi, të dhëna mbi fakultetin, departamentin, programin e studimit, rregulloren e institucionit etj. Përveç faqes së internetit, informacioni publikohet në forma të tjera si nëpërmjet fletëpalosjeve, shpalljeve publike në xham, sekretaria mësimore ose dërgimit me email. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve, mbajtjen e procesverbaleve të rezultateve të provimit, arkivimin e dosjeve të diplomimit si edhe informimin e studentëve sa herë që ato drejtohen në këto zyra. Gjithashtu, FGJH ofron edhe platformën e-student për studentët i cili operon në bazë të moduleve të ndryshme. Studentët dhe personeli akademik mund ta përdorin këtë platformë për të shkëmbyer informacione ndihmuese dhe orientuese në ndihmë të lehtësimit të jetës akademike. Në këtë platformë, sekretaria mësimore vjen në ndihmë të studentëve duke i njoftuar ato mbi orarin ose programin dhe personeli akademik duke i njoftuar studentët mbi vlerësimin. Evidenca

	<i>Evidencë IV.26 rregullore e brendshme e punës për organizimin dhe funksionimin e administratës së UT</i> <i>Evidencë III.34 rregullore për funksionimin e sistemit informativ në UT</i> <i>Evidencë III.35 manual sistemi e-student</i> <i>Evidencë III.37 rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore anglisht dhe frëngjisht</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Mbështetur në vizitën e kryer në FGJH, GVJ konstatoi se sistemi i brendshëm i menaxhimit dhe administrimit të informacionit, realizohet nëpërmjet strukturave të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit. FGJH ka një koordinim të mirë mes strukturave në ndarjen e informacionit, të dhënave, ruajtjen dhe përditësimin e dosjes së personelit. Koordinimi i brendshëm realizohet edhe nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara, specifike për departamentet ose të përbashkëta me njësinë kryesore. Një rol shumë të rëndësishëm në menaxhimin e brendshëm luan edhe sekretaria mësimore. Ajo bashkëpunon me personelin akademik, studentët apo çdo njësi tjetër, duke ofruar ndihmën për çdo informacion të nevojshëm nga ana e saj. Email-i zyrtar shërben si një tjetër mjet për shkëmbimin e informacionit dhe menaxhimin të brendshëm. Emaili zyrtar është në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve dhe nëpërmjet tij ata mund të bashkëpunojnë nëpërmjet grupeve për të shkëmbyer informacione, lajmërimi apo materiale mësimore. Nga ana tjetër, zyra e burimeve njerëzore administron dosjet e personeli akademik, ndjek procedurat e shpërndarjes dhe grumbullimit të kontratave të punës, ruan të dhënat personeli të punonjësve në regjistra mban librezat e punës dhe evidenca të tjera të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës në FGJH. Gjithashtu, FGJH ka miratuar edhe një rregullore specifike mbi vlerësimin e performancës në punë për personelin ndihmës akademik dhe administrativ. Evidenca <i>Evidenca IV.26 rregullore e brendshme e punës për organizimin dhe funksionimin e administratës së FGJH</i> <i>Evidencë VI.19 rregullore mbi vlerësimin e performancës së personelit ndihmës akademik dhe administrativ</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të	Mbështetur në takimet e zhvilluara në FGJH, GVJ konstatoi se ky institucion përdor sisteme informimi. Informacioni mund të

dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	jetë i brendshëm ose publik. Në të dyja rastet, mënyra e shpërndarjes së informacionit ndryshon, duke respektuar të dhënat personale dhe informacionin diskret. Sistemi e-student përdoret edhe nga studentët edhe nga personeli akademik por edhe nga sekretaria mësimore. Kryesisht ky sistem ka për funksion ofrimin e dokumenteve për personelin akademik dhe programet e studimit për studentët. Të dhëna të tjera të cilat disponohen në këtë platformë lidhen me orarin, kurset, lëndët, listën e studentëve, frekuentimin e studentëve në kurset që janë regjistruar. Informacion tjetër që disponohet në këtë platformë lidhen me procesverbalet e vlerësimit të studentëve, format e kontrollit. Platforma mund të përdoret në mënyrë individuale nga secili përdorues. FGJH ka vendosur në dispozicion të përdoruesve të tij edhe manualin e përdorimit të kësaj platforme. Një platformë tjetër e cila përdoret nga studentët dhe personeli akademik është edhe platforma TEAMS ku ngarkohen detyra, materiale mësimore dhe njoftime për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Evidenca <i>Evidencë III.35 manual sistemi e-student</i> <i>Evidencë III.34 rregullore e funksionimit të sistemit informativ në UT</i> <i>Evidencë III.33 shpallja e datave të detyrime përmbyllëse në mënyrë zyrtare</i> <i>Evidencë III.31 dhe 32 detyrë e ngarkuar në platformën TEAMS</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstatoi se sistemi Teams, Outlook dhe e-student janë në shërbim të personelit akademik dhe studentëve për të shkëmbyer informacione, emaile, materiale didaktike. Këto sisteme janë gjithashtu të aksesueshme nga sekretaria mësimore, e cila bën të mundur njoftimin e secilit student mbi vlerësimin, orarin apo çdo të dhënë tjetër që mund të kërkohet. Nëpërmjet këtyre sistemeve edhe njësitë brenda FGJH është më i lehtë komunikimi apo gjenerimi i të dhënave të nevojshme, në një kohë shumë të shkurtër. Evidenca <i>Evidencë III.35 manual sistemi e-student</i>

	<i>Evidencë III.34 rregullore e funksionimit të sistemit informativ në UT</i> <i>Evidencë III.33 shpallja e datave të detyrime përmbyllëse në mënyrë zyrtare</i> <i>Evidencë III.31 dhe 32 detyrë e ngarkuar në platformën TEAMS</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ gjatë takimeve në FGJH konstatoi se, sistemet e deklaruara të tilla si Teams, Outlook dhe microsoft office 365 education janë funksionale dhe e kanë lehtësuar komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm si edhe lehtësojnë mënyrën e raportimit apo realizimit të procesit mësimor. Këto platforma ofrojnë shërbime të ndryshme si ndërtimin e klasave bashkëpunuese të cilat janë efektive kryesisht për detyra të cilat mund të zhvillohen në distancë ose në mënyrë individuale nga studenti, mban lidhjet me personelin akademik, studentin dhe sekretarinë mësimore dhe funksionojnë nëpërmjet një email-i zyrtar. Evidenca <i>Evidencë IV.27 manual i përdorimit microsoft teams për studentët e universitetit të UT</i> <i>Evidencë III.35 manual sistemi e-student</i> <i>Evidencë III.34 rregullore e funksionimit të sistemit informativ në UT</i> <i>Evidencë III.31 dhe 32 detyrë e ngarkuar në platformën TEAMS</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se në faqen e internetit të FGJH jepen informacione mbi programin e studimit Master i shkencave në Përkthim Teknik-Letër dhe Interpretim, jepen informacione lidhur me kreditet, ndarjen vjetore të lëndëve, kontaktet institucionale, CV e personelit, lajmërimi. Faqja ofrohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe angleze. Gjithashtu, sistemi Teams, Outlook dhe e-student janë në shërbim të personelit akademik dhe studentëve për të shkëmbyer informacione, emaile, materiale didaktike. Evidence <i>Evidencë IV.27 manual i përdorimit microsoft teams për studentët e universitetit të UT</i> <i>Evidencë III.35 manual sistemi e-student</i> <i>Evidencë III.34 rregullore e funksionimit të sistemit informativ në UT</i>

	https://fgjh.edu.al/			
Konkluzione	GVJ konstaton se: FGJH ofron seksione të veçanta ku studentët dhe personeli akademik mund të aksesojnë informacion të rëndësishëm lidhur me aktivitetin mësimor, përfshirë oraret, lajmërimet, programet e studimit dhe rregulloren e institucionit. Informacioni publikohet në mënyra të ndryshme përmes faqes zyrtare, përfshirë fletëpalosje, shpallje publike dhe dërgimin e informacionit përmes emailit, duke siguruar që të gjithë aktorët e përfshirë të informohen për çdo zhvillim. FGJH ofron platformën e-Student, e cila është e disponueshme për studentët dhe personelin akademik. Kjo platformë është një mjet efektiv për shpërndarjen e informacionit, orareve, kurseve dhe vlerësimeve. FGJH ka vendosur një sistem të menaxhimit dhe administrimit të informacionit që lehtëson komunikimin dhe shpërndarjen e të dhënave mes strukturave të ndryshme. FGJH përdor sisteme si Microsoft Teams dhe Outlook për të lehtësuar shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin mes studentëve dhe personelit akademik. Këto platforma ofrojnë mundësi për ndarjen e materialeve didaktike, detyrave dhe informacioneve të tjera të rëndësishme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për	Pas takimeve të zhvilluara në FGJH, si edhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se ky institucion nuk harton një plan financiar të kostove specifike për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim por harton një planifikim lidhur me

mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	kostot mesatare të studentëve në nivel universiteti. Në SA dhe BA paraqiten raportet financiare të UT për miratim. Analiza financiare në fjalë pasqyron kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Megjithatë, në buxhet përfshihen zërat e njësive kryesore dhe prioritet u jepen atyre njësive të cilat pritët të gjenerojnë më shumë të ardhura nga investimi që do të realizojnë. <i>GVJ e konsideron në domosdoshëm ndjekjen e një procedure të caktuar lidhur me planifikimin dhe përdorimin e burimeve financiare, duke përcaktuar nevojat financiare specifike për këtë program studimi dhe jo vetëm për universitetin. Gjithashtu, GVJ sugjeron ofrimin e shanseve të barabarta të gjithë njësive kryesore pa diferencuar pritshmëritë që mund të ketë secila.</i> Evidenca <i>Evidencë IV.28 Raporti vjetor i UT 2020- 2021</i> <i>Evidencë IV.29 të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit</i>
Kriteri 2.Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në vizitat në FGJH, GVJ konstatoi se njësitet kryesore hartojnë një plan financiar buxhetor i cili i bashkëlidhet planeve të të gjitha njësive dhe dërgohet në SA për miratim. Të gjitha shpenzimet e parashikuara në këtë plan financiar lidhen me nevojat e njësive bazë për të përmirësuar procesin mësimor dhe ndihmuar personelin akademik dhe studentët në këtë aspekt. Shpenzimet lidhen kryesisht me financimin e udhëtimeve, kërkimit shkencor, fondin e bibliotekës, trajnimeve, shërbimeve operative, etj. UT bën mbledhjen e të ardhurave nëpërmjet dy mënyrave. Njëra lidhet me fondin e alokuar nga MAS dhe mënyra e dytë lidhet me vetë-gjenerimin e të ardhurave nga shërbime të ndryshme që UT ofron ose tarifat e studentëve. Shpërndarja e këtyre të ardhurave të grumbulluara bëhet në bazë të kërkesave që njësitet kryesore kanë bërë si edhe për nevoja të shërbimeve administrative që ofron nga njësitet kryesore. Projekt-buxheti, pasi merr formën përfundimtare miratohet në Senatin Akademik pas shqyrtimit paraprak nga Rektorati. Evidenca <i>Evidencë IV.30 Kërkesat buxhetore të departamenteve</i>

	<i>Evidencë IV.28 Raporti vjetor i UT 2020- 2021</i> <i>Evidencë IV.29 të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ konstatoi se në zbatim të politikës së transparencës së përdorimit të burimeve financiare, FGJH dhe vetë UT i nënshtrohet auditimit të jashtëm dhe të brendshëm financiar. Sipas RVB një gjë e tillë është e parashikuar edhe në organigramën e universitetit. Më specifikisht në varësi të administratorit të UT është ngritur një strukturë e cila njihet si Njësia e Auditimit të Brendshëm. Sikurse parashikohet në RVB kjo strukturë raporton çdo vit mbi gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të UT, ofron një pasqyrë financiare lidhur me të ardhurat nga tarifat apo kontribute të tjera. Për këtë program studimi nuk ka patur një raport auditimi nga struktura përkatëse. Megjithatë nga FGJH është vënë në dispozicion një shkresë e cila lidhet me miratimin e buxhetit, por parashikim financiar apo raportim bashkëlidhur nuk ka. Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 53 dhe neni 57 Funksionet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidencë IV.28 Raport vjetor UT për vitin akademik 2021</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sikurse konfirmohet edhe nga takimet e zhvilluara në ambientet e FGJH, GVJ konstatoi se UT bën një raportim të përvitshëm të aktivitetit financiar nëpërmjet raportit analitik të institucionit mbi veprimtarinë financiare të tij. Raportimi bëhet deri në nivel njësie bazë, referuar edhe kërkesave të njësisë për buxhetin, sipas një planifikimi paraprak. Kjo procedurë forcon edhe transparencën financiare brenda institucionit. Evidenca <i>Evidencë IV.16 Listë shembull e kërkesës për blerje fondi libri së njësisë kryesore drejtuar rektoratit të UT</i> <i>Evidencë 4.30 Kërkesat buxhetore të departamenteve (shembull departamenti i gjuhës gjermane)</i> <i>Evidencë IV.28 Raport vjetor UT për vitin akademik 2021</i>

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Gjatë takimeve në mjediset e FGJH, GVJ konstatoi se ky UT garanton qëndrueshmëri financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit master i shkencave në përkthim teknik-letrar dhe interpretim. Kjo pasi UT garanton kapacitete infrastrukturore dhe burime njerëzore të mjaftueshme për realizimin e tij. Gjithashtu, UT garanton një qëndrueshmëri financiare nëpërmjet fondeve të alokuara nga MAS si edhe nga fondet të cilat vetë universiteti i gjeneron nëpërmjet tarifave të studimit, projekteve të ndryshme, donacioneve apo shërbimeve që universiteti ofron te studentët apo palët e treta. Gjatë takimeve me personelin akademik, GVJ konstatoi se UT u garanton atyre mbështetje financiare nëse dëshirojnë të kryejnë aktivitet kërkimor shkencorë, të marrin pjesë në konferenca, të sigurojnë fonde të teksteve të nevojshme. Evidenca <i>Evidencë IV.16 Listë shembull e kërkesës për blerje fondi libri së njësisë kryesore drejtuar rektoratit të UT</i> <i>Evidencë IV.18 kontrata e blerjes së fondit të librit për vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023</i> <i>Evidencë IV.30 Kërkesat buxhetore të departamenteve (shembull departamenti i gjuhës gjermane)</i> <i>Evidencë IV.45 dhe 46 konferenca ndërkombëtare studentore</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se: <i>FGJH garanton qëndrueshmëri financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit përmes kapaciteteve infrastrukturore dhe burimeve njerëzore të mjaftueshme. Sipas deklarimeve në RVB, kjo gjë realizohet nëpërmjet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Megjithatë, GVJ konstatoi se nuk ka një raport të mirëfilltë audimi bashkëlidhur në dokumentacionin e vënë në dispozicion për të identifikuar raportimet e bëra nga FGJH në një vit akademik. Një raport i tillë do të ofronte një pasqyrë financiare lidhur me të ardhurat nga tarifat apo kontribute të tjera të gjeneruara nga ky program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat e miratuara për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim lidhur me pranimin e studentëve e në vazhdimësi deri në përfundim të studimeve, janë të përcaktuara në statutin e universitetit të Tiranës, rregulloren e universitetit dhe rregulloren e programit të studimit dokumente këto ku specifikohen kriteret e pranimin, procedura e pranimin dhe numri i kuotave të miratuara mbështetur në aktet ligjore në fuqi. Ky program studimi ka një kohëzgjatje prej dy viteve akademike dhe 120 kredite ECTS. Një nga kriteret e pranimin të studentëve në këtë program studimi është nota mesatare e përcaktuar nga departamenti. Gjatë takimeve të zhvilluara me GVJ në këtë fakultet u deklarua se të gjithë këto elementë si kuotat, kriteret e pranimin dhe procedurat e pranimin publikohen në faqen zyrtare të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, si edhe në rrjetet sociale të këtij fakulteti. Në kuotat e pranimin përfshihen edhe kuotat e transferimeve për studentët të cilët duan të transferojnë studimet nga universitete të tjera në këtë program studimi. Përfundimi i studimeve finalizohet me përgatitjen e një teme diplome dhe pas mbrojtjes me sukses të saj studenti pajiset me një diplomë "Master i Shkencave" në "Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim". Mbështetur në takimet në FGJH, GVJ konstatoi se fakulteti është duke bashkëpunuar me universitetin e Strasburgut për të ofruar mundësinë e diplomës së dyfishtë me këtë universitet. <i>Megjithatë, hapi i parë ishte riorganizimi i programit të</i>

	<i>studimit për ta përshtatur atë me programin që ofrohet në universitetin e Strasburgut dhe më vonë mund të ketë një bashkëpunim në ofrimin e diplomave të dyfishta.</i> Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti I Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidencë 1.21 Rregullore e programit të studimit master I shkencave në përkthim Teknik letrar dhe interpretim</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se studentët të cilët dëshirojnë të studiojnë në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në universitetin e Tiranës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke respektuar të drejtat dhe detyrimet e studentëve, specifika këto të pasqyruara në rregulloren e programit të studimit, rregulloren dhe statutin e universitetit. Studentët informohen mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, kuotat e pranimi dhe procedurat e pranimi nga sekretaria mësimore por edhe nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit, konkretisht të UT-së dhe FGJH-së. Duke qenë një program studimi i cili ofrohet në bashkëpunim me universitetin e Strasburgut, programi është riorganizuar deri në masën 20% për tu përshtatur me programin e studimit që ofrohet nga universiteti i Strasburgut. Kjo masë është marrë pasi përveç studentëve shqiptar në këtë program studimi mund të regjistrohen edhe studentë të huaj të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe të publikuara nga departamenti. Një nga kushtet që këta studentë të huaj të bëhen pjesë është mbrojtja e gjuhës shqipe në nivelin B1-B2. Nga deklaratat gjatë vizitave në FGJH, GVJ konstatoi se kryesisht studentët rus dhe ukrainas që janë vendosur në Shqipëri gjatë viteve të fundit kanë qenë të interesuar për ndjekjen e këtij programi studimi. Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidencë 1.21 Rregullore e programit të studimit master i shkencave në përkthim Teknik letrar dhe interpretim</i>

	https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Mbështetur në takimet në fakultet por edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion GJV konstatoi se studentët që ndjekin studimet në programin Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim kanë të drejtë të transferohen. Studentët njihen me procedurën dhe kushtet e transferimit si edhe afatet në universitet, departament, nëpërmjet këshillit studentor ose nëpërmjet faqeve zyrtare të universitetit dhe fakultetit. Studentët kanë të drejtë të transferohen përpara fillimit të vitit të ri akademik. Kuotat e pranimi përcaktohen nga senati akademik ndërsa kriteret nga departamenti. Kriteret propozohen nga njësi bazë e cila ngre një komision të vlerësimit të aplikimeve dhe miratohen nga rektori. Publikimi i tyre në faqen zyrtare bëhet vetëm pas miratimit nga Dekani. Më pas UT përcjell në QSHA listën me emrat e studentëve fitues dhe të regjistruar, për ti pajisur studentët me numër matrikullimi. Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/ <i>Evidencë V.2 Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimi 2022</i> <i>Evidencë II.14 Vendim i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimi 2021</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve bëhet nëpërmjet një procedure të rregullt ligjore duke respektuar edhe afatet ligjore. Përfitojnë të drejtën për të studiuar në programin Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim studentët të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve, në Shqipëri ose në Strasburg. Për studentët e huaj është kusht njohja e gjuhës shqipe në nivelin B1-B2. Këto studentë të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në një universitet të huaj përfitojnë nga kjo e drejtë nëse diploma e tyre është njësuar paraprakisht nga MAS (QSHA). Hapja e procedurave të aplikimit, kriteret, oraret, datat e veprimeve të regjistrimit apo çdo detaj tjetër i

	nevojshëm për regjistrimin bëhet publike në faqen zyrtare të FGJH dhe UT. Megjithatë, studentët mund të marrin informacion edhe në ambientet e fakultetit. Lidhur me përparimin akademik GVJ konstatoi se kriteret e vlerësimit të dijeve dhe diplomimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit dhe publikohen në faqen zyrtare të FGJH. Detyrimet e studentëve lidhur me pjesëmarrjen, mënyrën e vlerësimit, literaturën e nevojshme u bëhen me dije studentëve në orën e parë të mësimit nga lektori i lëndës në fillim të vitit akademik. Gjithashtu, të dhëna të tjera lidhur me përparimin akademik janë të përcaktuara edhe në sillabuset e secilës lëndë. Sillabusi u bëhet me dije studentëve në orën e parë të mësimit nga lektori i lëndës. Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidencë 1.21 Rregullore e programit të studimit master i shkencave në përkthim Teknik letrar dhe interpretim</i> <i>Evidencë V.4 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2022-2023</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstatoi se FGJH ndjek procedura të rregullta dhe të periodike mbi informimin lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim. Këto procedura janë të përcaktuara qartë në statutin e universitetit, rregulloren e UT dhe atë të programit të studimit. Një mënyrë informimi është publikimi i kriterëve dhe procedurës në faqen zyrtare të internetit, nëpërmjet broshurave si edhe gjatë ditëve të informimit me palët e interesuar. Për më tepër, nëse studentët drejtohen në fakultet, departament apo çdo strukturë tjetër përgjegjëse, ato mund të marrin informacionin e nevojshëm, qartë dhe në detaje. Kriteret e përcaktuara nga departamenti bëhen publike jo më vonë se data 20 dhjetor të vitit paraardhës akademik. Evidenca

	<i>Evidencë 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidencë 1.21 Rregullore e programit të studimit master i shkencave në përkthim Teknik letrar dhe interpretim</i> <i>Evidencë V.4 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2022-2023</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njofitime/
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se FGJH ndjek një procedurë të veçantë dedikuar përzgjedhjes dhe regjistrimit të studentëve me aftësi ndryshe dhe asaj kategorie që vjen nga shtresat në nevojë. Kanë të drejtë për të aplikuar në këtë program studimi individë të cilët gëzojnë statusin e jetimit, personit me aftësi të kufizuar, kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian. Lista e dokumentacionit që të interesuarit duhet të dorëzojnë në momentin e aplikimit është specifike për secilën kategori. Ky informacion u bëhet me dije përpara aplikimit. Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të këtyre kategorive miratohen konform udhëzimit të ministrisë së arsimit ose akteve të tjera ligjore në fuqi. Evidenca <i>Evidencë V.6 udhëzim i MAS nr 10, datë 15.05.2019</i> <i>Evidencë V.7 udhëzim i MAS nr 17, datë 30.07.2019</i> <i>Evidencë V.8 vendim nr 39, datë 23.01.2019</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstatoi se institucioni shpall kriteret specifike të pranimit në programin e studimit, studentët nga shtetet e tjera shqipfolëse, të cilët zotërojnë të paktën diplomën universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Për studentët e huaj të cilët kanë përfutur një diplomë nga një shtet tjetër, kriteri pranimi është njohja e diplomës nga MAS si edhe njohja e gjuhës shqipe në nivelin B1-B2. Legjitim për tu regjistruar në këtë program studimi janë edhe student nga Kosova, Maqedonia e veriut, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci. Një kriter specifik për këto studentë është njohja e gjuhës shqipe e cila duhet të dokumentohet nëpërmjet një certifikatë me nivelin B1-B2. Lista përfundimtare me emrat e fituesve bëhet publike në faqen zyrtare të internetit por edhe afishohet në ambientet e fakultetit. Specifikë për shtetasit e huaj që aplikojnë nëpërmjet marrëveshjes dypalëshe është

	përfshirja nga tarifa e studimit. Një kusht i tillë është përcaktuar në marrëveshjen dypalëshe mes universitetit të Strasburgut dhe universitetit të Tiranës për këtë program studimi. Evidenca <i>Evidencë V.5 udhëzim i MAS nr 26, datë 30.07.2018</i> <i>Evidencë V.6 udhëzim i MAS nr 10, datë 15.05.2019</i> <i>Evidencë V.7 udhëzim i MAS nr 17, datë 30.07.2019</i> https://fgjh.edu.al/
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ pas takimeve të zhvilluara në FGJH dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatoi se Programi i Studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim ofron mundësi të pajisjes së studentëve në nevojë me bursa. Detajet e përfitimit, kategoritë dhe masat e përfitimit parashikohen në akte të posaçme ligjore. Studentët në nevojë klasifikohen në bazë të kriterit ekonomik. Bursat pas vitit të parë të studimeve rishikohen dhe miratohen nga UT. Në takimet e zhvilluara në FGJH rezultoi se njësitë bazë verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme frekuentimin e mësimit nga kjo kategori përfituese e bursave. Evidenca <i>Evidencë V.8 vendim nr 39, datë 23.01.2019</i>
Konkluzione	GVJ konstatoi se: <i>programi i studimit Master të Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim ka një qëndrim të qartë mbi kriteret dhe procedurat e pranimit në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës dhe rregulloret përkatëse;</i> <i>Studentët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe informohen mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre përmes sekretarive mësimore dhe faqeve zyrtare të fakultetit, përfshirë edhe njoftimet për kuotat dhe procedurat e pranimit. Studentët kanë mundësi të transferohen në këtë program, dhe informacioni për procedurat e transferimit është i qartë dhe i aksesueshëm përmes strukturave universitare dhe faqeve online.</i>

	<i>Fakulteti ndjek një procedurë të veçantë për përzgjedhjen e studentëve me aftësi ndryshe dhe ata që vijnë nga kategoritë në nevojë. Studentët nga shtetet shqipfolëse plotësojnë kushte të veçanta për t'u regjistruar, duke përfshirë njohjen e diplomave nga autoritetet përkatëse. Kriteri i rëndësishëm është njohja e gjuhës shqipe në nivelin B1-B2. Programi ofron mundësi përfitimi bursash për studentët në nevojë, me detaje të përcaktuara në akte ligjore të posaçme. Kështu, çdo vit rishikohen dhe miratohet statusi dhe frekuentimi i kësaj kategorie studenti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Pas vizitave në FGJH dhe shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion GJV konstatoi se ky fakultet ofron një informacion të qartë mbi procedurat e pranimit në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim. Kriteret e pranimit përcaktohen përpara fillimit të vitit akademik dhe bëhen publike në faqen zyrtare të internetit. Në faqen zyrtare të internetit të FGJH dhe UT publikohet një përshkrim i planit mësimor dhe lëndët që studentët do të ndjekin, kreditet e secilës lëndë, mënyrat e kontrollit të dijes, totali i krediteve që do të përfitojnë në përfundim të programit të studimit. Gjithashtu, në procesin e shpërndarjes së informacionit për specifikat e lëndës ndihmon edhe personeli akademik, duke i informuar studentët jo vetëm në fillim të vitit akademik kur prezanton sillabusin por gjatë gjithë periudhës së studimeve mbi specifikat e programit të studimit, mënyrën e vlerësimit, detyrimin për frekuentim, etj. Më konkretisht, studentët duhet të ndjekin këtë program studimi përgjatë dy viteve akademike dhe për tu diplomuar duhet të fitojnë 120 kredite. Studenti ka të drejtë të kalojë në vitin e dytë, vetëm kur

	ai ka fituar të paktën 30 ETCS në vitin e parë. Mënyra e ndjekjes së këtij programi studimi është me kohë të plotë dhe orët mësimore janë me frekuentim të detyrueshëm. Vlerësimi përfundimtar është i shpërndarë mes detyrave, projekteve, provimeve dhe seminareve. Vlerësimi ka një shkallë prej 5 nota më e ulët dhe 10 nota maksimale. Nga nota 5 në notën 10 vlerësimi është kalues dhe nën notën 5 është jo kalues. Nëse studenti nuk plotëson detyrimet akademike të përcaktuara në programin e lëndës, ai nuk pranohet në provim. Këto specifika janë të përcaktuara edhe në sillabuset e secilës lëndë dhe përveçse u bëhen me dije studentëve në orën e parë të mësimin, publikohen edhe në faqen zyrtare të internetit. Evidenca <i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore e Programit të Studimit MSHPTI</i> <i>Evidenca II.2 Rregullore e diplomimit e programeve master</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstatoi se FGJH në politikat e brendshme lejon transferimin e studentëve dhe pranon transferime të studentëve nga universitete të tjera. Studentët kanë të drejtë të transferojnë studimet e tyre përmes sistemit të krediteve ECTS përpara fillimit të vitit akademik dhe në fusha të njëjta ose të përafërta studimi. Statuti i UT dhe Rregullorja e UT specifikon qartë kriteret dhe procedurat lidhur me njohjen e kualifikimeve të mëparshme si edhe procedurat e transferimit. Sekretaria mësimore u vjen në ndihmë studentëve për ti informuar rreth kriterëve dhe procedurave që duhet të ndjekin në secilin rast. Një mjet tjetër i shpërndarjes së këtij informacioni përveç komunikimit me personelin akademik ose departamentin është edhe faqja zyrtare e internetit. Studentët mund ti drejtohen faqes zyrtare të FGJH ose UT për të marrë informacionin e nevojshëm në rast se nuk mund të paraqiten fizikisht në ambientet e fakultetit. Gjithashtu, FGJH u ofron studentëve mundësinë për të ndjekur një semestër në një nga universitetet e huaja me të

	cilat UT ka marrëveshje bashkëpunimi. Shkëmbimi i studentëve ndihmon në diversitetin kulturor dhe akademik si edhe i ndihmon studentët të njohin veten dhe të qartësohen për të ardhmen e tyre. Përgjegjësi i departamentit, zyra e këshillimit të karrierës, personeli akademik dhe çdo strukturë tjetër në FGJH u vijnë në ndihmë studentëve si përpara largimit të tyre ashtu edhe pasi ato kthehen. Departamenti bën njohjen e krediteve të përfituara në universitetin e huaj si edhe kur është e nevojshme hapet një sezon i veçantë që këta studentët të mund të japin provimet dhe të mos humbasin vitin akademik. Evidenca <i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore e Programit të Studimit MSHPTI</i> <i>Evidenca II.20 Procedurë njohje dhe ekuivalentimi lëndësh</i> <i>Evidencë III.43.1 mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen e lëvizshmërisë së tyre</i> <i>Evidencë III.43.2 mobilitetet dalëse dhe hyrëse erasmus+ në FGJH</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi se FGJH zbaton një politikë transparente lidhur me informimin e studentëve mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Informimi i studentëve realizohet në fillim të vitit akademik, kryesisht në orën e parë të leksionit ku personeli akademik bën jo vetëm prezantimin e lëndës por edhe të sillabusit duke i njohur studentët me mënyrën sesi do të vlerësohen, si do të bëhet shpërndarja e vlerësimit, sa është detyrimi i frekuentimit. Përveç personelit akademik, edhe rregullorja e UT përcakton qartë procedurat dhe kriteret e vlerësimit të dijeve të studentëve. Gjithashtu, studentët informohen për mënyrën e vlerësimit nga personeli akademik ditën e parë të mësimit kur bëhet edhe prezantimi i sillabusit. Thënë kjo, mbështetur edhe në sillabuset e vëna në dispozicion, studentët vlerësohen për pjesëmarrjen në leksione dhe seminare, detyra apo projekte të ndryshme që mund të zhvillohen gjatë semestrit, provimi përfundimtar dhe ai i

	ndërmjetëm. Platforma Teams është një platformë online e cila shërben për shpërndarjen e informacionit. Personeli akademik ngarkon në këtë platformë sillabusin si edhe çdo informacion tjetër i cili mund të jetë i dobishëm për studentin. Një tjetër platformë e cila vjen në ndihmë të studentëve dhe personelit akademik apo sekretarisë mësimore për shpërndarjen e informacionit është edhe platforma e-student. Në këtë platformë kanë akses studentët, personeli akademik dhe sekretaria mësimore. Kryesisht kjo platformë shërben për informimin e studentëve rreth vlerësimit të tyre, orarit mësimor apo planit mësimor dhe sillabusit. Evidenca <i>Evidenca 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore e Programit të Studimit MSHPTI</i> <i>Evidenca sillabuse DGJA, DGJF, DGJGJ, DGJS</i> <i>Evidencë III.29 Model teze me shkrim</i> <i>Evidencë III.30 Model teze me gojë</i> <i>Evidencë III. 31 dhe 32 Detyrë e ngarkuar në platformën Teams</i> <i>Evidencë III.34 Rregullore për funksionimin e sistemit informativ</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstatoi se FGJH zbaton të drejtën e informimit për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim, që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomimin e tyre. Studentët dhe personeli i FGJH konfirmuan gjatë vizitave në institucion se pranë këtij fakulteti organizohen takime informuese me studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës. Ky informacion është gjithashtu i publikuar në faqen elektronike të UT. I lind e drejta për tu diplomuar të gjithë studentëve të këtij programi studimi që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare. Studentët diplomohen në vitin e dytë dhe mbrojnë një temë diplome. Studentët zgjedhin udhëheqësin dhe më pas së bashku përcaktojnë temën e diplomës, edhe pse një temë e përgjithshme është përcaktuar paraprakisht nga studenti. Detaje mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit gjenden në rregulloren e programit dhe në rregulloren e diplomimit ku specifikohet formati i shkrimit, rëndësia e etikës së kërkimit,

	organizimi i temës së diplomës dhe vlerësimi i saj. Gjatë dy viteve të studimit, studentët zhvillojnë edhe një lëndë të veçantë e cila i ndihmon ato të përgatisin temën e diplomës. Evidenca <i>Evidenca 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore e Programit të Studimit MSHPTI</i> Evidencë III.53 Rregullore diplomimi e programeve master https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstatoi se FGJH organizon përpara fillimit të vitit akademik takime informuese me të interesuarit për tu regjistruar në këtë program studimi. Konkretisht realizohen fushata informuese të paktën 6 muaj përpara fillimit të vitit akademik. Për të realizuar këto fushata ngrihen grupe pune specifike. Njësia kryesore bën kërkesë për miratim kuotash mbështetur në kapacitet pritëse që ka pas marrjes së propozimeve nga njësitë bazë. Të interesuarit e parë që informohen për aplikimin në këtë program studimi janë studentët e FGJH të cilët kanë përfunduar ose janë në përfundim të studimeve Bachelor. Secili departament organizon aktivitete informuese me këto studentë. Gjithashtu, ky informacion publikohet edhe në faqen zyrtare të FGJH dhe UT. U lind e drejta për të aplikuar në këtë program studimi të gjithë ato studentë të cilët plotësojnë kriteret ligjore të publikuara. Përveç aktiviteteve informuese në FGJH, ky program promovohet edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në panairë të ndryshme, si është panairi i punës dhe zyra e këshillimit të karrierës. Evidenca <i>Evidenca 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore e Programit të Studimit MSHPTI</i> <i>Evidencë II.4 Shkresë për komisionet e dosjeve të aplikantëve për regjistrimet në programet master</i> <i>Evidencë II.5 Procedurë e shpalljes së fituesve në programin MSHPTI</i>

	<i>Evidencë II.12 Kuotat dhe Kriteret e pranimit për programin MSHPTI</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se:</i> <i>FGJH ofron informacion të qartë mbi procedurat e pranimit në programin e Masterit Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim. Kriteret e pranimit publikohen në faqen zyrtare para fillimit të vitit akademik. Plani mësimor, lëndët, kreditet dhe mënyrat e kontrollit të dijes janë të publikuara në faqen zyrtare;</i> <i>FGJH lejon transferimin e studentëve nga universitete të tjera me sistemin ECTS. Procedurat e transferimit janë të qarta në Statutin e UT dhe në rregulloren e FGJH.</i> <i>Kriteret dhe procedurat e diplomimit janë të përcaktuara në rregulloren e FGJH. Studentët mund të kontaktojnë sekretarinë mësimore ose të vizitojnë faqet zyrtare për informacion të nevojshëm lidhur me procedurat dhe kërkesat e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ pas vizitave në FGJH konstatoi se ky institucion ndjek politika të qarta për informimin e studentëve lidhur me programin e studimi Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim. FGJH vendos në dispozicion të studentëve një sërë strukturash informimi, ku përfshihen rregullorja e programit, udhërrëfyesi i fakultetit, broshura informuese, si edhe njoftimet online të cilat bëhen në faqen zyrtare të FGJH dhe UT. Për më tepër, personeli akademik dhe sekretaria mësimore janë gjatë gjithë kohës të gatshëm të informojnë studentët për çdo pyetje apo paqartësi që ata mund të kenë lidhur me strukturën, organizimin apo kohëzgjatjen e programit të studimit që dëshirojnë të ndjekin.

	Evidenca <i>Evidenca 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore e Programit të Studimit MSHPTI</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton se FGJH i njeh studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim në fillim të vitit akademik me informacion të nevojshëm mbi sillabuset, modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Kjo gjë realizohet nëpërmjet aktiviteteve informuese të organizuara në ambientet e FGJH ose edhe nga vetë personeli akademik në orën e parë të mësimit. Megjithatë, përgjatë gjithë periudhës së studimeve FGJH informon nëpërmjet përgjegjësit të departamentit, sekretarisë mësimore, dhe nëpërmjet platformave online si e-student dhe Teams, mbi çdo informacion i cili është i nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor deri në diplomimin e studentit. Një informacion shumë i rëndësishëm për studentë është edhe mundësia për tu organizuar në klube të fushave të ndryshme për të dalë sado pak nga monotonja e studimit. Kryesisht ky informacion shpërndahet nga këshilli studentor por edhe nga personeli akademik apo faqja zyrtare e internetit ku publikohen foto të studentëve pararendës në aktivitete të ndryshme ku kanë marrë pjesë. Evidenca <i>Evidenca 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore e Programit të Studimit MSHPTI</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstatoi gjatë vizitave në institucion se Zyra e Këshillimit të Karrierës bashkëpunon me personelin akademik me qëllim informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës. Kjo gjë fillon kryesisht në semestrin e dytë të vitit të dytë pasi gjatë vitit të dytë studentët duhet të zhvillojnë për një semestër edhe praktikën mësimore. Praktika mësimore dhe kontakti i parë me tregun e punës nga ana e studentit dhe realizohet nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që FGJH ka nënshkruar me qëllim përmirësimin

	e performancës akademike të studentëve dhe aftësimin e tyre në tregun e punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës pas një studimi të tregut të punës, informon studentët për mundësitë e punësimit si edhe organizon aktivitete në formën e leksioneve të hapura për shkrimin e CV-ve dhe letër-motivimeve, panairë të punës Work & Study, leksione të hapura me institucione që ofrojnë mundësi rekrutimi dhe internship, etj. Gjithashtu kjo zyrë organizon edhe leksione të hapura me Alumnin, duke promovuar ish studentët e universitetit, me qëllim motivimin e studentëve aktualë. Alumni shpeshherë përfshihet në aktivitetet e FGJH duke kontribuar në mënyra të ndryshme si transmetimi i ideve, prezantimi i nismave inovatore, rekomandime për përmirësim, etj. Evidenca <i>Evidencë II.29 Dosje e praktikës së studentit</i> <i>Evidencë I.18 Manual i praktikës profesionale për programet master</i> <i>Evidencë I.19 Memorandume bashkëpunimi për praktikën mësimore dhe profesionale</i> <i>Evidencë II.17 Studimi i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja</i> <i>Evidencë III.8 leksion i hapur ALBAGLOBAL</i> <i>Evidencë III.9 leksion i hapur përkthimi dhe globalizimi</i> <i>Evidencë III.10 sfidat e përkthimit letrar</i> <i>Evidencë III.15 klasa TEAMS technology trainings FGJH</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se studentët e programit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letar dhe Interpretim informohen vazhdimisht për zhvillimin e procesit mësimor. Orari është i afishuar në ambiente të institucionit (në korridore në të dyja godinat) por kryesisht pranë sekretarisë mësimore si edhe është i publikuar në faqen zyrtare të FGJH. Studentëve u vihet në dispozicion çdo informacion i nevojshëm dhe i përditësuar lidhur me organizimin e procesit mësimor. Përpos publikimit të informacionit në faqen zyrtare, broshurat informuese dhe udhërrëfyese i fakultetit shërbejnë si mjete të informimit të studentëve. Studentët informohen gjithashtu edhe për mundësitë e organizimit në aktivitete ekstra kurrikulare ku mund të marrin pjesë. Kryesisht këto aktivitete lidhen me sportin, artin, aktivitete sociale për të ndihmuar shtresa të caktuara në nevojë,

	aktivitete kulturore, etj. Këshilli studentor dhe vetë strukturat informuese në FGJH u vijnë në ndihmë kryesisht studentëve të vitit të parë në këtë aspekt. Evidenca Evidencë III.3 dhe III.4 Plani mësimor 2016-2017 dhe 2023-2025 <i>Evidencë III. 28 Udhërrëfyese i FGJH</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstatoi se FGJH ofron për studentët e programit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim një sistem të brendshëm të informacionit nëpërmjet të cilit studentët mund të marrin informacion për çdo gjë lidhur me programin e studimit ose FGJH në përgjithësi, në çdo kohë dhe nga çdo distancë. Platformat online në dispozicion të studentëve shërbejnë si një sistem i brendshëm informacioni ku studentët mund të njoftohen për përditësime të ndryshme në distancë, pa qenë nevoja për tu paraqitur në mjediset e FGJH. Sistemi E-Student dhe Microsoft Teams janë sisteme online që shërbejnë për shkëmbimin e informacionit mes FGJH dhe studentëve kryesisht për informacione si konsultime mbi lëndën, regjistrimin për provimet, orarin e mësimi, vlerësimin apo çdo informacion tjetër i rëndësishëm për mbarrëvajtjen e procesit mësimor. Evidenca <i>Evidencë III.34 Rregullore për funksionimin e sistemit informativ në UT</i> <i>Evidencë III.35 Manual Sistemi E-student</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>FGJH ndjek politika të qarta për informimin e studentëve mbi programin Master në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim, duke ofruar një shumëllojshmëri burimesh informacioni, përfshirë rregulloren e programit, udhërrëfyese të fakultetit dhe broshura informuese, të cilat janë të disponueshme online në faqet zyrtare të institucionit;</i>

	<i>Personeli akademik dhe sekretaria mësimore janë të angazhuar në informimin e studentëve në lidhje me çdo pyetje apo paqartësi që ata mund të kenë. Informacioni ofrohet përmes aktiviteteve informuese, si në ambientet e fakultetit ashtu edhe në orët e mësimi.</i> <i>Zyra e Këshillimit të Karrierës bashkëpunon ngushtë me personelin akademik për të informuar studentët mbi mundësitë e punësimit dhe udhëheqjen e tyre drejt tregut të punës. Aktivitetet përfshijnë leksione të hapura mbi shkrimin e CV-ve, panairë pune dhe bashkëpunime me institucione për mundësi internship;</i> <i>FGJH ofron një sistem të brendshëm informacioni përmes platformave online, ku studentët mund të aksesojnë informacion të përditësuar lidhur me programin e studimit dhe të komunikojnë lehtësisht me fakultetin. Kjo lehtëson procesin e regjistrimit dhe konsultimit mbi lëndët dhe provimet;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Pas vizitave në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion GJV konstatoi se FGJH mban dhe përpunon të dhëna statistikore vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim. Më konkretisht, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për vitin akademik 2021-2022 janë diplomuar 67 studentë, për vitin akademik 2022-2023 43 studentë. Dokumentet ku regjistrohen këto të dhëna, përveç sekretarisë mësimore janë; regjistri themeltar i studentit, regjistri i arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Të dhëna të tjera të cilat regjistrohen në sekretarinë mësimore lidhen me procesverbalet e provimeve,

	studentët që aplikojnë për të studiuar në një program të tretë studimi, studentët që e humbasin këtë status ose transferohen, etj. Evidenca <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidencë V.15 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Pas vizitave në institucion si edhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se sekretaria mësimore mban listat me të dhënat e studentëve të regjistruar për herë të parë në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim. FGJH arkivon dokumentacionin për çdo student që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim të tij. Ruajtja e dokumentacionit bëhet në format hard-copy por edhe në versionin elektronik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion numri i studentëve për këtë program studimi është si vijon: në vitin akademik 2021-2022 janë regjistruar 64 studentë; në vitin akademik 2022-2023 janë regjistruar 62 studentë; në vitin akademik 2023-2024 janë regjistruar 60 studentë; në vitin akademik 2024-2025 janë regjistruar 65 studentë; Trendi për tu regjistruar në këtë program studimi është në rritje, duke dëshmuar edhe një kërkesë të shtuar nga tregu i punës për këtë profesion. Gjithashtu, sekretaria mësimore mban të dhëna të tjera statistikore si transferimet, tërheqjet nga program, largimet, pezullimet. Sekretaria mësimore administron regjistrat e posaçëm për secilin veprim, të dhënat përditësohen dhe përpunohen sipas procedurave institucionale dhe raportimeve të ndryshme kur kërkohet. Evidenca <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidencë V.14 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve të regjistruar në

duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	programin Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim menaxhohen nga FGJH. Të dhënat regjistrohen në formatin elektronik dhe hard-copy. Pjesë e sistemit të brendshëm të informacionit janë regjistrat e përpiluar nga sekretaria mësimore me të dhënat e studentëve si viti akademik, gjeneralitetet, grupi mësimor, emërtimin e lëndës, tipologjinë e veprimtarisë mësimore, etj. Megjithatë, edhe pse sekretaria mësimore ka një sistem të mirë organizuar për ruajtjen e të dhënave, një regjistër i ngjashëm hartohet dhe mbahet edhe nga personeli akademik për çdo student. Kjo garanton jo vetëm menaxhimin e brendshëm të informacionit por edhe verifikimin e tij në rast të pretendimeve të kundërta. Përveç regjistrimit të të dhënave në format hard-copy, sistemi E-Student garanton regjistrimin e të dhënave të studentëve në format elektronik. Ky sistem është i aksesueshëm nga personeli akademik, sekretaria mësimore dhe studentët. Menaxhimi i të dhënave realizohet duke respektuar privatësinë e studentëve dhe ato mund të vendosen në dispozicion të palëve të treta vetëm nëse janë të autorizuar sipas ligjit për të kërkuar këtë informacion. Evidenca <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidencë III.27 Tabelë me përqindjet e vlerësimit</i> <i>Evidencë III.35 Manual sistemi E-Student</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidencë V.14 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se mbështetur në aktet e brendshme FGJH garanton kontrollin periodik të njësive bazë e cila ofron programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim. Sekretaria mësimore është objekt kontrolli nga FGJH për të garantuar që informacioni është i saktë dhe i përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Ky kontroll konsiderohet i rëndësishëm nga FGJH pasi ai garanton transparencën, saktësinë dhe përditësimin e informacionit. Evidenca

veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidencë V.17 Miratim i Raportit Vjetor të UT</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstatoi se FGJH harton raporte të cilat ofrojnë informacione mbi studentët e regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim, që nga momenti që ato kanë filluar studimet e deri në përfundim, të dhëna që lidhen me performancën e tyre akademike apo edhe punësimin. Informacioni në këto raporte ndihmon në vlerësimin e rezultateve të arritura nga studenti. Të dhënat dhe gjetjet e këtyre raporteve analizohen për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit për të bërë ndërhyrjet e nevojshme dhe për ta përshtatur me kërkesat e tregut të punës. Kryesisht, studentët që regjistrohen në këtë program studimi kanë rezultuar të ruajnë të njëjtën cilësi dhe performancë akademike ose diferenca është shumë e vogël. Sikurse u theksua edhe më lart, FGJH mban të dhënat e të diplomuarve dhe i kontakton ato herë pas here për ti gjurmuar dhe për tu informuar për të dhënat e punësimit duke përditësuar kështu edhe bazën e të dhënave e për rrjedhojë edhe raportet e FGJH. Evidenca <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidencë II.17 Studim i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja</i> <i>Evidencë V.17 Miratim i Raportit Vjetor të UT</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore</i>
Konkluzione	GVJ konstatoi se: <i>FGJH përpunon të dhëna statistikore të studentëve që nga momenti i regjistrimit të tyre deri në përfundim të studimeve. Sekretaria mësimore mban listat me të dhënat e studentëve, duke arkivuar dokumentacionin nga regjistrimi deri në diplomim.</i> <i>Të dhënat e studentëve janë të mbrojtura sipas rregulloreve dhe ato mund t'u jepen palëve të treta vetëm nëse janë të autorizuar nga ligji. FGJH garanton kontrollin periodik të njërive që ofrojnë programet e studimit, për të siguruar që informacioni është i saktë dhe i përditësuar sipas standardeve ligjore.</i>

	FGJH harton raporte të cilat ofrojnë informacione në lidhje me studentët, duke përfshirë performancën akademike dhe të dhënat mbi punësimin. Këto informacione ndihmojnë në vlerësimin e rezultateve dhe identifikimin e nevojave për përmirësim në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Pas vizitave në institucion dhe mbështetur në dokumentacionin e vendosur në dispozicion GVJ konstatoi se studentët organizohen dhe përfaqësohen në organe vendimmarrëse apo këshilluese. Sipas statutit dhe rregullores së UT studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në Senatin Akademik, Këshillin e etikës, Komisionet e përhershme dhe Këshillat studentorë. Përfaqësuesit e studentëve në Këshillin studentor zgjidhen me procedura të veçanta të parashikuara në rregulloren e këshillit studentor dhe përcaktohen në detyrë me vendim të Senatit Akademik. Këshilli studentor në FGJH përbëhet nga 5 anëtarë. Evidenca <i>Evidencë 1.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë V.19 Rregullorja e këshillit të studentëve të FGJH</i> <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH</i> https://unitir.edu.al/komisioni-institucional-zgjedhor-studentor https://fgjh.edu.al/keshilli-studentor/
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	GVJ konstatoi se përfshirja e studentëve është e garantuar dhe realizohet nëpërmjet akteve të brendshme të institucionit. Ata janë aktiv gjithashtu në vetëvlerësimin e brendshëm të institucionit duke ndihmuar në garantimin e sigurimit të cilësisë. Ata janë aktiv në pjesëmarrjen në pyetësorët për sigurimin e

vlërësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	cilësisë së procesit mësimor dhe institucionit në tërësi. Në statutin e UT parashikohen funksionet e Komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë nga të cilët 3 prej tyre janë student. Nga ana tjetër, studentët të cilët janë përfaqësues në Senatin Akademik marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje të ndryshme në interes të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe garantimit të cilësisë së tij. Gjithashtu, studentët përfshihen në grupe ad-hoc të ngritura në nivel institucional apo njësie bazë. Studentët përveç përfshirjes në procese vendimmarrëse organizohen edhe në klube studentore me tematika të ndryshme si klube sportive, klube për përfshirjen e tyre në aktivitete sociale apo aktivitete të tjera ekstra kurrikulare. Studentët njoftohen nga zura e këshillimit të karrierës edhe për pjesëmarrje në leksione të hapura nga profesionistë të fushës, sipas fushave të studimit. Evidenca <i>Evidencë 1.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë V.19 Rregullorja e këshillit të studenteve të FGJH</i> <i>Evidencë 1.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë I.9 raport vjetor mësimor-kërkimor 2021-2022</i> <i>Evidencë I.10 raport vjetor mësimor-kërkimor 2022-2023</i> <i>Evidencë III.5 leksion i hapur nga rektori Artan Hoxha</i> <i>Evidencë III.7 leksion i hapur nga departamenti i gjuhës gjermane</i> <i>Evidencë III.15 klasa TEAMS technology trainings FGJH</i> https://fgjh.edu.al/keshilli-studentor
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament,	GVJ konstatoi se studentët kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës apo përmirësimit të programeve të studimit. Një mënyrë tjetër sesi studentët japin mendimin e tyre mbi cilësinë e procesit të mësimdhënies është nëpërmjet pyetësorëve të cilët NJSBC ia shpërndan studentëve dhe ata shprehin lirshëm në mënyrë anonime mendimin e tyre. Të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët reflektohen dhe analizohen në raporte për FGJH për të marrë më vonë masat e nevojshme për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe garantimin e sigurimit të cilësisë.

me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë I.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidencë III.26 Rregullore e NJSBC-FGJH</i> <i>Evidencë III.25 Model pyetësori me studentët</i> <i>Evidencë III.27 Tabela me përqindjet e vlerësimit</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Pas vizitës në FGJH dhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konstatoi se studentët njihen me rezultatet e provimeve nga personeli akademik përgjegjës për lëndën përpara se ky vlerësim të vendoset në procesverbal nga sekretaria mësimore. Ata kanë të drejtë të rishikojnë provimin apo të kërkojnë rivlerësim nëse nuk janë të kënaqur me vlerësimin ose pretendojnë se meritojnë më shumë. Nëse edhe pas vlerësimit të dytë nga ana e personelit akademik studenti nuk është dakord me vlerësimin, ai ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim pranë sekretarisë mësimore. Megjithatë, gjatë vitit akademik studentët marrin vazhdimisht informacione lidhur me vlerësimin e provimit të ndërmjetëm, aktivizimit në seminare, detyrat e kursit dhe vlerësimin përfundimtar. Sekretaria mësimore dhe personeli akademik janë në dispozicion të studentëve për ti informuar mbi mënyrën e vlerësimit dhe format e ankimimit në rast pakënaqësie. Për vlerësimin përfundimtar dhe animimin, personeli akademik dhe studentët duhet të respektojnë afatet ligjore të përcaktuara në rregulloren e FGJH, rregulloren e UT dhe rregulloren e sekretarisë mësimore. Evidenca <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se:</i> <i>studentët janë të organizuar dhe përfaqësohen në organe vendimmarrëse dhe këshilluese të universitetit sipas statutit dhe rregullores së UT. Ata kanë të drejta të përfaqësimit në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionet e Përhershme dhe Këshillat Studentorë.</i>

	<i>Studentët janë aktivë në proceset e vetëvlerësimit të institucionit dhe kontribuojnë në sigurimin e cilësisë përmes pjesëmarrjes në pyetësorë dhe komisione të ngritura për këtë qëllim. Studentët kanë të drejtë të japin mendime për hartimin dhe përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të studimit.</i> <i>Rregullat për vlerësimin dhe ankimimin janë të përcaktuara në rregulloren e FGJH dhe UT, dhe të dyja palët, personeli akademik dhe studentët, duhet të respektojnë afatet e caktuara. Studentët përveç përfshirjes në procese vendimmarrëse organizohen edhe në klube studentore me tematika të ndryshme si klube sportive, klube për përfshirjen e tyre në aktivitete sociale apo aktivitete të tjera ekstra kurrikulare. Studentët njoftohen nga zura e këshillimit të karrierës edhe për pjesëmarrje në leksione të hapura nga profesionistë të fushës, sipas fushave të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstatoi se FGJH zhvillon procedura konkrete dhe të qarta mbi informimin e studentëve, procedura këto të cilat rregullohen me akte të brendshme dhe që shkojnë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studentët informohen mbi programin e studimit, procedurat e regjistrimit, organizimin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, transferimet apo pezullimet, kohëzgjatjen e studimit dhe tarifat, zhvillimin e procesit mësimor, strukturën akademike, shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor apo për çdo informacion tjetër që studentët mund të kërkojnë. Këto informacione ofrohen për studentët nëpërmjet sekretarisë mësimore, përgjegjësit të departamentit apo dekanit si edhe janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të FGJH dhe UT. Gjithashtu, në funksion të shpërndarjes së informacionit te studentët vijnë në ndihmë edhe

	broshurat informuese dhe udhërrëfyesit. Zyra e informacionit dhe zyra e këshillimit të karrierës janë gjithashtu në dispozicion të studentëve për ti informuar ata në çdo kohë. Gjatë periudhës së studimeve në dispozicion të studentëve departamenti përcakton një kujdestar për të ofruar këshillimin e nevojshëm sa herë që ata hasin vështirësi. Këshilli studentor luan një rol të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit duke i informuar dhe motivuar studentët për pjesëmarrjen në takimet informuese ose takime të tjera të cilat i shërbejnë rritjes së tyre profesionale dhe sociale, ku bëjnë pjesë përfshirja e tyre në aktivitete ekstra kurrikulare, në klube sportive, sociale apo akademike. Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë 1.21 Rregullore e programit të studimit MSHPTI</i> <i>Evidencë V.12 Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidencë III.28 Udhërrëfyes i FGJH</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se FGJH ka ngritur një sistem informimi me në qendër studentin. Mbështetur në vizitat në FGJH rezultoi se informimi dhe këshillimi i studentëve kryhet nga struktura të ndryshme si sekretaria mësimore, zyra e këshillimit të karrierës, koordinatori për programin dhe zyra e kurrikulave. Gjithashtu, personeli akademik është vazhdimisht në komunikim me studentë jo vetëm në auditor por edhe në zyrë sa herë që është e nevojshme. Këshilli studentor luan një rol të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit duke i informuar dhe motivuar studentët për pjesëmarrjen në takimet informuese ose takime të tjera të cilat i shërbejnë rritjes së tyre profesionale dhe sociale, ku bëjnë pjesë përfshirja e tyre në aktivitete ekstra kurrikulare, në klube sportive, sociale apo akademike. Së fundmi, FGJH përditëson dhe publikon broshura informuese me informacione të përgjithshme mbi programin e studimit, personelin akademik, infrastrukturën dhe informacione të tjera si edhe i publikon ato në faqen zyrtare të internetit.

	Evidenca <i>Evidencë III.37 Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidencë V.21 Programi i transparencës për UT</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Pas takimeve të zhvilluara në FGJH si edhe në mbështetje të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se UT dhe njësitë kryesore në FGJH kanë ngritur struktura të veçanta për pritjen dhe pranimin e studentëve në fillim të vitit akademik të cilat ndihmojnë studentët të informohen mbi programin e studimit, ciklet e studimit, akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, mundësitë e transferimeve, etj. Koordinator i programit u vjen në ndihmë studentëve gjatë periudhës së ndjekjes së studimeve. Struktura të tjera që vijnë në ndihmë në këtë aspekt janë edhe zyra e këshillimit të karrierës. Më konkretisht kjo zyrë informon studentët mbi vendet e punës ku ato mund të integrohen, institucionet ku mund të ndjekin praktikën profesionale, informimin mbi trajnimet dhe seminarët që organizohen në fakultet, brenda orarit zyrtar. Zyra e këshillimit të karrierës ndihmon të orientojë studentët drejt tregut të punës duke i informuar ato për kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë, shkrimin e letrës së motivimit ose CV si edhe i informojnë rreth pyetjeve të përgjithshme që mund të hasin gjatë intervistës së punës. Në panairët e punës të organizuar nga njësia kryesore, studentët njihen në mënyrë të drejtpërdrejtë me tregun e punës dhe institucionet ku mund të punësohen pas diplomimit. Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti i UT</i> <i>Vendim nr. 48 për qendrën virtuale të zhvillimi profesional dhe trajnimit</i> <i>Evidencë II.17 Studim i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja</i> <i>Evidencë II.29 Dosje e praktikës së studentit</i> <i>Evidencë III.8 dhe III.9 Leksion i hapur</i> <i>Evidencë III.12 Trajnime UT qendra virtuale e trajnimeve</i> <i>Evidencë III.49 Model marrëveshje, memorandum bashkëpunimi</i>

	<i>Evidencë V.12 Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë së marrëdhënieve me studentët</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës pranë këtij institucioni shërben si një urë lidhëse mes studentëve dhe institucionit duke u dhënë mundësinë studentëve të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me tregun e punës dhe punëdhënësit, mban të dhëna mbi studentët e diplomuar lidhur me punësimin e tyre pas diplomimit ose angazhimin profesional që ata mund të kenë. Gjithashtu, kjo zyrë organizon edhe takime ose leksione të hapura me studentët ku të ftuar janë alumni i FGJH, kjo me qëllim ndarjen e eksperiencave dhe përfitimeve që këta mund të kenë pas diplomimit. Të dhënat e grumbulluara në formën e statistikave u vihen në dispozicion organeve drejtuese përkatëse, për zhvillimin e politikave institucionale dhe për arsye promovimi. Për të mbajtur një pasqyrë të saktë mbi punësimin e të diplomuarve, Zyra e Këshillimit të Karrierës disponon të dhëna statistikore të detajuara që pasqyrojnë suksesin e integritetit të studentëve në tregun e punës. Evidenca <i>Evidencë II.17 Studim i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja</i> <i>Evidencë V.12 Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë së marrëdhënieve me studentët</i> <i>Evidencë III.12 Trajnime UT qendra virtuale e trajnimeve</i> <i>Evidencë III.8 dhe III.9 Leksion i hapur</i> <i>Evidencë V.14 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i>
Konkluzione	GVJ konstatoi se: FGJH ka zhvilluar procedura të qarta për informimin e studentëve lidhur me programin e studimit, regjistrimin, transferimet, tarifat, strukturën akademike apo përfshirjen e tyre në leksione të hapura apo aktivitete ekstra kurrikulare. Informacioni ofrohet përmes sekretarisë mësimore, përgjegjësve të departamentit dhe dekanit, këshillit studentor si dhe në faqet zyrtare të internetit të FGJH dhe UT. Komunikimi me studentët realizohet jo vetëm në auditor, por edhe në zyrat administrative kur është e nevojshme, duke përfshirë këtu broshurat informuese dhe udhërrëfyesit. Zyra e

	informacionit dhe zyra e këshillimit të karrierës janë gjithashtu në dispozicion për të ofruar mbështetje dhe informacion për studentët. Çdo student ka një kujdestar të caktuar nga departamenti që i ofron këshillim në rast vështirësish. Zyra e Këshillimit të Karrierës luan një rol të rëndësishëm duke ofruar informacion mbi mundësitë e punës, trajnimet dhe seminarët, si dhe organizon panairë pune që ndihmojnë në lidhjen e studentëve me autoritetet e tregut të punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës mbledh dhe analizon të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar, çka ndihmon në formimin e politikave institucionale dhe strategjive për zhvillimin e mëtejshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstatoi se FGJH investohet për implementimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies, duke i përshtatur me profilin e secilës gjuhë. Garantimi i sigurimit të cilësisë së mësimdhënies është pjesë e misionit të universitetit dhe njësisë kryesore. Dokumente specifike si manuali i cilësisë dhe rregullorja e sigurimit të cilësisë ofrojnë udhëzime dhe detaje mbi metodat e mësimdhënies, udhëzime për personelin akademik për të përmirësuar dhe garantuar cilësinë e këtij procesi. Qasje të reja, përfshirja e mekanizmave dhe mjeteve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

117

	teknologjike në procesin e mësimdhënies mbështesin zhvillimin profesional të studentëve. Në FGJH ngrihen grupe pune dhe njësi të sigurimit të cilësisë në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. FGJH raporton periodikisht mbi këtë proces duke theksuar mjetet, platformat dhe metodat innovative që përdoren gjatë mësimdhënies nga personeli akademik. Evidenca <i>Evidencë 1.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë II.8 Manuali i cilësisë</i> <i>Evidencë II.9 Vendimi I FGJH për ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidencë VI.3 Vendimi i SA për miratimin e paketës së sigurimit të cilësisë në UT</i> <i>Evidencë VI.4 Vendimi i SA për ngritjen e grupit të punës për hartimin e manualit për sigurimin e brendshëm të cilësisë së UT</i> <i>Evidencë VI.8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi nga student, semestri pare dhe dytë</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ konstatoi se pranë FGJH janë ngritur struktura specifike për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies. Këto struktura implementojnë mekanizma për monitorimin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin e personelit akademik dhe ndihmësakademik. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, harton pyetësorë periodikë për të monitoruar procesin mësimor. Këto pyetësorë u shpërndahen studentëve dhe rezultatet e tyre u bëhen të ditur personelit akademik. Gjatë takimeve me përfaqësuesit e njësive të cilësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë u theksua fakti se çdo njësi bazë ka ngritur një strukturë të sigurimit të cilësisë përveç asaj të ngritur në nivel njësie kryesore. Çdo njësi kryesore harton raporte në kuadër të garantimit të sigurimit të cilësisë dhe FGJH dërgon në rektorat vetëm një raport të përbashkët. Nga ana tjetër, manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik është një tjetër mekanizëm që FGJH përdor për të garantuar sigurimin e cilësisë, ku përcaktohen kritere të vlerësimit të aftësive pedagogjike, metodat e zhvillimit të mendimit kritik të studentëve apo mënyrën e përdorimit të mjeteve teknologjike. Një tjetër mekanizëm që FGJH përdor për garantimin e sigurimit të cilësisë është edhe formulari i deklarimit të aktivitetit shkencor nga personeli akademik përgjatë një viti akademik. Akte të tjera si manuali dhe rregullorja e sigurimit të cilësisë

	përcaktojnë kriteret e vlerësimit të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Evidenca <i>Evidencë VI.2 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik</i> <i>Evidencë VI.5 Rregullore e NJSBC të FGJH</i> <i>Evidencë VI.8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi nga student, semestri pare dhe dytë</i> <i>Evidencë VI.12 Model i formularit të raportit të kërkimit shkencor për personelin akademik</i> <i>Evidencë VI.16 Vendim i SA mbi manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik</i> <i>Evidencë VI.17 Vendim i SA rregullorja mbi vlerësimin e performancës së personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ konstatoi se studentët përfshihen në procesin e vlerësimit periodik duke marrë pjesë në pyetësorë të cilët vlerësojnë lëndën dhe metodat e mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit të dijeve si edhe japin sugjerime sesi mund të përmirësohet procesi i mësimdhënies. NJSBC harton pyetje sipas tematikave të caktuara dhe pas plotësimit të pyetësorëve nga ana e studentëve, analizohen të dhënat dhe më pas rezultatet u raportohen fillimisht personelit akademik dhe më pas dërgohen në rektorat. Vlerësimi i personelit akademik lidhet me performancën që ai ka në auditor dhe cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu, mbështetur në vizitat e kryera në mjediset e FGJH, studentët kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin përfundimtar të provimit nëse konsiderojnë se vlerësimi nuk ishte i kënaqshëm ose ata mund të ankimohen edhe për shkelje të rregullave të provimit. Evidenca <i>Evidencë VI.10 Raport vjetor i NJSBC</i> <i>Evidencë II.25 Raport përmbledhës mbi pyetësin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi nga student, semestri pare dhe dytë</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si edhe gjatë vizitave në institucion, GVJ konstatoi se pas plotësimit të

dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	pyetësorëve nga studentët, rezultatet e tyre u bëhen me dije personelit akademik nëpërmjet përgjegjësit të departamentit. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik, njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë harton një raport ku në mënyrë të detajuar paraqet analizën e gjetjeve, rekomandimet dhe sfidat e hasura. NJSBC bën një përmbledhje të raportit me rezultatet e vlerësimit të performancës së personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Dokumente të tilla si manuali i vlerësimit të performancës apo instrumentet e sigurimit të cilësisë janë publike jo vetëm për personelin akademik por edhe për studentët apo çdo palë e interesuar. FGJH e konsideron shumë të rëndësishme transparencën e këtij procesi pasi e konsideron si një element kyç për përmirësimin e besueshmërisë së institucionit dhe demonstroi një vendosmëri për përmirësim dhe garantim të vazhdueshëm të cilësisë. Evidenca <i>Evidencë VI.3 Vendimi i SA për miratimin e paketës së sigurimit të cilësisë në UT</i> <i>Evidencë VI.10 Raport vjetor i NJSBC</i> <i>Evidencë VI.13 Komisioni i përhershëm i sigurimit të standardeve të cilësisë së UT</i> <i>Evidencë VI.17 Vendim i SA rregullorja mbi vlerësimin e performancës së personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Pas takimeve të zhvilluara në FGJH dhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se institucioni përdor mekanizma për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet pyetësorëve për vlerësimin e procesit të mësimdhënies nga ana e studentëve dhe formularit të deklaratimit të kërkimit shkencor të zhvilluar nga personeli akademik gjatë një vitit akademik. Rezultatet e pyetësorëve u bëhen me dije personelit akademik në mënyrë që të merren masat për përmirësimet e nevojshme si edhe nxitjen e praktikave më të mira. Ky proces është periodik dhe zhvillohet dy herë në vit, përpara përfundimit të semestrit. Një gjë e tillë u konfirmua gjatë takimeve të zhvilluara në FGJH ku personeli akademik konfirmoi realizimin e pyetësorëve dhe analizimin e tyre në departament për përmirësimin e situatës, kur është e nevojshme. Këto pyetësorë mund të shërbejnë shpeshherë edhe si iniciator i

	trajnimeve apo aktiviteteve të ndryshme ekstrakurrikulare për ti ardhur në ndihmë sa më shumë studentëve duke përbushur nevojat e tyre përpara se ata të përballen me tregun e punës. NJSBC garanton identifikimin e praktikave më të mira dhe promovimin e tyre në nivel institucioni. Evidenca <i>Evidencë VI.2 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik</i> <i>Evidencë VI.8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi nga student, semestri pare dhe dytë</i> <i>Evidencë VI.10 Raport vjetor i NJSBC</i> <i>Evidencë VI.12 Model i formularit të raportit të kërkimit shkencor për personelin akademik</i> <i>Evidencë II.9 Vendimi i FGJH për ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se: <i>FGJH, ka investuar në metoda inovative të mësimdhënies, të përshtatura për çdo profil gjuhe, për të garantuar cilësinë e procesit mësimor si pjesë e misionit të tij. Dokumentet specifike, si manuali dhe rregullorja e cilësisë, ofrojnë udhëzime për personelin akademik për të përmirësuar standardet e mësimdhënies.</i> <i>Struktura për monitorimin dhe vlerësimin mbledhet rregullisht për të shqyrtuar performancën akademike dhe për të siguruar cilësinë. Studentët luajnë një rol aktiv duke përfshirë në proceset e vlerësimit dhe duke dhënë sugjerime për përmirësime.</i> <i>FGJH ofron transparencë në procesin e sigurimit të cilësisë, pasuar nga analiza e rekomandimeve dhe sfidave të hasura, duke përfshirë dokumente publike që reflektojnë angazhimin për përmirësim të vazhdueshëm.</i> <i>Analiza e rezultateve nga pyetësit është një mekanizëm i rëndësishëm për zbulimin e praktikave më të mira dhe inkurajimin e aktiviteteve përkrahëse për studentët.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstatoi se FGJH harton politika, ka ngritur struktura dhe ndjek procedura ligjore për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto reflektohen në akte të brendshme të institucionit si rregullore, udhëzime apo njësi specifike si ajo e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Më konkretisht politika e sigurimit të cilësisë është e përcaktuar qartë në manualin e cilësisë, rregulloren e vlerësimit të performancës së personelit ndihmës-akademik dhe administrative dhe manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik. NJSBC është përgjegjëse për hartimin e mekanizmave të cilat vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies si edhe realizon përpunimin e të dhënave të mbledhura me qëllim vlerësimin e efikasitetit dhe cilësinë e programeve të ofruara. Pyetësorët mbi vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe formulari i deklarimit të aktivitetit kërkimor shkencor janë dy prej mekanizmave që aplikohen. Vlerësimi është periodik dhe realizohet dy herë në vit, përpara përfundimit të semestrit. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët përpunohen dhe analizohen si edhe u bëhen publike personelit akademik me qëllim përmirësimin e procesit dhe reflektimin e rekomandimeve. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë I.6 Strategjia e zhvillimit të FGJH</i> <i>Evidencë I.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë II.8 Manuali i cilësisë</i> <i>Evidencë II.9 Vendimi i FGJH për ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidencë VI.2 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik UT</i> <i>Evidencë VI. 5 Rregullore e NJSBC të FGJH 2022</i>

	<i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstatoi se njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë është ngritur dhe funksionon në përputhje me planin strategjik të FGJH, si edhe në përputhje me rregulloren e programit të studimit. FGJH ka përcaktuar persona përgjegjës në çdo departament të cilët janë përgjegjës për koordinimin e procesit të sigurimit të cilësisë. NJSBC si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe garantimin e cilësisë në UT është ngritur në nivel institucional dhe mbledh raportimet e njësive kryesore mbi këtë aktivitet. Studentët janë të përfshirë në këtë proces duke ofruar mendim objektiv ndaj pyetjeve që u drejtohen dhe rekomandojnë përmirësimin e procedurave të caktuara. Mekanizmat për garantimin e cilësisë janë pyetësorët për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe formularët e deklarimit të aktivitetit kërkimor shkencor. Pyetësorët janë periodikë dhe rezultatet e tyre u bëhen me dije personelit akademik për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë I.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati UT</i> <i>Evidencë VI.5 Rregullore e NJSBC të FGJH 2022</i> <i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	GVJ konstatoi se FGJH ka ngritur struktura të caktuara për garantimin e cilësisë si edhe ka përcaktuar persona përgjegjës në nivel njësie bazë për koordinimin e procesit të sigurimit dhe monitorimit të cilësisë. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në nivel institucional është një tjetër mekanizëm që FGJH përdor për të garantuar cilësinë sipas standardeve të kërkuara. Kjo është e parashikuar edhe në aktet e brendshme të institucionit por është e mundur edhe nëpërmjet mekanizmave matës të tillë si pyetësorët dhe formularët e deklarimit të aktivitetit kërkimor shkencor. Pyetësorët vlerësojnë performancën akademike të personelit akademik, gjë e cila bëhet nga studentët ndërsa formulari lidhet me performancën

cilësinë në programin e studimit.	kërkimore shkencore që personeli akademik ka realizuar në një vit akademik. Në të dyja rastet, rezultatet bëhen publike dhe merren masa për përmirësimin e situatës kur është e nevojshme. Publikimi i tyre realizohet nëpërmjet raporteve dhe analizave të të dhënave ku evidentohen problematikat dhe aspekte të ndryshme të cilat kanë nevojë për përmirësim. Lidhur me sigurimin e jashtëm të cilësisë, FGJH i nënshtrohet akreditimit të programeve të studimit për t'iu përmbajtur standardeve ligjore. Evidenca <i>Evidencë VI.3 Vendim i SA për miratimin e paketës së dokumenteve të sigurimit të cilësisë në UT</i> <i>Evidencë II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati UT</i> <i>Evidencë VI.7, 8, 9, 10 Raport vjetor i NJSBC</i> <i>Evidencë II.25 Raport përmbledhës për pyetësin</i> <i>Evidencë VI.11 Model pyetësori të studentëve për pedagogun</i> <i>Evidencë VI.12 Model i formularit i raportit të kërkimit shkencor për personel akademik</i> <i>Evidencë VI.18 Vendim i SA për akreditimin periodik të programeve të studimit në UT</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ konstatoi se FGJH përdor instrumente të ndryshëm matës të cilësisë të tillë si pyetësorë për vlerësimin e lëndës dhe mësimdhënies dhe formularë për deklarimin e aktivitetit kërkimor shkencor, raportime dhe analiza të pyetësorëve, formularë mbi deklarimin e kërkimit shkencor të realizuar nga personeli akademik, publikimi dhe përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ndërsa sigurimi i jashtëm i cilësisë garantohej përmes akreditimit të programit të studimit. Strukturat e ngritura në FGJH bashkëpunojnë me njëra tjetrën për të garantuar një cilësi sa më të lartë të shërbimit akademik. NJSBC përdor metoda vlerësimi dhe instrumente vlerësuese, njësia bazë dhe njësia kryesore bashkëpunojnë për realizimin e pyetësorit dhe shpërndarjen te studentët, pasi e konsiderojnë procesin të rëndësishëm për evidentimin e problematikave si edhe përmirësimin e cilësisë. Një tjetër instrument i përdorur është edhe ai pyetësor i cili i është shpërndarë studentëve të diplomuar, duke e rritur nivelin e objektivitetit. Përgjegjësit e

	departamenteve e njohin personelin akademik me rezultatet e vlerësimit, më pas zhvillohen takime për të diskutuar rreth problematikave dhe merren masa për përmirësimin e situatës kur është e nevojshme. Evidenca <i>Evidencë II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati UT</i> <i>Evidencë VI.11 Model pyetësori të studentëve për pedagogun</i> <i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se:</i> <i>FGJH ka ngritur një strukturë të mirëfilltë dhe procedura ligjore për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat reflektohen në akte të brendshme përfshirë rregullore dhe udhëzime. Politika për sigurimin e cilësisë është e qartë në manualin përkatës, duke përfshirë rregulloren e vlerësimit të performancës së personelit ndihmës-akademik dhe administrativ, si dhe manualin për vlerësimin e performancës së personelit akademik.</i> <i>NJSBC është krijuar për të monitoruar dhe garantuar cilësinë në universitet, duke hartuar mekanizma vlerësimi si pyetësorët për mësimdhënien dhe formularët e aktivitetit kërkimor shkencor. Vlerësimi është i periodik dhe realizohet dy herë në vit, me rezultatet e mbledhura që analizohen dhe publikohen për të informuar personelin akademik dhe për të përmirësuar procesin.</i> <i>Studentët gjithashtu kontribuojnë në këtë proces përmes ofrimit të mendimeve dhe rekomandimeve. Instrumente të ndryshëm matës si pyetësorë dhe formularë për aktivitetin kërkimor përdoren për të mbledhur të dhëna, të cilat më pas analizohen dhe bëhen publike për personelin akademik, duke siguruar kështu një qasje të bazuar në të dhëna për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VL3

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

125

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Mbështetur në vizitat e zhvilluara në FGJH dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se ky institucion përdor mekanizma dhe procese specifike për garantimin e mbikëqyrjes periodike të programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim. Në listën e mekanizmave bëjnë pjesë raportet vjetore të njësive kryesore, pyetësorët që plotësojnë studentët për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, formularët e plotësuar nga personeli akademik për të deklaruar aktivitetin shkencor që kanë zhvilluar gjatë vitit akademik si edhe mbledhjet periodike që zhvillon njësia bazë pasi personeli akademik është njohur me rezultatet e pyetësorit. Mbledhjet kanë për qëllim diskutimin e problematikave dhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës kur është e nevojshme dhe përmirësimin e programit brenda standardeve të kërkuara. Ajo çka vlen të theksohet është fakti se çdo njësi bazë përfaqësohet me një koordinator për të garantuar mbarëvajtjen e procesit të sigurimit të cilësisë dhe ruan komunikimin me njësinë bazë dhe NJSBC. Evidenca <i>Evidencë II.21 paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati i UT</i> <i>Evidencë VI.11</i> <i>Evidencë II.25 raport përmbledhës mbi pyetësorin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.7, 8 dhe 9 raport përmbledhës mbi pyetësorin formular vlerësimi</i> <i>Evidencë VI.15 rregullore e brendshme e FGJH</i> <i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga FGJH, GVJ konstatoi se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pas plotësimit të pyetësorëve dhe analizës së tyre, harton një raport vjetor në të cilin pasqyrohen rezultatet e pyetësorëve si edhe matja e performancës. Në raport përfshihen rezultatet por

praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	edhe masat që duhet të merren në kuadër të garantimit të cilësisë, objektivat e së ardhmes për përmirësimin e procesit akademik dhe përmirësimin e programit të studimit. Raportet pas finalizimit u bëhen të njohura personelit akademik dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit. Gjithashtu, manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik është një mekanizëm i cili organizohet në disa pjesë dhe kryesisht trajton parimet, kriteret dhe periudhën e vlerësimit, hapa të cilat konkludojnë të gjithë procesin e sigurimit të cilësisë. Përveç personelit akademik, një rol shumë të rëndësishëm në FGJH luan edhe personeli ndihmës-akademik dhe ai administrativ. Në këtë kuadër, FGJH ka miratuar rregulloren mbi vlerësimin e performancës së personelit ndihmës-akademik dhe administrativ, në mënyrë që të drejtat, detyrimet dhe procedurat të jenë të qarta për të gjithë palët. Evidenca <i>Evidencë 1.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë 1.12</i> <i>Evidencë VI.16 vendim për miratimin e manualit të vlerësimit të personelit akademik</i> <i>Evidencë VI.17 vendim për rregulloren mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT</i> <i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>
Kriteri 3.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,	GVJ konstatoi se metodat e përdorura për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim janë gjithëpërfshirëse. Monitorimi dhe vlerësimi realizohen nëpërmjet pyetësorëve që u shpërndahen studentëve dhe analizës së rezultateve të përfuara prej tyre. Rezultatet e pyetësorëve analizohen dhe publikohen nëpërmjet raporteve vjetore. Mbështetur në rezultatet e pyetësorëve mund të ndërmerren masa për ndryshimin e programit të studimit deri në masën 20% ose të përmirësohet procesi i mësimdhënies nga personeli akademik, duke evidentuar nevojat e studentëve dhe duke e përqasur lëndën me nevojat e tyre. Një tjetër mekanizëm i cili shërben si garantor i sigurimit të cilësisë në FGJH janë edhe vëzhgimet në auditor të cilat realizohen gjatë kryerjes së ushtrimeve dhe praktikave kryesisht në klasë dhe ndiqen nga

testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	personeli akademik. Këto vëzhgime ndihmojnë në identifikimin e elementëve të cilët nuk janë në përputhje me planin dhe në rast nevojë bëhen ndërhyrje të menjëhershme. Gjithashtu, analizohen rezultatet e arritura në testime kombëtare. Evidenca <i>Evidencë 1.9 dhe 1.10 raport vjetor mësimit kërkimor</i> <i>Evidencë II.25 raport përmbledhës mbi pyetësorin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.7, 8 dhe 9 raport përmbledhës mbi pyetësorin formular vlerësimi</i> <i>Evidencë II.23 plani i veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> <i>Evidencë II.24 plani i veprimit për veprimtarinë monitoruese dhe vlerësuese 2022-2023</i> <i>Evidencë VI.5 rregullore e NJSBC të FGJH 2022</i> <i>Evidencë VI.12 model i formularit të raportit të kërkimit shkencor për personel akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe në vizitat e kryera në FGJH, GVJ konstatoi se njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përdor mekanizma për matjen e cilësisë, të cilat shpërndahen në mënyrë periodike te studentët dhe feedback-u i marrë prej tyre analizohet dhe përpunohet në formën e raporteve dhe u vihet në dispozicion strukturave drejtuese dhe personelit akademik. Shpeshherë organizohen edhe mbledhje me qëllim diskutimin e rezultateve të pyetësorëve dhe ndërhyrjen në përmirësimin e situatës, kur është e nevojshme. Këto mbledhje organizohen gjithashtu për të vendosur nëse është e nevojshme ndërhyrja në programin e studimit deri në masën 20% për ti ardhur në ndihmë plotësimi të nevojave të studentëve ose për të përmirësuar procesin e mësimit në lëndë të caktuara. Studentët nuk përfshihen vetëm në vlerësimin akademik të institucionit, por ata shprehin lirshëm dhe në mënyrë anonime edhe vlerësimin institucional, administrativ dhe të shërbimeve. Gjithashtu, FGJH mban komunikimin me studentët alumni duke u informuar mbi punësimin e tyre pas diplomimit ose duke i ftuar ato në auditorët e njësisë kryesore për të shkëmbyer eksperiencë me studentët e padiplomuar ende. Një tjetër mekanizëm që përdoret nga FGJH është edhe raporti i vetëvlerësimit të lëndës nga ana e personeli akademik. Më konkretisht ky raport vjen si rezultat i një pyetësori të plotësuar nga personeli akademik ku ky i fundit bën

	një analizë të lëndës, kalueshmërisë së studentëve dhe shpërndarjes së vlerësimit. Në këtë pyetësor, personeli akademik mund të japë mendimin për ndryshime të caktuara të cilat i konsideron të domosdoshme për të garantuar standardet ligjore në fuqi. Gjithashtu, personeli akademik deklaroi nëpërmjet një formulari aktivitetin kërkimor shkencor që ka realizuar gjatë një viti akademik. Edhe rezultatet e mbledhura nga këto formular janë mjet matës i cilësisë së personeli akademik dhe përfshirjes së tyre në aktivitete kërkimore shkencore sikurse kërkohet në aktet ligjore në fuqi. Evidenca <i>Evidencë II.21 paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati i UT</i> <i>Evidencë I.6 strategjia e zhvillimit të FGJH 2021-2024</i> <i>Evidencë II.17 studim i tregut të punës për studentët e FGJH</i> <i>Evidencë II.25 raport përmbledhës mbi pyetësin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.7, 8 dhe 9 raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi</i> <i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se:</i> <i>FGJH njësia kryesore përgatiti raportet vjetore që përmbajnë analizat e aktiviteteve akademike dhe shkencore. Studentët plotësojnë pyetësorë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të cilat analizohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe rezultati iu njoftohet personelit akademik. Njësitë bazë organizojnë mbledhje për të shqyrtuar rezultatet e pyetësorëve dhe për të diskutuar masat për përmirësim sipas nevojave të identifikuar nga rezultatet.</i> <i>Vlerësimi realizohet nëpërmjet pyetësorëve, analizës së rezultateve nga testimet kombëtare dhe vëzhgimit direkt në auditor, të cilat ndihmojnë në identifikimin e nevojave për përmirësim.</i> <i>FGJH mban kontakte me ish-studentët për të mbledhur informacion mbi punësimin e tyre pas diplomimit, gjë që ndihmon në identifikimin e nevojave të tregut të punës.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si edhe në takimet e zhvilluara në FGJH, GVJ konstatoi se ky institucion garanton sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm garantohet nëpërmjet përdorimit të mekanizmave vlerësues, analizimi i të dhënave të gjeneruara prej tyre dhe vlerësimi i jashtëm është një proces periodik i akreditimit dhe bashkëpunimit me agjencinë e sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, FGJH ngre grupe pune sa herë është e nevojshme për të garantuar cilësinë në këtë institucion, ku pjesë janë personeli akademik dhe studentët kur është e nevojshme, si është rasti i akreditimit institucional dhe akreditimit të programit të studimit. Bashkëpunimi me institucione të ndryshme që ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së FGJH konsiderohen gjithashtu mekanizma garantues të cilësisë. Evidenca <i>Evidencë I.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë I.2 strategjia e zhvillimi të UT</i> <i>Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë së IAL</i> <i>Evidencë II.8 manuali i cilësisë</i> <i>Evidencë VI.5 rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konstatoi se FGJH miraton akte të brendshme të cilat përcaktojnë qartë të drejtat dhe detyrimet e aktorëve të angazhuar për të marrë pjesë në proceset e sigurimit të cilësisë. Detyrat e NJSBC si

të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	struktura kryesore e sigurimit të cilësisë janë të përcaktuara qartë në rregulloren e saj. Duke qenë se pyetësorët janë anonim, studentët mund të shprehin lirshëm dhe në mënyrë sa më objektive mendimet e tyre mbi procesin mësimor. Gjithashtu, lidhur me përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse vlen të theksohet fakti se të drejtat dhe detyrimet e tyre u bëhen me dije paraprakisht dhe ata janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kanë, përpara se të bëhen pjesë e këtyre proceseve. Nga ana tjetër, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë pranë FGJH luan një rol shumë të rëndësishëm në këtë institucion pasi krijon një kulturë përgjegjësie për të ruajtur cilësinë e veprimtarisë akademike dhe garanton standardet e cilësisë të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi. Evidenca <i>Evidencë I.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë VI.5 rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë II.23 plani i veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UT</i> <i>Evidencë II.9 vendim i FGJH për ngritjen e NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si edhe gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se FGJH garanton që në procesin e sigurimit të cilësisë të jenë të përfshirë aktorë të ndryshëm si personeli akademik, studentët, njësitë kryesore dhe njësitë bazë dhe personeli administrativ. Secili ka detyra të përcaktuara qartë dhe përfshirja e tyre garanton një gjithëpërfshirje në procesin e vlerësimit të cilësisë. Studentët përfshihen nëpërmjet pyetësorëve, propozimeve të këshillit studentor dhe takimeve periodike me kujdestarët e programit. Vlerësimi i cilësisë është i brendshëm kur personeli akademik, administrativ dhe studentët angazhohen për shkrimin e raportit dhe mbështetjen e tij në evidenca konkrete që faktojnë të dhënat e deklaruara ndërsa vlerësimi i jashtëm kryhet nga agjencia e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Komunikimi në të dyja rastet është i shpejtë dhe ndërveprimi efikas pasi përveç takimeve fizike komunikimi ruhet edhe nëpërmjet email-it. Nga ana tjetër, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës garantojnë përfshirjen

	e njësisë kryesore në procesin e sigurimit të cilësisë së programeve që FGJH ofron. Evidenca <i>Evidencë II.9 vendimi i FGJH për ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë II.24 plani i veprimit për veprimtarinë monitoruese dhe vlerësuese 2022-2023</i> <i>Evidencë VI.17 rregullorja mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe mbështetur në vizitat e realizuara në FGJH, GVJ konstatoi se institucioni ngarkon me detyrë për të marrë pjesë në proceset të cilat garantojnë cilësinë e institucionit personel akademik, administrativ dhe studentë të cilët ruajnë integritetin akademik. FGJH garanton që vendimet të merren bazuar në aktet nënligjore në fuqi duke lënë mënjanë gjykimet personale ose pabarazinë. Aktet e brendshme e përforcojnë më shumë garantimin e cilësisë pasi këto procedura dhe standarde janë të parashikuara edhe aty. Ajo që u vu re ishte se në departamentin e gjuhës frënge, gjuhës ruse dhe gjuhës angleze për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim nuk ka studentë të përfshirë në aktivitete shkencore të IAL si projekte, punime shkencore në nivel fakulteti, departamenti apo me bashkëpunëtorë të tjerë. <i>Për sa më sipër, sugjerohet përfshirja e studentëve në këto aktivitete edhe për departamentet e sipërpërmendur.</i> Gjithashtu, lidhur me integritetin akademik dhe identifikimin e punimeve shkencore të personelit akademik apo diplomave të studentëve FGJH nuk disponon një platformë për identifikimin e plagjiaturës apo Inteligjencës Artificiale. Sipas deklaratave të personelit akademik në takimet e zhvilluara në FGJH pjesa më e madhe e tyre gjejnë mënyra alternative të identifikimit të këtyre dy elementëve si përdorimi i platformave pa pagesë. GVJ e konsideron shumë të rëndësishëm ofrimin e këtij shërbimi për studentët dhe personelin akademik për respektimin e të drejtave të autorit. <i>Për sa më sipër, GVJ sugjeron implementimin e një platforme plagjature e cila identifikon detyrat e studentëve, temat e</i>

	<i>diplomës së studentëve dhe punimeve shkencore të personelit akademik përpara publikimit të tyre.</i> Evidenca <i>Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë VI.5 rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë nr 13 dokumente shtesë tabela 22 aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi se FGJH konsultohet me bashkëpunëtorë, kolegë dhe ekspertë të jashtëm për të marrë mendime mbi proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Vlerësimi i jashtëm vjen kryesisht nëpërmjet leksioneve të hapura, trajnimeve, shkëmbimit me institucione të tjera ose ekspertë të cilët ndihmojnë në mënyrë aktive dhe të drejtpërdrejtë në evidentimin e praktikave më të mira. Bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm është parashikuar edhe në aktet e brendshme të UT dhe FGJH. Evidenca <i>Evidencë I.11 strategjia e ndërkombëtarizimit FGJH</i> <i>Evidencë I.12 vendim për miratimin e strategjisë kombëtare të arsimit 2021-2026</i>
Konkluzione	GVJ konstatoi se: <i>FGJH implementon mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm për garantimin e cilësisë, ku të dhënat e gjeneruara analizohen përmes procesit të akreditimit dhe bashkëpunimit me agjencitë e sigurisë së cilësisë. Institucioni angazhon personelin akademik, studentët, njësitë kryesore dhe ato bazë, të cilët kanë detyra të qarta në proceset e vlerësimit.</i> <i>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Komisioni i Kurrikulës janë të rëndësishëm për ruajtjen e cilësisë akademike dhe garantimin e standardeve ligjore. Vlerësimi i brendshëm realizohet nga personeli akademik dhe administrativ, ndërsa vlerësimi i jashtëm kryhet nga agjenci të specializuara. Komunikimi në të dy nivelet është i shpejtë dhe efikas.</i> <i>FGJH angazhon të gjithë aktorët për të mbajtur integritetin akademik dhe për të siguruar që vendimet merren në përputhje</i>

	me aktet nënligjore pa ndikimin e gjykimeve personale. Institucioni konsultohet me ekspertë të jashtëm dhe kolegë të tjerë, duke organizuar leksione të hapura, trajnime dhe shkëmbime me institucione të tjera, për të identifikuar praktikat më të mira. <u>GVJ sugjeron përfshirja e studentëve në këto aktivitete edhe për departamentet e sipërpërmendur.</u> Gjithashtu, lidhur me integritetin akademik dhe identifikimin e punimeve shkencore të personelit akademik apo diplomave të studentëve FGJH nuk disponon një platformë për identifikimin e plagjiaturës apo Inteligjencës Artificiale. Sipas deklaratave të personelit akademik në takimet e zhvilluara në FGJH pjesa më e madhe e tyre gjejnë mënyra alternative të identifikimit të këtyre dy elementëve si përdorimi i platformave pa pagesë. GVJ e konsideron shumë të rëndësishëm ofrimin e këtij shërbimi për studentët dhe personelin akademik për respektimin e të drejtave të autorit. Për sa më sipër, <u>GVJ sugjeron implementimin e një platforme e cila identifikon detyrat e studentëve, temat e diplomës së studentëve dhe punimeve shkencore të personelit akademik përpara publikimit të tyre.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstatoi se FGJH nëpërmjet NJSBC garanton zbatimin e proceseve transparente dhe të ligjshme lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Vlerësimet dhe matjet e performancës bëhen në mënyrë periodike. Të dhënat pasi grumbullohen analizohen dhe më pas bëhen publike me raportimin dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të institucionit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohet edhe nëpërmjet përfshirjes në proces të personelit akademik, administrativ dhe të vetë studentëve të cilët shprehin lirshëm mendimin e tyre mbi problematika të caktuara. Ajo që u vu re ishte se në

	departamentin e gjuhës frënge, gjuhës ruse dhe gjuhës angleze për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letërar dhe Interpretim nuk ka studentë të përfshirë në aktivitete shkencore të IAL si projekte, punime shkencore në nivel fakulteti, departamenti apo me bashkëpunëtorë të tjerë. <i>Për sa më sipër, <u>sugjerohet</u> përfshirja e studentëve në këto aktivitete edhe për departamentet e sipërpërmendur.</i> Evidenca <i>Evidencë I.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë VI.5 rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë nr 13 dokumente shtesë tabela 22 aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstatoi se FGJH ka miratuar akte të brendshme të cilat parashikojnë mënyrat e publikimit të rezultateve të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së institucionit. Publikimi bëhet duke respektuar parimet e lirisë dhe etikës profesionale dhe akademike si edhe parimin e anonimitetit. Të dhënat përpara se të publikohen analizohen dhe i bëhen me dije personelit akademik. Raportet e publikuara ndihmojnë në vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e cilësisë së institucionit. Gjithashtu, rezultatet e vlerësimeve diskutohen në mbledhje informuese me personelin akademik por edhe palë të tjera të interesuara me qëllim përmirësimin e kurrikulës dhe procesit të mësimdhënies. Evidenca <i>Evidencë I.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë I.12 vendim për miratimin e strategjisë kombëtare të arsimit 2021-2026</i> <i>Evidencë II.25 raport përmbledhës mbi pyetësin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.7, 8 raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi</i> <i>Evidencë VI.10 raport vjetor i NJSBC dhe FGJH 2020-2021</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan	Mbështetur në dokumentacion e vënë në dispozicion dhe gjatë vizitave të kryera në institucion GVJ konstatoi se qëllimi i hartimit të mekanizmave matës të cilësisë është jo vetëm të

masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	identifikojë problematikat por edhe të marrë masa për përmirësimin e mangësive të evidentuara. Lidhur me programin e studimit master i shkencave në përkthim teknik-letrar dhe interpretim raporti i NJSBC ka dhënë rekomandime për marrjen e masave dhe planeve të veprimit për trajtimin e problematikave, kur ka qenë e nevojshme. Evidenca <i>Evidencë VI.15 rregullore e brendshme e FGJH</i> <i>Evidencë VI.5 rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se FGJH nëpërmjet strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë garanton këtë të fundit duke përdorur mekanizma vlerësues si pyetësorë dhe formularë vlerësimi të aktivitetit kërkimor shkencor. Pjesëmarrës në këtë proces janë personelit akademike, administrative dhe vetë studentët. Për të garantuar një proces sa më transparent dhe të drejtë, të dhënat e grumbulluara analizohen dhe u bëhen me dijeni strukturave drejtuese përpara publikimit në faqen zyrtare të institucionit. Studentët nga ana tjetër përfshihen në grupe pune apo komisione si edhe mbledhje ku trajtohen dhe marrin zgjidhje problematikat e tyre. Evidenca <i>Evidencë I.6 strategjia e zhvillimit të FGJH</i> <i>Evidencë I.7 rregullore e FGJH</i> <i>Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë I.11 strategjia e ndërkombëtarizimit të FGJH</i> <i>Evidencë I.12 vendim për miratimin e strategjisë kombëtare të arsimit 2021-2026</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të	GVJ konstatoi se FGJH përfshin studentët, personelin akademik dhe administrativ në proceset e vlerësimit të cilësisë jo vetëm për të garantuar procedurat ligjore por edhe për ti ndërgjegjësuar ata mbi rëndësinë e procesit dhe rolit të tyre në këtë institucion. Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës pranë FGJH organizohen aktivitete të ndryshme informuese kryesisht për studentët lidhur me detaje të programit të studimit, punësimin e

cilësisë së programit të studimit.	tyre pas diplomimit, institucionet ku mund të kryejnë praktikën profesionale. Kjo zyrë bashkëpunon jo vetëm me zyrat e tjera mbështetëse të njësive kryesore por edhe me këshillin studentor duke i qëndruar më pranë studentëve dhe duke i dhënë zgjidhje shqetësimeve të tyre më shpejt. Kjo gjë i përfshin studentët në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit dhe shërbimeve administrative. Evidenca <i>Evidencë II.24 plani i veprimit për veprimtarinë monitoruese dhe vlerësuese 2022-2023</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se:</i> <i>proceset e vlerësimit të cilësisë janë të ndërmarrë në mënyrë periodike dhe transparente, duke shpërblyer të dhëna të grumbulluara dhe publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Vlerësimet dhe matjet bëhen në mënyrë periodike, duke përfshirë pjesëmarrje të personelit akademik, administrativ dhe studentëve.</i> <i>Studentët janë të përfshirë në aktivitetet shkencore dhe vlerësues, duke përfshirë pjesëmarrjen në komisione dhe grupe punuese. Megjithatë, ajo që u vu re ishte se në departamentin e gjuhës frënge, gjuhës ruse dhe gjuhës angleze për programin e studimit Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim nuk ka studentë të përfshirë në aktivitete shkencore të IAL si projekte, punime shkencore në nivel fakulteti, departamenti apo me bashkëpunëtorë të tjerë. Për sa më sipër, <u>sugjerohet</u> përfshirja e studentëve në këto aktivitete edhe për departamentet e sipërpërmendur.</i> <i>FGJH ka miratuar akte të brendshme të cilat parashikojnë mënyrat e publikimit të rezultateve të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë. Publikimi bëhet duke respektuar parimet e lirisë dhe etikës profesionale akademike, si dhe parimin e anonimitetit. Raportet e publikuara ndihmojnë në vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e cilësisë së institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Përkthim Teknik-Lettrar dhe Interpretim”

a. Pikat të forta dhe afirmime:

1. FGJH zhvillon procedura të qarta për informimin e studentëve mbi programin e studimit, regjistrimin, tarifat dhe mundësitë e përfshirjes në aktivitete. Kjo siguron që studentët të kenë akses të lehtë në informacionin që u nevojitet;
2. FGJH mbledh dhe analizon të dhëna statistikore të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, duke siguruar që informacionet janë të saktë dhe të mbrojtura;
3. Proceset e vlerësimit të cilësisë realizohen në mënyrë periodike dhe transparente, me shpërndarjen e të dhënave të mbledhura në faqen zyrtare të institucionit;
4. Studentët përfshihen në aktivitete vlerësuese, duke marrë pjesë në komisione dhe grupe pune. Kjo i jep atyre mundësinë të shprehin mendimin e tyre mbi proceset mësimore;
5. Godina e institucionit ka ambiente të mirë të pajisura, përfshirë laboratorë të specializuar për përkthim dhe një bibliotekë të pasur me literaturë;
6. Personel akademik me tituj dhe grada shkencore si dhe me kualifikime të nevojshme, të arritura si brenda edhe jashtë vendit;
7. Lidhja e fortë me industrinë dhe mundësitë që ofron kjo për praktika profesionale dhe punësim të studentëve;
8. Përfshirja e njësive kryesore në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në projekte Erasmus, që mundëson fitimin e përvojave ndërkombëtare;

b. Pika të dobëta:



1. Ndryshimet e miratuara nga organet përgjegjëse të FGJH-së, në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2028, për ndarjen e ngarkesës së krediteve sipas veprimtarive formuese, nuk

janë të reflektuara në të gjithë dokumentacionin përkatës, përkatësisht Tabela sipas Veprimtarive Formuese, Plani mësimor dhe Suplementi i Diplomës; (*Standardi II.1, kriteri 1 dhe 3*)

2. Departamenti i gjuhës greke ka vetëm 6 anëtarë, ndërkohë që ligji kërkon të paktën 7 me tituj shkencorë të lartë; (*Standardi II.2, kriteri 1;*)
3. Një pjesë e literaturës nuk ka informacionin e vitit të botimit, ose i përket një periudhe më të hershme botimi sesa ajo e pesë viteve të fundit; (*Standardi II.4, kriteri 5; Standardi IV.3., kriteri 2*)

Rekomandime

1. Ndryshimet e miratuara në lidhje me ndarjen e ngarkesës sipas krediteve në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018, të reflektohen në të gjithë dokumentet përkatëse që ndikohen nga ky vendim;
2. Të ndërmerren masa për të punësuar një anëtar të ri në Departamentin e Gjuhës Greke për të përmbushur kërkesat ligjore, duke siguruar kështu që përbërja e departamentit të jetë në përputhje me standardet ligjore;
3. Të realizohet një përditësim i literaturës me materiale të botuara në pesë vitet e fundit, për të siguruar që studentët kanë akses në informacionin më të ri dhe bashkëkohor;
4. Të implementohet një platformë për identifikimin e plagjiaturës dhe inteligjencës artificiale që do të ndihmojë në vlerësimin objektiv të punimeve të studentëve dhe integritetit akademik për personelin akademik dhe studentët;
5. Të inkurajohen studentët që të angazhohen më shumë në aktivitete shkencore, duke ofruar stimuj dhe mundësi për të marrë pjesë në projekte shkencore;
6. Silabuset e lëndëve të programit të përfshijnë tematika specifike që reflektojnë drejtimet dhe trendin e ri në fushën e përkthimit, kryesisht me karakter teknik dhe letrar (të cilat janë edhe pjesë e emërimit të programit), si dhe tematika në fushën e teknologjisë dhe informacionit apo përdorimin e CAT tools;



**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in
"Technical-literary translation and interpretation"**

a. Strengths and affirmations:

1. FGJH develops clear procedures in informing students about the study program, registration, fees, and opportunities for involvement in activities. This ensures that students have easy access to the information they need;
2. FGJH collects and analyzes students' statistical data from enrollment to graduation, ensuring that the information is accurate and protected;
3. Quality assessment processes are carried out periodically and transparently, with the dissemination of collected data on the institution's official website;
4. Students are involved in assessment activities, participating in committees and working groups. This gives them the opportunity to express their opinion on the learning processes;
5. The institution's building has well-equipped facilities, including specialized translation laboratories and a library rich in literature;
6. Academic staff with academic titles and degrees, as well as the necessary qualifications, obtained both at home and abroad;
7. A strong connection with the industry and the opportunities it provides for professional internships and student employment;
8. The involvement of the main unit in national and international projects, as well as Erasmus projects, enabling the acquisition of international experience;

b. Weaknesses:

1. The changes approved by the responsible bodies of the Faculty of Foreign Languages (FGJH), in accordance with Decision of the Council of Ministers (VKM) no. 41, dated 24.01.2018, regarding the distribution of credit load by formative activities, are not reflected in all the relevant documentation, specifically the Table of Formative Activities, the Curriculum Plan, and the Diploma Supplement; (*Standard II.1, criteria 1 and 3*)
2. The Greek language department has only 6 members, when the law requires at least 7 with high scientific titles; (*Standard II.2, criterion 1*)
3. Some of the literature does not have information on the year of publication, or belongs to an earlier publication period than the last 5 years; (*Standard II.4, criterion 5; Standard IV.3., criterion 2*)


Recommendations

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

140



1. To ensure that the approved changes regarding credit load distribution in line with VKM no. 41, dated 24.01.2018, are reflected in all relevant documents affected by this decision;
2. To take measures to hire a new member in the Department of Greek Language to fulfill legal requirements, thereby ensuring that the department's composition complies with legal standards;
3. To update the literature with materials published in the last five years in order to ensure that students have access to the most recent and contemporary information and knowledge;
4. To implement a platform for the detection of plagiarism and artificial intelligence use, which will support the objective evaluation of students' work and safeguard academic integrity for both academic staff and students;
5. To encourage students to become more engaged in scientific activities by offering incentives and opportunities to participate in research projects;
6. The syllabi of the program should include specific topics that reflect new directions and trends in the field of translation, mainly of a technical and literary nature (which are also part of the name of the program), as well as topics in the field of technology and information or the use of CAT tools;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X